

1 E hënë, 24 qershor 2024

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi merr pjesë përmes
5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 9.00

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretar i
8 Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

9 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Kjo është
10 çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim
11 Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.
12 Faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vërej që të
14 akuzuarit, me përjashtim të z. Krasniqi, janë të pranishëm në
15 sallën e gjyqit, z. Krasniqi i është dhënë leja të na ndjekë
16 përmes videolidhjes.

17 Vërej gjithashtu që për arsye personale edhe Gjykatësi
18 Barthe, po e ndjek këtë seancë përmes videolidhjes. Besojmë se
19 do të vijë nesër. Ka pasur probleme me transportin.

20 Përpara se të fillojmë me dëshmitarin e radhës kemi disa
21 urdhra me gojë. E para, ka të bëjë me provat materiale video
22 që janë pranuar sipas rregullës 154 për Dëshmitarin me numër
23 04410.

24 Ju rikujtoj se palët, me përjashtim të Mbrojtjes së
25 Selimit dhe Krasniqit që nuk u përgjigjën, pra, palët e tjera

1 u pajtuan se provat materiale me numër 1255 deri në 1262 mund
2 të klasifikohen si publike.

3 Ka ndonjë kundërshtim prej palëve? Nuk shoh të ketë
4 kundërshtime. Atëherë urdhëroj Zyrën Administrative të bëjë
5 riklasifikimin e dokumentit me numër P01255 deri në P01262 si
6 dokumente publike.

7 Ky është urdhri i parë me gojë.

8 Së dyti, kam një urdhër me gojë sa i takon për të njëjtin
9 dëshmitar.

10 Rikujtoj se materialet nga libri i Dëshmitarit 04410 u
11 kërkuan të pranoheshin si pjesë e provave gjyqësore si nga
12 Mbrojtja dhe nga ZPS-ja. Meqë këto materiale, pra, këto,
13 fragmente që janë pjesë e provës materiale P1264 dhe ato që
14 kanë dhënë Mbrojtja kanë numra të ndryshme ERN, atëherë do të
15 duhet për arsye administrative që këtë dokument ta pranojmë me
16 një numër të vetëm të provës materiale.

17 Ka kundërshtime? Me sa shoh nuk ka.

18 Atëhere i lutem Sekretarit të Gjykatës, që materialet me
19 numër 1D00159, për ndryshe me numrin SPOE00351537 -- deri në
20 SPOE00351537 deri në SPOE00351557 që është kërkuar të pranohet
21 si provë nga Mbrojtja e Thaçit, përfshirë përkthimin me numër
22 DHT04004 deri në DHT04006 dhe SPOE00351231 e kërkuar prej
23 Mbrojtjes së Selimit, përfshirë këtu dhe përkthimin që mban
24 numrin DSR00758 deri në DSR00758 të marri numrin përkatës të
25 provës materiale.

1 Me kaq mbyll urdhrin e dytë me gojë.

2 Sa i takon grupit të dëshmitarëve për këto dëshmi të
3 ardhme, vërej që përmes komunikimeve *inter partes*, Mbrojtja ka
4 kërkuar konfirmimin e ZPS-së të na thotë se cilët do të jenë
5 dëshmitarët që do të japin dëshmi pas Dëshmitarit 04752 dhe
6 ZPS-ja u përgjigje, dhe ka dhënë një listë të propozuar të
7 rendit të dëshmitarëve, megjithatë nuk mund të dal garant që
8 do të thirren këta dëshmitarë për shkak se dëshmia e
9 rëndësishme e Dëshmitarit 04752 mund të ketë ndikim në rendin
10 e dëshmitarëve që duhet të vijë.

11 Trupi Gjykses po ashtu pranon që duhet të jemi pak
12 fleksibël sa i takon dëshmitarëve të tjerë në këtë bllok
13 dëshmish sepse kjo ka të bëjë me disponueshmërinë e
14 dëshmitarëve po dhe me aspektet logjistike, prandaj është e
15 vështirë që të themi tani se në çfarë rendi do të vijë
16 dëshmitarët e tjerë.

17 Megjithatë ka një numër të konsiderueshëm dëshmitarësh në
18 këtë bllok dëshmish për të cilët kërkohet një përgatitje e
19 rëndësishme dhe e imtësishme, prandaj Trupi Gjykses urdhëron
20 ZPS-në që të thotë të paktën kush do të jenë dëshmitarët e
21 mundshëm pas dëshmisë së Dëshmitarit 04752 dhe këtë të na e
22 thotë deri nesër brenda orës 4.00, në mënyrë që Mbrojtja të
23 përgatitet në mënyrë të njëmend për këta dëshmitarë.

24 Me këtë mbyll urdhrin e tretë me gojë.

25 Tani do të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 04744.

1 Sekretar i Gjykatës, ju lutem të kalojmë në seancë
2 private për mbrojtjen e dëshmitarit.

3 [Seancë private]

4 [Seancë private teksti i fshirë]

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17 [Seancë e hapur]

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,

20 Dëshmitar. Përpara ke betimin solemn që duhet ta bësh në bazë

21 të rregullores së Gjykatës. Lexojeni tekstin që keni përpara

22 me zë, ju lutem.

23 DËSHMITARI: Faleminders.

24 Betim solemn: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë

25 sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do

1 të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën
2 dhe nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

3 DËSHMITARI: KURTESH FONDAJ

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
5 Dëshmitar. Mund të uleni tani.

6 DËSHMITARI: Faleminders.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
8 sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që mendohet se do të
9 zgjasë rreth tre ditë. Siç e dini, në fillim pyetjet i bën
10 Prokuroria, më pas kanë të drejtën ekipet e mbrojtjes t'ju
11 bëjnë pyetje, por pyetje mund të kenë dhe anëtarët e Trupit
12 Gjykues.

13 Prokuroria ka parashikuar dy orë për t'ju marrë ju në
14 pyetje. Ekipet e Mbrojtjes kanë kërkuar rreth 7 orë e gjysmë.
15 Inkurajoj të gjitha palët të jenë sa më të kujdesshëm në
16 shfrytëzimin e kohës për bërjen e pyetjeve. Trupi Gjykues mund
17 të lejojë pyetje shtesë nëse plotësohen kushtet.

18 Dëshmitar, përgjigjuni qartë me fjali të shkurtra. Nëse
19 nuk e kuptoni një pyetje, lirisht kërkon që pyetja t'ju
20 përsëritet ose thoni që nuk e kuptoni në mënyrë që ta
21 sqarojmë.

22 Gjithashtu, na thoni ku i bazoni ju faktet dhe rrethanat
23 dhe njohurinë për të cilën do të përgjigjeni.

24 Në qoftë se Prokuroria ju thotë që të përmendni disa nga
25 korrigjimet që keni bërë në deklaratat tuaja, ju lutem thoni

1 me zë për procesverbal, që deklarata me shkrim, bashkë me
2 korigjimet përkatëse, pasqyron saktësisht deklaratën tuaj.

3 Flisni pranë mikrofonit edhe prisni pesë sekonda përpara
4 se sa të përgjigjeni dhe ju lutem flisni ngadalë për
5 përkthyesit.

6 Gjatë ditëve që do të jepni dëshmi në sallën e gjyqit,
7 nuk duhet të diskutoni me askënd përmbajtjen e dëshmisë suaj
8 jashtë sallës së gjyqit. Në qoftë se ndonjë person, jashtë
9 sallës së gjyqit, ju kontakton për dëshminë tuaj, ju lutem na
10 thoni menjëherë.

11 Trupi Gjykses e kupton që ZPS-ja ka disa kopje fizike të
12 deklaratave të mëparshme që keni dhënë ju që t'i përdorni si
13 referencë në qoftë se do keni nevojë. Nëse nuk do t'ju
14 kujtohet diçka, do keni nevojë të konsultoheni me dokumentet
15 për të rifreskuar kujtesën tuaj, informoni paraprakisht Trupin
16 Gjykses. Po jua theksoj dhe një herë, mund t'i shihni
17 dokumentet vetëm në rast se nuk ju kujtohet diçka. Nuk duhet
18 të lexoni tekstin e këtyre dokumenteve.

19 Gjithashtu nëse ua kërkoj unë të mos flisni më, pushoni.
20 Gjithashtu mos flisni më nëse unë ngre dorën, sepse kjo do të
21 thotë që unë duhet të jap një udhëzim.

22 Në çdo moment që keni nevojë për pushim, më thoni në
23 mënyrë që ta organizojmë.

24 Do të fillojmë tani me pyetjet e Prokurorisë, që janë në
25 të majtën tuaj. Ju lutem dëgjojini me vëmendje.

1 Z. Halling, fjala është për ju.

2 Pyetje nga z. Halling:

3 Z. HALLING: [Përkthim]

4 PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar. Ne jemi takuat edhe më përpara.
5 unë quhem Matt Halling dhe punoj për ZPS-në. Unë jam Prokurori
6 që do t'ju bëj pyetjet sot paradite. Ju theksoj se jemi në
7 seancë publike.

8 Dëshmitar, si është emri dhe mbiemri juaj?

9 PË. Mirëmëngjesi fillimisht. Unë quhem Kurtesh Fondaj.

10 PY. Cila është datëlindja juaj dhe vendi juaj i lindjes?

11 PË. Jam i lindur më 4 mars 1960, fshati Peqan, komuna
12 Suharekë.

13 PY. A ju ka intervistuar më herët ZPS-ja?

14 PË. Po, jam intervistuar në vitin 2019.

15 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarit të Gjykatës të
16 nxjerrë në ekran materialin me numër 083249-TR-AT Pjesa 1
17 RED2, ju lutem të vendoset në gjithë ekranin.

18 PY. Dëshmitar, dokumenti që shohim në ekran a është
19 intervista e vitit 2019?

20 PË. Po. Po, kjo është intervista.

21 PY. Kohët e fundit a ju është dhënë mundësia ta lexoni dhe
22 një herë përmbajtjen e kësaj interviste?

23 PY. Po, më është dhënë mundësia javën që shkoi.

24 PY. Gjatë seancës përgatitore bëre disa ndryshime dhe
25 korrigjime në këtë intervistë, kështu?

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 10

1 PË. Mendoj që po.

2 PY. Po. Dhe këto ndryshimet u hodhën në një shënim të cilin
3 ua lexuam sërish, apo jo?

4 PË. Po.

5 PY. A e konfirmoni se ato që u lexuam në atë shënim,
6 pasqyrojnë saktësisht dhe tërësisht ndryshimet që bëtë ju?

7 PË. Po.

8 PY. Duke marrë parasysh ndryshimet në atë shënim, intervista
9 tashmë a pasqyron saktësisht atë që ke thënë aso kohe dhe që
10 do të thoje sot në sallën e gjyqit?

11 PË. Mendoj që po.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, gjykojmë se
13 kemi përmbushur kriteret e rregullës 154. Dhe në përputhje dhe
14 me vendimin F02328, ZPS-ja kërkon që të pranohen të gjitha
15 pjesët e versionit të rishikuar të materialit 083249-TR, siç
16 janë hedhur në listën tonë të materialeve, përfshirë Shënimin
17 Përgatitor 1, që mban numrin ERN 121695 deri në 12702, këtu
18 prefshin edhe provat materiale që janë renditur në
19 poshtëshënimin 98 të vendimit të dëshmitarit sipas rregullës
20 154.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
22 kundërshtime?

23 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtime.

24 Z. ROBERTS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

25 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

2 Materiali me numër 083249-TR-AT Pjesa 1 RED2, plus
3 Shënimi Përgatitor me numër 1 që mban numrin 121695 deri në
4 121702 dhe provat materiale shoqëruese pranohen.

5 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Deklarata me numër
6 083249-TR Pjesa 1 E Rishikuar RED2, do të marrë shënimin
7 përkatës, por dëshiroj që të theksoj që ka nëntë pjesë kjo
8 deklaratë dhe do të marri numrin e provës materiale P01327.
9 Pjesa 1 do të marri numrin P01327.1. Pjesa 2 në të dyja
10 gjuhët, do të jetë numri P01327.2. Pjesa 3 me numër P01327.3.
11 Pjesa 4 me numër P01327.4. Pjesa 5 merr numrin P01327.5.
12 Pjesa 6 do të marrë numrin P01327.6. Pjesa 8 do të marrë
13 numrin P01327.8. Ndërsa Pjesa 9 do të marrë numrin P01327.9.
14 Të gjitha janë të klasifikuara si konfidenciale.

15 Ndërsa Shënimi Përgatitor numër 1, që mban numrin ERN
16 121695 deri në 121702, do të marrë numrin e provës materiale
17 P01328. Po ashtu me klasifikim konfidencial.

18 Provat materiale shoqëruese U001-7877 deri në U001-7877,
19 në të dyja gjuhët, do të marrin numrin e provës materiale
20 P01329.

21 Materiali me ERN 083226 deri në 083226, në të dyja
22 gjuhët, merr numrin e provës P01330, me klasifikimin
23 konfidencial aktualisht.

24 Prova materiale shoqëruese me numër U000-6605 deri në
25 U000-6605, në të dyja gjuhët, do të marrë numrin e provës

1 1331. Po e përsëris edhe një herë, P01331.

2 Prova materiale shoqëruese IT-03-66 P29, në të dyja
3 gjuhët, si në anglisht dhe në shqip, merr numrin e provës
4 materiale P01332. Aktualisht me klasifikimin konfidencial.

5 Materiali me ERN 083227 deri në 083248, si në anglisht
6 dhe në shqip, me faqet konkrete 083227 deri në 083239, si në
7 anglisht dhe në shqip, marrin numrin e provës materiale P01333
8 edhe klasifikimi aktual është konfidencial.

9 Prova tjetër materiale, që është po ashtu pjesë e numrit
10 të sipërpërmendur, përkatësisht me numrin 083227 deri në
11 083248 e më konkretisht faqet 083240 deri në 083240, në dyja
12 gjuhët, marrin numrin e provës materiale P01334, aktualisht të
13 klasifikuara si konfidenciale.

14 Në të njëjtin dokument, në të njëjtin varg numrash, pra,
15 më konkretisht faqet 083241 deri në 083242, si në anglisht dhe
16 në shqip, merr numrin e provës materiale P1335. P01335, po
17 ashtu e klasifikuar si konfidenciale.

18 Faqet 083243 deri në 083243, si në anglisht dhe në shqip,
19 do të marrin numrin e provës materiale P01336, aktualisht e
20 klasifikuar si konfidenciale.

21 Faqet në të njëjtën varg numrash, siç u përmend më herët,
22 përkatësisht me numër 083244 deri në 083244, si në anglisht
23 dhe në shqip, do të marrin numrin e provës materiale P01337,
24 klasifikuar si konfidenciale.

25 Faqet e tjera me ERN 083245 deri në 083245, si në

1 anglisht dhe në shqip, do të marrin numrin e provës materiale
2 P01338, me klasifikim konfidencial.

3 Materiali me numër ERN 083246 deri në 083246, si në
4 anglisht dhe në shqip, do të marri numrin e provës materiale
5 P01339, klasifikimi aktual është konfidencial.

6 Ndërsa ERN me numër 083247 deri në 083247, si në anglisht
7 dhe në shqip, do të marrë numrin e provës materiale P0133,
8 P1340.

9 Materiali me ERN 083227 deri në 083248 dhe, në veçanti
10 faqet me numër 083248-083248, si në anglisht edhe në shqip, do
11 të marri numrin e provës materiale P01341, aktualisht të
12 klasifikuara si konfidenciale. Ju faleminderit.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. I nderuar Gjykatës,
15 ne kishim një përmbledhje të shkurtër për këtë dëshmitar
16 përpara se të vijonim.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam diçka për të thënë. Nuk mendoj
18 se deklaratat nuk janë aktualisht të klasifikuara si
19 konfidenciale. A mund të na thotë Prokuroria nëse ka ndonjë
20 pjesë të këtyre deklaratave që duhet redaktuar, përndryshe
21 mendoj se të gjithë dokumentet duhet të jenë publike.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Nëse kanë nevojë për redaktime,
23 atëherë ne sidoqoftë duhet të ruajmë klasifikimin
24 konfidencial. Sidoqoftë, ka disa pjesë të deklaratave që mund
25 t'i diskutojmë në seancë të hapur, por e mira është që

1 klasifikimi të mbetet si klasifikim konfidencial.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Po më falni, në qoftë se kjo është
3 një deklaratë e rregullës 154 dhe dëshmia do të jetë në seancë
4 publike dhe dëshmitari pranon ta japë në seancë publike,
5 mendoj që nuk ka asnjë problem, pra, gjithçka duhet të jetë
6 publike. Unë e pranoj se duhet të ketë pjesë që duhen
7 redaktuar, por dëshmia do të jetë publike.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptova
9 çfarë doni të thoni. Do të marrim një vendim më vonë.

10 Z. HALLING: [Përkthim] Mund të jap edhe një alternativë
11 tjetër, kur bëjmë rishikimin e redaktimit përkatës të këtij
12 transkripti, mund të rishikojmë dhe deklaratat në të njëjtën
13 kohë paralelisht dhe të vendosim nëse do të bëjmë redaktimet
14 përkatëse.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Deri kur mund
16 të na thoni që do të bëhet kjo?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Brenda të njëjtit afat si dhe për
18 transkriptin. Duhet të keni parasysh që masat mbrojtëse u
19 hoqën në momentin e fundit për ne.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
21 zgjidheni këtë se nuk më duket ndonjë gjë shumë e vështirë
22 kjo.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Përmbledhje.

24 Dëshmitari me numër 4744 është një ish-ushtar i UÇK-së
25 dhe do flasë për mënyrën si ka funksionuar Shtabi i

1 Përgjithshëm i UÇK-së.

2 PY. Dëshmitar, unë kam disa pyetje për ju.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Do i lutesha Sekretarit të
4 Gjykatës që të nxjerrë në ekran një hartë përkrah Shënimit
5 Përgatitor numër 2. Është me numër 121703 deri në materialin
6 që mbaron me 12 në fund. Ju lutem të vendoset në ekran harta.

7 PY. Dëshmitar, ndërkohë që presim të dalë materiali në ekran,
8 gjatë seancës përgatitore, a të kujtohet që ti shënove në
9 hartë zonat e përgjegjësisë së Pashtrikut në korrik 1998?

10 PË. Po.

11 PY. Dëshmitar, harta që kemi përpara në ekran, a është harta
12 për të cilën folëm?

13 PË. Po.

14 PY. Dëshmitar, që të jemi sa më të qartë për hartën dhe mbase
15 mund të na ndihmojë edhe Sekretari i Gjykatës, unë do ju
16 lutesha t'i shënonit dhe një herë të njëjtat zona përgjegjësie
17 që the gjatë seancës përgatitore.

18 Do t'ju jap një shënjes Asistentja e sallës. Ju lutem
19 shënjoni edhe një herë zonat e përgjegjësisë së Brigadës 123
20 që kishit shënuar dhe më përpara në këtë hartë?

21 PË. [Shënon]

22 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Në fakt ju dolët përpara pyetjes
23 që doja të bëja për numrin e brigadës.

24 Me ç'kam kuptuar, ju e keni ndarë në batalione këtë
25 hartë, në divizione. A mund të na tregoni ku është Batalioni i

1 1-rë i Brigadës 123? Cilat prej këtyre zonave?

2 PË. [Shënon]

3 PY. Po i dyti?

4 PË. Batalioni i 3-të nuk është formue dhe nuk ka funksionu
5 gjatë luftës. Po ka qenë i parapamë të veprojë në këtë terren.

6 PY. Dhe kjo është vija e ndërprerë në fund të kësaj harte që
7 keni bërë ju?

8 PË. Po. Këtu e kam vizatu me vija të ndërprera se realisht
9 kjo nuk ka funksionu në këtë rajon, por ka qenë në plan.

10 PY. Dhe tani nëse mund të na tregoni ku ishin disa nga
11 brigadat e tjera. Cila ishte zona e përgjegjësisë e Brigadës
12 121 në këtë kohë, pra, në korrik të vitit 1998?

13 PË. [Shënon]

14 PY. Faleminderit, Dëshmitar. A mund të bëni të njëjtën gjë
15 për Brigadën 122, ju lutem?

16 PË. [Shënon]

17 PY. Dhe sërish të njëjtën gjë për Brigadën 124, ju lutem?

18 PË. Zona e përgjegjësisë e Brigadës 124 ka qenë kryesisht
19 komuna e Rahovecit. Pjesa tjetër që kufizohej me Brigadën 122,
20 123, domethënë është ...

21 Zona, komanda në atë periudhë ka qenë Zatriqi.

22 PY. Dëshmitar, në zonën e Brigadës 124, a kam të drejtë të
23 them që ajo shtrihet deri në Opterushë dhe Reti në këtë hartë?

24 PË. Po. Që kjo pika është Opterusha, Retia e që kjo është
25 Zeqishti. Respektivisht, po.

- 1 PY. Në rregull. A mund të vini shkronjën Z aty ku është
- 2 Zeqisht?
- 3 PË. Zatriqi. Zoçishta.
- 4 PY. Zoçishta.
- 5 PË. Zoçishta. Mendoj që duhet me qenë në qët pikë.
- 6 PY. Faleminderit. Dhe një pyetje tjetër të fundit. A ka patur
- 7 Shtab të Përgjithshëm, një batalion të posaçëm me zonë
- 8 përgjegjësie në këtë zonë?
- 9 PË. Na e kemi ditë që po. Bëhet fjalë për një batalion
- 10 special që e ka udhëheqë komandant Guri në rajonin e
- 11 Llanishtit edhe të Grejçecit.
- 12 PY. Ju lutem, tregoni zonën ku ju mendoni që ka funksionuar
- 13 ky batalion.
- 14 PË. Qe zona. Zona dhe një herë që kjo t'u fillue, domethënë,
- 15 t'u kufizue tash me Brigadën 121 edhe me Brigadën 123.
- 16 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitari ka treguar me shkronjat
- 17 "b.sp" Për këtë zonë.
- 18 PY. Nuk është e thënë për ta shkruajtur në hartë, por pyetja
- 19 është a ka patur një njësi të veçantë në Brigadën 123?
- 20 PË. Edhe një herë pyetja?
- 21 PY. Patjetër. Në këtë kohë, në korrik të vitit 1998, a ka
- 22 pasur një njësi speciale Brigada 123?
- 23 PË. Ka një njësit i vogël që e kemi quajt si njësi speciale.
- 24 Ka funksionue brenda Batalionit të 1-rë të Brigadës 123,
- 25 PY. Dhe kush ishte komandant i kësaj njësie speciale?

1 PË. Ka qenë Vehbi Krasniqi.

2 PY. Faleminderit.

3 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne dëshironim
4 që ta dorëzonim këtë hartë si provë më vonë, megjithatë për
5 momentin do t'ju luteshim Gjykatës që të bënte një fotografi
6 të kësaj harte pasi dëshirojmë që ta dorëzojmë atë si pjesë të
7 dëshmisë.

8 Dhe pasi të jetë bërë kjo gjë, mund ta heqim nga ekrani.
9 Dhe të përdorim U000-2995 deri në U000-2995 për t'u vendosur
10 në ekran.

11 PY. Dëshmitar, meqenëse po presim që të vendoset dokumenti i
12 radhës në ekran. Në korrik të 1998, zona e Pashtrikut ka qenë
13 në komunikim me zonat e tjera?

14 PË. Po, diçka. Në korrik të 1998 nuk kanë figurue zonat
15 operative. Këtu ndoshta kanë qenë si koncept kështu me thënë
16 në letër, po me funksionalizu, nuk kanë qenë funksionale.

17 PY. Kur thoni që nuk kanë qenë funksionale, e keni fjalën për
18 zonën operacionale të Pashtrikut gjithashtu edhe për të e keni
19 fjalën?

20 PË. Po. Po edhe për zonën e Pashtrikut, se zakonisht unë ma
21 tepër kam informacion dhe di për zonën operative të
22 Pashtrikut, kurse për zona të tjera kam informacione shumë
23 pak.

24 PY. Atëherë Dëshmitar, ju keni thënë në seancën përgatitore
25 që është P01328, paragrafi 13, që njësitë e UÇK-së në Pashtrik

1 i raportonin Shtabit të Përgjithshëm gjatë gjithë luftës, por
2 kjo zonë filloi të funksiononte si zonë operationale në
3 dhjetor të 1998 sepse atëherë u bë komandant, komandant Drini,
4 komandant i zonës.

5 A është e saktë kjo, Dëshmitar?

6 PË. Po.

7 PY. Dhe për këtë e keni fjalën kur thoni që zona nuk
8 funksiononte si zonë në korrik të 1998?

9 PË. Kur them këtë kam parasysh që Brigada 123 prej themelimit
10 në korrik ka komunikue me Shtabin e Përgjithshëm,
11 respektivisht me shefin e Shtabit të Përgjithshëm, Bislum
12 Zyrapin, e jo me zonën.

13 PY. Kur komunikohet me territorin e zonave të tjera që ishin
14 bërë zona operationale, nëse mund ta themi kështu, si
15 organizohet ky lloj komunikimi në korrik të vitit 1998?

16 PË. Shikoni, unë në korrik të 1998 kam qenë një komandant i
17 një togu dhe realisht detyra jeme ka qenë pak më tepër me i
18 përgatitë ushtarët për përdorim të armëve dhe kryerje të
19 veprimeve luftarake. Kështu që sa i përket çështjes së pjesës
20 organizative, unë fort nuk jam në dijeni. Por me aq sa di unë
21 komunikimi është realizuar me Shtabin e Përgjithshëm,
22 respektivisht me Bislum Zyrapin.

23 PY. Dëshmitar, a e dini ju nëse territori i zonës
24 operationale të Pashtrikut komunikonte me territorin e zonës
25 së Dukagjinit në korrik të vitit 1998?

1 PË. Po ai komunikim është realizu, po është realizu në mes
2 Brigadës 123 dhe zonës operative të Dukagjinit, respektivisht
3 të njësive të Ramush Haradinaj.

4 PY. Tani Dëshmitar, dëshiroj që të shikojmë dokumentin në
5 ekran dhe në fakt pjesën e majit, pasi është në shqip. Bëhet
6 fjalë për datën 28 korrik 1998 dhe është kërkesë e shtabit
7 rajonal të Suharekës për furnizim me artikuj ushqimorë,
8 shkruhet.

9 Dëshmitar, a është ky një shembull i komunikimit ndërmjet
10 zonave të ndryshme?

11 PË. Po. Po këtu kemi të bëjmë me shtabin rajonal të UÇK-së,
12 pra, është fjala për njësitet. Para se mu u formu brigada kanë
13 ekzistue shtabet rajonale. E në shtabet rajonale, domethënë,
14 kanë qenë shtabi rajonal për Suharekë, për Malishevë, Rahovec
15 e kështu me radhë. Pra, këto kanë qenë shtabe rajonale
16 fillimisht, domethënë, gjatë muajit qershor. Edhe në fazën e
17 muajit korrik 1998 këto shtabe kalojnë edhe bëhen brigada.

18 PY. Pra, shikojmë këtu lartë që thuhet në fakt shtabi lokal
19 në Gllogjan, shtabi operativ i Rrafshit të Dukagjinit. Këto
20 ishin emërtimet dhe kështu shpjegohej territori në atë kohë?

21 PË. Po në bazë të këtij dokumenti, del që ka qenë kjo. Por,
22 unë realisht nuk jam fort në rrjedha të kësaj problematike.

23 PY. Dhe me ç'kam kuptuar, ju nuk e keni parë këtë kërkesë të
24 veçantë pra, përpara Seancës së Parë Përgatitore, apo jo?

25 PË. Nuk e kam pa.

1 PY. Por ju thatë që ka patur kërkesa të tilla që janë marrë
2 nga shtabi i Suharekës?

3 PË. Për sa i përket çështjes së bashkëpunimit, atë e di, se
4 kemi pasun në rrethana tjera që ne e kemi pas një grup
5 ushtarësh që e ka ndihmue zonën, domethënë, operative të
6 Dukagjinit. Se tash gjatë bisedave ne po i ngatërrojmë ndoshta
7 konceptet, po e përmendni zona, ndoshta është faza kur ka qenë
8 ende e organizume zona. Prandaj në këtë kuptim unë kërkoj
9 falje nëse bëj ndonjë gabim. Por, realisht ma mirë është me
10 thanë që gjatë muajit korrik dhe gusht ka pas komunikim në mes
11 pjesëve të njësive që kanë vepru në komunën e Suharekës me
12 njësi që kanë vepru në Dukagjin, respektivisht në Glllogjan.

13 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

14 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, ne do të
15 thonim që shpjegimi që na ka dhënë dëshmitar është i qartë
16 kështu që gjithçka që na është dorëzuar dhe kemi marrë në fakt
17 mund që ta t'ia japim Gjykatës, t'ia ofrojmë asaj.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk kemi kundërshti.

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim.

20 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtim.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
22 pranohet dokumenti. Mund t'i japim një numër.

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,
24 U000-2995 deri në U000-2995, në anglisht dhe në shqip, do t'i
25 jepet klasifikimi konfidencial. Faleminderit.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe tani ju kërkojmë Sekretarit të
3 seancës që në ekran të vendosë dokumentin P1327.1, faqet 23,
4 24 dhe 27 në gjuhën shqip.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Për momentin, i nderuar Gjykatës,
6 nuk shikojmë arsye se pse dokumenti që sapo u pranua të jetë
7 konfidencial.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kemi kundërshtim për ta
9 riklasifikuar atë.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
11 dokumenti U000-2995 riklasifikohet si publik.

12 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po. Tashmë merr
13 emërtimin P01342 dhe i klasifikuar si publik. Faleminderit,
14 Gjykatës.

15 Z. HALLING: [Përkthim]
16 PY. Dëshmitar, tani dëshiroj të kalojmë tek koha kur ju është
17 komunikuar emërimi në Brigadën 123. Prandaj do t'ju kërkoj
18 Sekretarit të seancës që të na vendosë në ekran një pjesë të
19 dëshmisë tuaj dhe për të dëshiroj t'ju bëj një pyetje.

20 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe tani kalojmë tek fundi i kësaj
21 faqeje në anglisht.

22 PY. Atëherë Dëshmitar, në këtë moment ju nuk ishit dakord me
23 karakterizimin që juve ju zgjodhën dhe këtu thuhet:

24 "Dhe fjalët, 'u zgjodh' nuk është fjala e duhur, pra,
25 'komandanti i Brigadës 123 dhe Kurtesh Fondaj', po ka qenë

1 Hashim Thaçi i cili më dha pozicionin e komandantit të
2 Brigadës 123 në 6 tetor.”

3 Dhe besojmë që është viti 1998.

4 Atëherë Dëshmitar, pyetja ime është: Çfarë tha me saktësi
5 Hashim Thaçi kur ju komunikoi emërimin juve?

6 PË. Këtë ditë, më 6 tetor 1998, ma ka komunikue emnimin. Se e
7 pata sqarue që emnimet e një niveli të komandantëve të
8 brigadave kryesisht janë kry nga Shtabi i Përgjithshëm edhe
9 ato nga Bislam Zyrapit, si shef shtabi. Kështu që Hashim Thaçi
10 mua këtë ditë ma ka komunikue emërimin dhe më thanë që ke të
11 drejtën të formon komandën e brigadës pa pasë nevojë që për
12 ekipën komanduese të kërkon verifikim.

13 PY. Çfarë do të thoshte “të formoje brigadë” në këtë kohë, 6
14 tetor 1998?

15 PË. Po ndoshta kur flitet kështu me kapërcime, nuk mund të
16 kuptohet. Për faktin se ne tash më duhet me sqaru se në
17 shtator të 1998, ne kemi pas një ofensivë në rajonin e
18 Budakovës, por paraprakisht dhe në muajin gusht të 1998. Dhe
19 thjesht muj me thanë që komanda e brigadës, por edhe ushtria,
20 ka qenë thuar gati e shpërbëme në atë periudhë. Prandaj tuj i
21 pa rrethanat që duhet të rikonsolidohet dhe të punohet në
22 vazhdimin e punës së brigadës, atëherë unë mendoj se kjo ka
23 ardhë si rezultat i saj. Dhe prej këtij momenti kemi fillu me
24 i konsolidue radhët e komandës së brigadës.

25 Se mos të harrojmë se ne kemi një fakt që është e vërtetë

1 që Blerim Kuqi si komandant i brigadës atë kohë gjendej në
2 Shqipëri, por edhe të gjithë anëtarët tjerë të komandës së
3 brigadës kanë qenë me ta në Shqipëri.

4 PY. Në përgjigjen e fundit që dhatë ju folët për brigadën që
5 u shpërnda. Rreth kësaj kohe, për afërsisht sa ushtarë kishte
6 ende Brigada 123?

7 PË. Brigada 123 në këtë fazë, është pra, faza e fundit të
8 shtatorit, fillimi i tetorit i ka pas dikund rreth 600 ushtarë
9 të koncentruar në dy batalione, batalioni i Budakovës dhe
10 batalioni që ka qenë mbrenda, domethënë, territorit të
11 Semetishtit, Rreshtanit, Studençanit, Peqanit.

12 PY. Gjithashtu ju thatë që "nga ky moment e tutje, ne filluam
13 me konsolidimin e radhëve të brigadës". Momenti të cilit i
14 referoheni që kur filluat është fundi i këtij takimit që patët
15 me Hashim Thaçi?

16 PË. Konsolidimi ka fillu edhe pak më herët, por realisht në
17 mënyrë intensive jemi marrë prej kësaj date se kemi pas edhe
18 kompetencat e plota për vazhdim të punës.

19 PY. A keni filluar ushtrimin e funksioneve tuaja si komandant
20 menjëherë pas mbarimit të këtij takimi?

21 PË. Po.

22 PY. Edhe një pyetje të fundit në lidhje me këtë çështje.
23 Hashim Thaçi ka thënë gjithashtu që kishit të drejtën të
24 formonit brigadën pa nevojë për verifikimet e personelit
25 komandues. Çfarë do të thotë kjo nëse mund ta shpjegoni më

1 tej, ju lutem.

2 PË. Po ne kemi qenë në situatë lufte dhe për çdo formalitet
3 në aspektin e pyetjes - a bën kjo, ky të hyn në ekip komandues
4 apo jo - e vështirësonte punën. Prandaj unë kam bindjen që në
5 këtë rast Hashim Thaçi ka pas besimin e plotë te unë edhe ma
6 ka besue që do t'i vendos njerëz ma meritor, respektivisht
7 njerëz me të cilët do ta ripërtërij brigadën.

8 PY. Ky verifikim pa nevojën e personelit drejtues të
9 komandimit, këtu bëhet fjalë për Shtabin e Përgjithshëm meqë
10 ra fjala për pjesën komanduese?

11 PË. Po. Pasi mungonte zona në atë periudhë atëherë është
12 fjala për shefin e shtabit të UÇK-së.

13 PY. Dhe përgjegjësia ka qenë e shefit të Shtabit të
14 Përgjithshëm, e keni fjalën për shefin e Shtabit të
15 Përgjithshëm?

16 PË. Po. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm ka bë emërimin e
17 komandantëve të brigadave dhe ka dhënë miratimin edhe për
18 anëtarë të komandës së brigadës.

19 PY. Atëherë rregulli në atë kohë ka qenë përgjithësisht që të
20 miratoheshin këto emëime nga Shtabi i Përgjithshëm?

21 PË. Nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, po.

22 PY. Dhe përse Hashim Thaçi ua delegoi juve këtë autoritet në
23 këtë moment?

24 PË. Po kam bindjen se ai pat besim në mu, respektivisht
25 ndoshta shefi i shtabit ia ka komuniku. Por shefi i shtabit,

1 në atë periudhë, nuk ka qenë në territorin e Kosovës. Prandaj
2 edhe komunikimi me të ka qenë thua j i pamundur. Po ndoshta
3 Hashim Thaçi ka pas kontakt edhe komunikim me shefin e
4 shtabit. Çka unë e besoj që po.

5 PY. Po. Atëherë Dëshmitar, në paragrafin 23 të P1328, në
6 Shënimin Përgatitor, ju shkruajtet:

7 "Që nga korriku ka qenë komandanti i brigadës që bënte
8 emërimet. Këto miratoheshin nga shefi i Shtabit të
9 Përgjithshëm, zakonisht Bislam Zyrapi. Dhe në rast se nuk
10 kishte miratim kërkohej një emërim tjetër, por këto lloj
11 çështje ishin pjesë e autoritetit të komandantit të brigadës."

12 Dëshmitar, kjo përgjigje e pasqyruar në shënimin
13 përgatitor a shpjegon në fakt se si qëndronte situata në atë
14 kohë?

15 PË. Në princip, në atë formë është dashtë me funksionu. Dhe
16 kam bindjen se q'ashtu ka funksionue.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe tani dëshiroj që Sekretari i
19 seancës të na vendosë në ekran një dokument tjetër me numrin
20 SPOE00226718 deri në SPOE00226719, në veçanti faqen e dytë të
21 saj, që është SPOE00226719.

22 PY. Dëshmitar, dëshiroj t'ju bëj një pyetje në lidhje me një
23 dokument në të cilin përmendet emri juaj.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Nëse mund të kalojmë tek faqja 2,
25 ju lutem.

1 PY. Është një raport i nënshkruar ku thuhet: Data 24 nëntor
2 1998, komandanti i togut të 3-të, Haqif Kadriaj. A e dini kush
3 është Haqif Kadriaj?

4 PË. Ka qenë komandant, domethënë, në togun nën njësitë të
5 batalionit të Budakovës, domethënë, Batalionit të 2-të.

6 PY. Dhe këtu në të majtë të kësaj faqeje thuhet që:

7 "Në 10.10.1998 u dha një urdhër nga Morina, i cili tha që
8 urdhrin e mori nga Kurtesh Fondaj, komandanti, që duhet të
9 bëheshin veprime të ndryshme gjatë ditës si edhe roje gjatë
10 natës. Dhe që të mos dilnin thjesht të armatosur. Dhe që
11 secili prej tyre të operonte në fshatrat përkatëse."

12 A i keni dhënë ju një urdhër rreth kësaj date Morinës,
13 Isë Morinës?

14 PË. Me konstituimin e komandës së brigadës, unë i kam ndaj
15 detyrat edhe iu kam dhënë në specifikë ç'ka duhet të veprojnë
16 dhe si duhet të veprojnë deri në një moment rehabilitimi pas
17 ofensivës që ata e kanë pas. Kjo realisht sipas datës del që
18 është dikund 24, 25 ditë pas përfundimit të ofensivës në
19 Batalionin e 2-të. Komandanti e ka shkruar në këtë formë, nuk
20 i di specifikat e asaj se ç'ka kam urdhnu saktë. Por qëndron.

21 PY. Dhe ju keni dhënë një urdhër të caktuar Isë Morinës, a
22 është e saktë kjo?

23 PË. Po, po. Po Isë Morina në atë kohë ka qenë autoritet për
24 udhëheqjen e Batalionit të 2-të në Brigadën 123 në Budakovë.

25 PY. Mesa keni ju dijeni a ka pasur ndonjë funksion tjetër të

1 zbulimit ai në kohë të caktuara gjatë luftës?

2 PË. Ma vonë në dhjetor ka pas një ristrukturim respektivisht

3 ndonjë ndryshim të vogël kadrovik në kuadër të Brigadës 123.

4 Po në atë periudhë, unë kam kalu në zonën operative të

5 Pashtrikut në funksion shef shtabi, kështu që nuk i di saktë,

6 por, ma merr mendja që ka qenë në sektorin e zbulimit dhe

7 kundërzbulimit. Por nuk jam i sigurt.

8 PY. Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni dhe një herë sepse nuk

9 arriti ta kapte përkthyesi.

10 PË. Pra, në muajin dhjetor ka pas ndryshime kadrovike në

11 komandën e Brigadës 123. Komandën e ka marrë Nexhmedin

12 Kastrati si komandant dhe ai ka bë një ndryshim të vogël

13 kadrovik edhe të strukturës së brigadës. E tash në kuadër të

14 asaj, Isë Morina ka mujt me pas detyrën e përgjegjësit për

15 zbulim dhe kundërzbulim, por nuk jam i sigurt.

16 PY. Faleminderit.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po shoh orën

18 që mund të bëjmë pushimin, megjithatë përpara se të bëjmë

19 pushimin do të doja që të kërkoja që të pranohej ky dokument.

20 Me numër SPOE00226718 deri në 226719. Është një raport me datë

21 e me firmë. Dëshmitari konfirmoi saktësinë e këtij urdhri edhe

22 ky është një dokument i sekuestruar prej Rexhep Selimit.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje?

24 PËRKTHYESJA: Ekipet e Mbrojtjes nuk kanë kundërshtime.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Materiali me numër SPOE00226718 deri në 226719 pranohet.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Dokumenti merr numrin e
3 provës materiale P01343 dhe aktualisht është i klasifikuar si
4 konfidencial.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Po shoh orën dhe mendoj që është
6 çasti më i përshtatshëm për të bërë pushimin e parë.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
8 Dhjetë minuta pushim.

9 Dëshmitar, do bëjmë vetëm dhjetë minuta pushim dhe do të
10 riktheheni në sallën e gjyqit.

11 DËSHMITARI: Faleminderit.

12 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
14 rikthehemi në orën 10.10.

15 --- Seanca ndërpritet në orën 10.03

16 --- Seanca rifillon në orën 10.12

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sillni
18 dëshmitarin në sallë, ju lutem.

19 Z. HALLING: [Përkthim] Ndërkohë që presim për
20 dëshmitarin, i lutem Sekretarit të Gjykatës që të vendosim në
21 ekran dokumentin me numrin e provës P1338.

22 [Dëshmitari vijon dëshminë]

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
24 uleni.

25 Në rregull, vazhdoni.

1 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit. Edhe një herë për
2 Sekretarin e Gjykatës të vendosë në ekran materialin P1338.
3 PY. Dëshmitar, tani do të flasim për kohën kur keni qenë shef
4 shtabi në zonën operative të Pashtrikut. Fillimisht për sa
5 kohë ose më saktë në cilën periudhë kohore e keni mbajtur këtë
6 pozitë?

7 PË. Në -- përgjegjës në zonën operative të Pashtrikut si shef
8 shtabi kam qenë në periudhën dhjetor 1998, janar dhe shkurt
9 1999. Në fund të shkurtit kam bërë unë një kërkesë për kalim
10 në një strukturë tjetër komanduese dhe realisht më është
11 mundësu dhe kam kaluar në Shtab të Përgjithshëm në sektorin për
12 shkollim dhe stërvitje gjatë fillimit të muajit mars.

13 PY. Para pushimit thatë që më pas iu zëvendësoi Nexhmedin
14 Kastrati. Edhe një herë. Pasi ju nuk ishit më shef shtabi i
15 zonës operative të Pashtrikut kush u emërua në vendin tuaj?

16 PË. Nëse nuk gaboj përsëri Nexhmedin Kastrati më ka
17 zëvendësuar dhe në funksionin e shefit të shtabit në zonën
18 operative të Pashtrikut.

19 PY. Dëshmitar, ekziston një urdhëresë që e keni dhënë ju më 3
20 janar 1999.

21 Z. HALLING: [Përkthim] Për momentin ka dalë vetëm
22 anglishtja në ekran. Shumë shpejt do të dali edhe shqipja.

23 PY. Në fillimet tuaja si shef i shtabit i zonës së
24 Pashtrikut, a ju është kërkuar ju të ndihmonit Brigadën 124?

25 PË. Po. Edhe realisht unë e kam -- jo që më është kërkuar po më

1 është urdhnu. Edhe unë kam vepru konform kësaj urdhnesës në
2 konsolidim të komandës së Brigadës 124, që në atë kohë e ka
3 pas komandën në Reti.

4 PY. Dokumenti në të majtë a është ky urdhri për të cilin sapo
5 fole?

6 PË. Po. Ky është dokumenti.

7 PY. Çfarë ndihme i dhatë ju kësaj brigade?

8 PË. Po në këtë urdhër janë specifikum edhe detyrat. Tash
9 detale konkrete muj me u bazu dhe me i shiku qëto. Qëto kanë
10 qenë detyrat di që kam punu dhe në front pas kësaj. Di që unë
11 e kam bë një raport me shkrim lidhur me të gjeturat edhe me
12 detyrat që i kam -- me punën që e kam bo edhe orientimet,
13 detyrat që iu kam dhënë komandës për vazhdim të punës së
14 mëtejshme.

15 PY. A e more përsipër komandimin e kësaj brigade gjatë
16 ushtrimit të këtyre detyrave?

17 PË. Po, por kjo shkon automatikisht. Në momentin kur unë jam
18 vendos dhe kam marrë, domethënë jam vendos në komandë të
19 brigadës derisa aty kam qëndru në -- komanda e brigadës ka
20 qenë nën urdhrin tem, domethënë nën komandën teme. Dhe në
21 përfundim unë ja kam kthy detyrën sikurse e parasheh urdhri i
22 komandantit të asaj kohës, Skënder Hoxhës dhe jam kthy në
23 komandë të zonës operative në Kosterc.

24 PY. The që ja dhe detyrën Skënder Hoxhës. Skënder Hoxha ishte
25 komandanti i Brigadës 124 në të njëjtën kohë që i morët ju

1 përsipër këto detyra?

2 PË. Po, po, Skënder Hoxha ishte edhe paraprakisht komandant i
3 asaj brigade po kishte vështirësi dhe prandaj komanda,
4 domethënë e zonës, respektivisht komandant i zonës Ekrem Rexha
5 e pa të nevojshme respektivisht, edhe këtu e jep në bazë të
6 urdhrit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së,
7 domethënë është kërkesë edhe nga Shtabi i Përgjithshëm, në
8 këtë rast edhe nga Bislir Zyrapi, që përcjell një epror për me
9 e ndihmu Brigadën 124. Edhe unë kam vepru konform këtij
10 urdhri.

11 PY. Skënder Hoxha a ka qenë ushtar profesionist sikurse ju?

12 PË. Me sa mbaj mend po ka qenë ushtarak, ka qenë me shkollë
13 të mesme ushtarake.

14 PY. Kur thoni "dytësor" ishte i njëjti nivel arsimit ushtarak
15 që kishit edhe ju?

16 PË. Jo. Unë kam të kryme Akademinë Teknike Ushtarake.

17 Domethënë grada jeme ka qenë e nënoficerit të -- edhe kam pas
18 gradën toger. E Skënderi në ish-armatën jugosllave ka pas
19 detyrat e nënoficerit, respektivisht, gradave rreshter.

20 PY. Grada rreshter është më e ulët se grada që kishit ju, apo
21 jo?

22 PË. Po, po. Grada rreshter është gradë e nënoficerit.

23 PY. Çfarë vështirësish kishte Skënder Hoxha në zonën e tij.

24 Me çfarë vështirësish do ta ndihmonit ju atë?

25 PË. Po sipas këtij dokumenti, mundem me pa, pra qëllimi ka

1 qenë të bëj konstituimin e gjendjes njerëzore, konstatimin e
2 gjendjes njerëzore me pa sa është numri i eprorëve, ushtarëve,
3 kuadrit tjetër komandues. Pra, në të vërtetë ne kur kërkonim
4 raporte në zonë në lidhje me situatën në brigadë, Skënder
5 Hoxha nuk kishte informacion me dhënë këto shënime. Prandaj
6 ishte çështja si mund të bëhet dhe si duhet të funksionojë për
7 me mujt ai me kry me i grumbullu të dhënat dhe për me mujt me
8 i fut komplet strukturën, domethënë, ushtarake nën komandën e
9 tij.

10 Pastaj edhe elemente të tjera. Por realisht është shku
11 shumë kohë prej asaj. Realisht po flas me hamendje.

12 PY. Me sa dini ju problematikat në zonën e -- në brigadën e
13 Skënder Hoxhës vijuan edhe pasi u larguat ju nga zona?

14 PË. Nuk i di, nuk i di specifikisht çfarë ka pas, tek ka pas.
15 Kam pas edhe unë boll punë të tjera kështu që nuk jam marrë më
16 me këtë problematikë.

17 PY. Faleminderit.

18 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem tani Sekretarit të
19 Gjykatës të nxjerrë në ekran materialin SPOE00232262 deri në
20 SPEO00232265. Na nevojitet faqja e parë.

21 PY. Dëshmitar, do t'ju bëj disa pyetje lidhur me ndalimin e
22 Blerim Kuqit që e keni diskutuar në intervistën tuaj me ZPS-
23 në. Në veçanti dua të flasim për deklaratën që keni dhënë në
24 mbrojtje të Blerim Kuqit.

25 Si fillim shohim dokumentin që lexon "Aktakuzë". E këtu

1 do të shihni disa pretendime të paraqitura në paragrafin më
2 poshtë. A janë të njëjta pretendime që shohim këtu,
3 pretendimet që u ngritën kundër Blerim Kuqit?

4 PË. Unë këtë dokument e kam pa në fazën përgatitore që e kam
5 pasë me juve z. Prokuror. Paraprakisht nuk e kam pa këtë
6 dokument. Po realisht në bazë të kësaj që po shkruhet këtu
7 kryesisht kjo problematikë edhe unë si pjesëtar i UÇK-së kam
8 pasur bindjen se për këtë problematikë po akuzohet Blerimi.

9 PY. Faleminderit. Ju lutem të shkojmë në fund të faqes. Këtu
10 thuhet cilët janë dëshmitarët, edhe do të shihni edhe emrin
11 tuaj këtu përkrah Habib Elshanit dhe Ilaz Kadollit. A kanë
12 qenë këta dëshmitarët në procesin gjyqësor kundër Blerim
13 Kuqit?

14 PË. Unë kam qenë po më duket [E pakuptueshme] mbasi e
15 përmendëm që edhe një dëshmitari i cili nuk po figuron. Se kur
16 kam shku unë me dhënë dëshminë me mu ka qenë edhe Isuf
17 Krasniqi. Edhe ai ka dhënë dëshmi. Këtu s'qenka ai, në këtë
18 listë i përmendun emri i tij.

19 PY. Në rregull. Por ama këto tri emra, mes të cilëve edhe
20 emri juaj, kanë qenë dëshmitari në këtë çështje, apo jo?

21 PË. Nëse s'gaboju po, unë po. Për këta dy të tjerët nuk e di
22 saktë, por megjithatë unë po.

23 PY. Faleminderit.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do të kërkoja që të shfaqej
25 në ekran materiali me numër SPOE00231841 deri në SPOE00231843.

1 Konkretisht faqja 2 që mban numrin SPOE00231842, si në shqip
2 edhe në anglisht.

3 PY. Dëshmitar, ky është një dokument apeli që ka dorëzuar
4 Mbrojtja e Blerim Kuqit. Do të shohim këtu më konkretisht që
5 vërtetohet -- presim pak. "Është deklarata, thotë, e Kurtesh
6 Fondajt".

7 Dhe më pas jep një përmbledhje të dëshmisë që keni dhënë
8 ju. Tani pyetja ime është kjo: Kjo përmbledhje që shohim a
9 është e saktë? A është ajo që keni thënë ju për Blerim Kuqin?
10 PË. Po. E kam thënë edhe më shumë se kjo. Por megjithatë kjo
11 është e përmbledhme. Po.

12 PY. Këtë deklaratë ku e keni dhënë?

13 PË. Deklaratën para Prokurorit, [E pakuptueshme] po e di që
14 ka qenë Prokuror, e kam dhënë në Divjakë, në -- s'e di saktë,
15 q'atë muajit shkurt të vitit 1999.

16 PY. Kush të kërkoi ta jepje këtë deklaratë?

17 PË. Unë deklaratën e kam dhënë para Sokol Dobrunës edhe çdo
18 herë jam i bindur se ai ka qenë Prokuror në rastin e Blerimit.
19 Pra, unë e kam dhënë deklaratën para tij, në prezencën e
20 avokatit mbrojtës të Blerim Kuqit, Agron Berisha, dhe një
21 procesmbajtës i cili ka evindentu komplet ato ç'ka unë kam fol
22 dhe kam dhënë dëshmi në një fletore.

23 PY. Faleminderit. E kuptoj. Po ta bëj pyetjen pak më
24 ndryshëm. Ty fillimisht kush të kërkoi që të shkoje në Divjakë
25 dhe të jepje deklaratë? Kush ta kërkoi ty këtë?

1 PË. Dikush i ka kërku komandantit të zonës, Ekrem Rexhës,
2 edhe Ekrem Rexha më ka njoftu mu që duhet të shkosh në Kleçkë
3 në lidhje me Blerim Kuqin. Tash rrethanat se kush e ka kërku,
4 tek e ka kërku unë nuk i di. Nuk i di.

5 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam nevojë që
6 të sqarohet paragrafi 24 i Shënimit Përgatitor numër 2.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër.

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 PY. Dëshmitar, në Shënimin Përgatitor ju keni thënë që keni
10 shkuar në Divjakë për të dhënë deklaratë në mbrojtje të Blerim
11 Kuqit dhe me kërkesë të mbrojtjes së Blerim Kuqit, kështu?

12 PË. Ka mujt me konun edhe kërkesa e tijna. Ka mujt. Po unë
13 qysh e kuptova kush juve ju ka thënë me shku me dhënë dëshmi.
14 Edhe tash a kon [E pakuptueshme] kryesorja që mundet me qenë
15 edhe ajo që ka insistu edhe mbrojtësi i Blerim Kuqit që unë ta
16 jap dëshmi. Nuk e kundërshtoj atë që ju kam thënë juve z.
17 Prokuror.

18 PY. E kuptoj. The që ka qenë edhe Sokol Bodruda -- Dobruna,
19 atje, më falni, edhe se ai ka qenë Prokurori në këtë çështje.
20 Pse mendoni ju që ka qenë ai Prokurori në këtë çështje?

21 PË. Po unë deklaratën e kam dhënë para tij. Ai mi ka shtru
22 pyetjet edhe unë i kam dhënë përgjigjet në bazë të pyetjeve që
23 i ka bo Sokol Dobruna. Edhe për mua ka qenë prokuror,
24 gjykatës, s'di qysh kish mujt me më bo pyetje mue në dhënien e
25 deklaratës.

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 37

1 PY. Në rregull. Pra, sipas teje ai ishte Prokurori sepse
2 ishte personi që ju bënte pyetjet, apo jo?

3 PË. Edhe unë sot jam i bindur se kam dhënë dëshmi para
4 Prokurorit.

5 PY. Faleminderit.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këto dy
7 materiale me numër SPOE00232264 deri në 0023265 dhe më pas
8 SPOE00231841 deri në 0231848 janë materiale të sekuestruara
9 prej Jakup Krasniqit dhe janë përdorur për të kuptuar më mirë
10 kontekstin e këtij dëshmitari. Për shembull, janë pjesë e një
11 grupi dokumentesh të ndryshme. Më konkretisht prova me numër
12 P1106 është një raport i policisë ushtarake i datës 16 janar
13 1999, dhe mban numrin PP599. Po në të njëjtën ditë është një
14 raport me të njëjtin numër që gjendet i përmendur në fillim të
15 faqes së dytë.

16 Pra, me këtë doja të thoja që është përmbushur kriteri i
17 pranueshmërisë që të pranohen këto dokumente.

18 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne e kundërshtojmë. Ky është një
19 kundërshtim i vazhdueshëm sa i takon këtyre materiale. Me sa
20 kuptojmë ne këto janë materiale që janë sekuestruar nga një
21 skrivani pune apo vend pune. Dëshmitari as nuk e ka parë më
22 përpara, as nuk e di kur janë përgatitur, as nuk e di kush i
23 ka lënë ato në skrivaninë e punës. Nuk mendojmë që dëshmitari
24 është personi i duhur për këto materiale. Dhe gjithashtu, ai
25 nuk e di kush i ka përgatitur këto materiale?

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka gjë
2 tjetër?

3 Në rregull. Materiali me numër SPOE00232264 deri në
4 SPOE00232265, dhe materiali me numër SPOE00231841 deri në
5 SPOE00231843 pranohen sepse përmbushim standardet *prima facie*
6 të rregullës 138.

7 Vazhdoni.

8 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali me numër
9 SPOE00222264 deri në SPOE00232265 do të marrë numrin e provës
10 materiale P01344, aktualisht kanë klasifikimin konfidencial si
11 shqipja dhe anglishtja.

12 Ndërsa materiali me numër SPOE00231941 deri në
13 SPOE00231843 si në shqip dhe në anglisht marrin numrin e
14 provës materiale P01345, aktualisht klasifikuar si
15 konfidencialë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund t'i
17 klasifikojmë si publikë?

18 Z. HALLING: [Përkthim] Po, po.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
20 Të dy dokumentet që tashmë kanë numrin e provës materiale
21 P1344 dhe P1345 riklasifikohen si publikë.

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Në rregull, do të bëjmë
23 riklasifikimin përkatës.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Tani do të doja të vendosni në
25 ekran një hartë tjetër. Mban numrin 121703 deri në 121113 dhe

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 39

1 na duhet edhe faqja e fundit që mban numrin P121713. Ju lutem
2 të vendoset në ekran.

3 PY. Dëshmitar, tani do të flasim pak për shkurtin e 1999-s që
4 ka qenë edhe periudha kur keni qenë shef shtabi i zonës së
5 Pashtrikut. Gjatë seancës përgatitore a mban mend që të
6 kërkuam që të shënoje zonën e përgjegjësisë të brigadave që
7 kishte kjo zonë në atë kohë?

8 PË. Po.

9 PY. Siç bëmë edhe me hartën tjetër të korrikut 1998 do ju
10 luteshim edhe tani të shënoni zonat e ndryshme të
11 përgjegjësisë që kishit në atë kohë. Do t'ju ndihmojë
12 Asistentja e sallës për këtë.

13 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të shihni
14 që është zmadhim i hartës që është zmadhuar më herët.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
16 prisni sa të dali harta. Nuk ka dalë ende në ekran.

17 Në rregull.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

19 PY. Dëshmitar, njësoj siç bëmë edhe më përpara ju lutem të
20 shënoni zonën e përgjegjësisë që kishte Brigada 123 në këtë
21 hartë, ju lutem.

22 PË. A ka mundësi pak me e rrit madhësinë e figurës?

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Patjetër, po.

24 Z. HALLING: [Përkthim]

25 PY. Dëshmitar, a ke nevojë ta zmadhojmë më shumë apo është e

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 40

1 qartë?

2 PË. I tash është në rregull.

3 PY. Njësoj si më përpara ju lutem fillojmë një herë me
4 Brigadën 123 dhe batalionët përkatës.

5 PË. Edhe pak nëse bën me e rrit se nuk jam t'u mujt me e
6 lexu.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Po ta zmadhoj më shumë
8 do humbasim shkronjat. Ky është një dokument që ka shënime.

9 Z. HALLING: [Përkthim] Meqë dëshmitari ka kërkuar të
10 zmadhohet, atëherë ju lutem zmadhojeni sepse mund t'i shënojmë
11 edhe një herë.

12 DËSHMITARI: Pastaj e zvogëlojmë q'atë të vizatimit por
13 një herë vetëm qët pjesën ku prezantohet pjesa e komunës së
14 Suharekës.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Mendoj që në fakt një version më i
16 zmadhuar do të jetë gjëja e duhur që të vizatohet siç duhet
17 gjithçka.

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë do t'i kërkojmë
19 dëshmitarit që të mos vijojë më.

20 Z. HALLING: [Përkthim]

21 PY. Atëherë ju lutem Dëshmitar mos vijoni, por do të fillojmë
22 vizatimin, domethënë, sërish më pas.

23 Dëshmitar, a ju mjafton ky lloj zmadhimi tani për të bërë
24 punën e duhur apo jo?

25 PË. Në rregull është.

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 41

1 PY. Faleminderit.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë falënderojmë edhe
3 Sekretarin e seancës.

4 PY. Atëherë Dëshmitar ju lutem filloni sërish së pari me
5 Brigadën 123.

6 PË. [Shënon]

7 Z. HALLING: [Përkthim] Dëshmitari në fakt po vijon edhe
8 me të tjerat përtej Brigadës 123. Pra, dëshmitari ka vendosur
9 edhe Brigadën 124, e të tjerë.

10 DËSHMITARI: Brigada 123 kufizohet në pjesën jugore -- në
11 pjesën perëndimore me Rahovecin, respektivisht me Brigadën
12 124. Në pjesën jugore, me Brigadën 125, që një batalion
13 komandën e ka pasë në Kabash. Batalioni i Budakovës së
14 Brigadës 121. Një batalion i dytë në Budakovë. Brigada ka pasë
15 -- e ka pasë komandën në lagjen Breshanc të Nishorit. Ndërsa
16 zona operative ka qenë komanda e zonës --

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 PY. Po. Dëshmitar, në mënyrë që gjithçka të bëhet me rendin e
19 vet, ZOP-ja është komanda e zonës së Pashtrikut apo për 123-
20 shin si brigadë?

21 PË. ZOP është komanda e zonës operative të Pashtrikut. Ndërsa
22 me pikën lart në pjesën e veriut në raport me te, ku shkrun
23 "Nishor", vetëm si pikë është komanda e Brigadës 123 -- jo
24 121, s'e di pse e paskam shkru gabim.

25 PY. Dhe shikojmë B2 dhe B3 me të njëjtën vijë. Këto janë dy

1 batalionet e tjera të së njëjtës brigadë apo jo?

2 PË. Po. Batalioni 1, Batalioni 2. Edhe 3-shi që ka qenë
3 perspektive por edhe një herë prezantohem me pika, me viza të
4 ndërpreme kjo nuk ka funksionu kurrë në terren. Edhe pse më
5 vonë ka pasë disa tentime, jo tentime por rritje të Brigadës
6 123 në një fazë ka pasë edhe dy batalione në pjesën e
7 Batalionit 1. Po kjo mbas marsit është -- kjo është -- mua mu
8 kërkua me qenë janar edhe shkurt.

9 PY. Po. Ashtu është. Atëherë, numri që ju keni shkruajtur
10 këtu te batalioni është B123, e saktë është kjo?

11 PË. BR 123. Brigada, BR 123. A këtu veç B1.

12 PY. Faleminderit. Po tani mund të na tregoni me vizë se ku ka
13 qenë Brigada 121?

14 PË. 121 kufizohet me Brigadën 123 në qet pjesë. Pastaj
15 vazhdon në Bajë, dhe rajoni deri te Gryka e Llapushnikut.
16 Kënejna nga rruga magjistrale për Shtimje deri dikun afër
17 Shtimjes q'ky rajon është zona e përgjegjësisë së Brigadës
18 121.

19 PY. Dhe tani për Brigadën 122, ju lutem.

20 PË. Brigada 122 tash është brigada që ka kontrolluar zonën e
21 komunës së Malishevës deri në pjesën e magjistrals. Veç ky
22 rajoni është i Brigadës 122 në -- komandën e ka pas në
23 Dragobil, respektivisht në Marali në këtë pikën ku e
24 prezantova.

25 PY. Po kemi edhe një B.sp. Është ky batalioni i posaçëm,

1 special për të cilën folën në 1998?

2 PË. Po. Po. Ky bazën e ka pas në Llanishtë, ndërsa komanda e
3 Brigadës 121 ka qenë në Kleçkë.

4 PY. Dhe në jug-lindje thuhet OP Nerodima. Çfarë do të thotë
5 kjo?

6 PË. Kemi zonën operative të Nerodimës.

7 PY. Në rregull. Atëherë edhe një gjë të fundit përpara se ta
8 lëmë hartën. Ju keni treguar dhe se selinë qendrore për
9 Brigadën 123 dhe zonën, nëse mund të na tregoni selinë
10 qendrore ose shtabin e brigadave të tjera. Për shembull, ku
11 ishte shtabi i përgjithshëm i Brigadës 121, ju lutem?

12 PË. Brigada 121 e ka pas në Kleçkë komandën afër rajonit të
13 Shtabit të Përgjithshëm në Divlljakë. Me këtë rrethin që ka
14 qenë këtu në hartë është mendu komanda e Shtabit të
15 Përgjithshëm.

16 PY. E kuptuam. Ju përmendët edhe ku ishte komanda e Brigadës
17 123. Megjithatë a mund të na e tregoni në hartë, ju lutem.
18 122.

19 PË. E Brigadës 123 është në një lagje Breshanc e fshatit
20 Nishor.

21 PY. Jo, unë e kisha fjalën për 122-shin. Brigadën 122, ju
22 lutem.

23 PY. Brigada 122 ka -- e ka pas komandën në fshatin Dragobil,
24 respektivisht Marali. Këto janë dy fshatra ngjit njëna me
25 tjetrën.

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 44

1 PY. Po. Dhe 124? Brigada 124 nëse mund të na tregoni selinë
2 qëndrore të saj në hartë, ju lutem?

3 PË. Për këtë fazë brigada e ka pas komandën në Reti.

4 PY. Dhe selia qëndrore e Brigadës 125, ju lutem?

5 PË. 125 ka funksionue në disa batalione. A një prej
6 batalioneve ka funksionue në Kabash dhe komanda e saj është në
7 fshatin Kabash. Për pjesë të tjera të Vrrinit e këto elementet
8 nuk i di. Nuk kam qenë kurrë në atë territor gjatë fazës së
9 luftës.

10 PY. Faleminderit, Dëshmitar. Mendoj që është e qartë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Vetëm në rast se ka Gjykata pyetje
12 për Dëshmitarin në lidhje me hartën. Në rast se jo, ne atëherë
13 e kërkojmë që ta paraqesim si provë këtë hartë si dhe atë të
14 korrikut të 1998-s me shënimet e bëra sot. ERN-ja e tyre është
15 121712 deri në 121713.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A ka
17 kundërshtime?

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

19 Z. ELLIS: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë të
21 dyja versionet e hartës pranohen dhe do t'u caktohet -- do të
22 caktohet një numër i vetëm për to, një numër P.

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës,
24 harta e parë me shënimet e dëshmitarit, e cila tashmë ka
25 numrin REG001181 deri në REG001181, dhe për momentin me

1 klasifikimin konfidencial. Ndërkohë që harta e dytë e cila ka
2 patur numrin REG001182 deri në REG001182 për momentin me
3 klasifikimin konfidencial do t'ju jepet numri si provë P01446.

4 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar, sigurisht që të dyja
5 mund të jenë harta publike.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë këto
7 harta klasifikohen si publike.

8 Z. HALLING: [Përkthim]

9 PY. Atëherë, Dëshmitar, qëndrojmë tek viti 1999, dhe
10 dëshirojmë t'ju tregojmë një dokument tjetër shtesë.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Me numrin 06677, dhe i kërkojmë
12 Sekretarit të seancës ta shfaqë atë në ekran. Në rast se ju
13 ndihmon faqja në gjuhën shqipe gjendet tek 066767 deri në
14 066797, por është e njëjta faqe ama 066787.

15 PY. Dëshmitar, meqenëse ky dokument do të vendoset në ekran,
16 në cilësinë tuaj si shefi i shtabit të zonës operative të
17 Pashtrikut ju keni patur ndonjë numër protokolli për
18 urdhëresat që lëshonit, përdornit numër protokolli?

19 PË. Në fazën e dhjetorit, në fund të dhjetorit, po sidomos në
20 janar, shkurt ne kemi mbajtur një protokoll shumë strikt në
21 zonën operative të Pashtrikut.

22 PY. A e mbani mend numrin e protokollit që keni përdorur?

23 PË. Jo, jo s --

24 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë nëse mund të përqendrohemi
25 te urdhëresa që kemi në ekran tashmë. Dhe nëse mund të kalojmë

1 pak poshtë tek dokumenti në gjuhën shqipe. Oh tani pak më
2 lart, ju lutem. Faleminderit.

3 PY. Dëshmitar, a është kjo firma juaj në këtë urdhëresë?

4 PË. Po.

5 PY. Dhe këtu thuhet që kemi pra edhe një numër? A ka të bëjë
6 kjo 02/1-73, a ju kujton kjo numrin e protokollit?

7 PË. 02/1-73, po, numër protokollit është.

8 PY. Dhe kjo është një urdhëresë siç thuhet që tek pjesa e
9 parë:

10 "Në bazë të Rregullores së SHP, pika 12 dhe 15 për shkak
11 të nevojës së shërbimit me qëllim të rritjes së gatishmërisë
12 luftarake jap këtë urdhëresë."

13 Cila është kjo rregullore?

14 PË. Nuk muj me u kujtu tash saktë për çfarë rregullore bëhet
15 fjalë, po është fjala për rregullimin e brendshëm të punës. Po
16 saktë se ç'ka përmbajt ajo dhe ç'ka është nuk e di. Por muj me
17 thonë në përgjithësi se në fazën e dhjetorit ne i kemi dhënë
18 detyra personelit të caktum, të bëjë të përgatisë rregullore.
19 Dhe pastaj i kemi lexu ato rregullore dhe disa prej tyre i
20 kemi aprovu në komandë apo në shtab të zonës operative të
21 Pashtrikut dhe kemi vepru pastaj me to.

22 Pra, në periudhën janar, sidomos janë nxjerrë plot
23 rregullore që kanë pas të bëjnë me organizimin e jetës së
24 brendshme edhe punës në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës,
25 sidomos për nivel zone.

1 PY. Po. Ju keni thënë në përgjigjen tuaj që ju keni vepruar
2 në bazë të rregulloreve. Atëherë, kjo që citohet këtu, a është
3 pikërisht baza mbi të cilën pra ju keni bazuar urdhëresën që
4 keni lëshuar?

5 PË. Detajet nuk më kujtohen rreth kësaj, megjithatë një
6 çështje muj me thënë se urdhnesa është shkresë zyrtare që
7 është lëshu në atë kohë dhe unë qëndroj prapa saj.

8 PY. Atëherë, me ç'kuptoj këto dispozita që citohen në fillim
9 të kësaj urdhërese ju nuk e mbani mend se çfarë thuhej për
10 shembull në Rregulloren e Shtabit të Përgjithshëm? Është e
11 saktë kjo që thamë?

12 PË. Nuk i di, nuk i di. Sot vërtetë nuk i di.

13 PY. Kjo urdhëresë a është lëshuar në bazë të këtyre
14 dispozitave edhe pse juve nuk i mbani mend ato sot?

15 PË. Po nuk ka kuptim me qenë dispozitat me thënë diçka tjetër
16 e unë nisem me pas kuptim diçka tjetër. Pra, sigurisht është
17 thirr në qëto pikat të q'asaj rregullores. Pra, ato pika me
18 siguri kanë të bëjnë me problematikën që është fillu ma vonë,
19 pra me urdhënesë.

20 PY. Faleminderit.

21 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkojmë që të
22 paraqitet edhe ky dokument si provë.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
24 kundërshtime?

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Nuk ka kundërshtime.

1 Z. ELLIS: [Përkthim] Vetëm kjo faqe po dorëzohet nëse
2 mund të kontrolloj për këtë gjë?

3 Z. HALLING: [Përkthim] Po, keni të drejtë vetëm kjo faqe
4 me numrin e saj përkatës i cili është 066777.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Atëherë nuk kemi kundërshtim për
6 këtë faqe.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
8 066777, plus versionit në gjuhën shqipe do t'i japim një numër
9 si dëshmi.

10 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, po
11 për momentin ky dokument është i klasifikuar konfidencial.

12 Z. HALLING: [Përkthim] Po, mund të bëhet.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]

14 Z. HALLING: [Përkthim] Në fakt për këtë do të na kërkohet
15 në redaktim që kemi në fund të urdhëresës. Kështu që do të na
16 duhet që klasifikimi të vijojë të jetë konfidencial. Pra, mund
17 të jetë publik, mund të bëhet publik versioni i redaktuar.
18 Por, unë enkas nuk kam kaluar, qëllimisht nuk kam kaluar deri
19 në fund të kësaj faqe pasi në fund të saj ka edhe një
20 nënshkrim tjetër.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
22 vendimi për këtë çështje do ta marrim më pas.

23 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, vetëm
25 për klasifikimin.

1 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
2 atëherë P01347 do të vijojë me klasifikimin konfidencial.
3 Faleminderit.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe ndoshta kjo mund të jetë edhe
5 një çështje me të cilën mund të fillojmë të paktën pas
6 pushimit, por U001 deri 2310 dhe U001 deri në 2319 e në mënyrë
7 të veçantë U001-2317.

8 PY. Dëshmitar, ndërkohë që këtë dokument do ta shfaqim në
9 ekran, në shkurt të vitit 1999, a keni marrë pjesë në një
10 trajnim për kandidatët e batalioneve të UÇK-së?

11 PË. Po, kam marrë pjesë edhe pse nuk kam qenë pjesë e planit,
12 por ka mungu një epror dhe unë e kam zëvendësuese. Fjala është
13 për Gëzim Hazrollin. Edhe nja dy orë mësimore unë i kam majt
14 me kandidatët për komandanta batalioni në shkurt të vitit 1999
15 në Nishor.

16 PY. A i njihni personat e tjerë të cilët kanë folur përpara
17 të njëjtit grup?

18 PË. Po zona operative e Pashtrikut ka qenë në atë kohë me
19 oficerë karriere disa, edhe një shumicë e tyre kanë dhënë
20 ligjërata në këtë trajnim. Tuj fillu prej komandantit të zonës
21 Ekrem Rexha, Sylejman Kollçaku e pastaj nëse s'gaboju ka qenë
22 edhe Sadit Halitjaha që ka mbajtur ligjërata, e të tjerë.

23 PY. Dhe Dëshmitar, përpara se të largohemi nga kjo faqe, këto
24 shënime janë nga biseda që ju keni dhënë ose nga leksioni që
25 ju keni dhënë?

1 Z. HALLING: [Përkthim] A mund të kalojmë pak më poshtë
2 për të parë emrin tuaj, ju lutem. Pra është U001-2317. Ky
3 është numri i duhur ERN, ndërkohë që duhet të kalojmë tek
4 anglishtja në një faqe tjetër. Faleminderit.
5 PY. Dëshmitar, po e bëj edhe një herë pyetjen time. Këto
6 shënime a janë nga leksioni që i keni bërë juve, që i keni
7 dhënë këtyre kandidatëve në 18 shkurt? Datën përkatëse që kemi
8 këtu të 1998?

9 PË. Në lidhje me specifikat e trajnimit unë e kam harru sa,
10 veç e di që kanë qenë pyetjet, dokumentat operative, por tash
11 a ka qenë kjo njësia jonë, nuk e di saktë. Nuk i -- përmbajtja
12 s'më kujtohet, por megjithatë unë i kam mbajtur dy orë mësimore
13 pikërisht në këtë problematikën e dokumentacionit ose
14 dokumenta operative.

15 PY. Në rregull. Dhe janë këto të njëjtat tema që diskutohen
16 në këtë faqe për të cilën ju folët?

17 PË. Po.

18 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mund të
19 mbarojmë me këtë dokument pas pushimit pasi vura re orën.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
21 Dëshmitar, do të bëjmë një pushim prej gjysmë ore në këtë
22 moment. Mund të bëni pak pushim. Ju lutem mos flisni me askënd
23 në lidhje me dëshminë që keni dhënë këtu në këtë sallë dhe do
24 të rishihemi pas gjysmë ore. Faleminderit.

25 DËSHMITARI: Faleminders.

1 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

2 Z. HALLING: [Përkthim] Nga ana e ZPS-së ne mendojmë që do
3 të mbarojmë në gjysmëorën e parë të seancës së radhës.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
5 shumë. Atëherë seanca shtyhet deri në orën 11.30.

6 Z. ELLIS: [Përkthim]

7 --- Pauza fillon në orën 11.02

8 --- Seanca rifillon në orën 11.30

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
10 uleni.

11 Ju lutemi sillni dëshmitarin në sallë.

12 [Dëshmitari vijon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë,
14 dëshmitar. Dëgjon mirë?

15 DËSHMITARI: Po, krejt --

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do vazhdojmë.
17 Ka ende pyetje z. Halling për ju.

18 Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit.

19 PY. Dëshmitar, do qëndrojmë te ky leksioni, te dokumenti që
20 diskutuam edhe para pushimit. Ju thatë që Ekrem Rexha, dhe
21 sipas teje edhe Sadik Halitjaha, folën gjatë këtij trajnimi.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Të shikojmë tani faqen U001-2311.

23 PY. Dëshmitar, shihni një emër këtu, Ekrem Rexha, lektor --
24 Ekrem Rexha, Drini, e shihni? E hënë, 15 shkurt e vitit 1999,
25 në krye të faqes?

1 PË. Po, po e shoh.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë te faqja U001-2314.

3 PY. Dëshmitar, cili është ky emri lart në të majtë të faqes,
4 e sheh?

5 PË. [Nuk ka përgjigje]

6 PY. Dëshmitar, e kuptove? Dëshironi ta përsërisim pyetjen?

7 PË. Unë s'di -- nuk po -- nuk i -- s'jam tu mujt me lexue.

8 PY. Tek anglishtja është shënuar Sadik dhe në viza të
9 pjerrëta "Alija -- Alijaha" këtu. Dhe thotë: "Raport ushtarak
10 -- marsi -- më falni, marsi luftarak i UÇK-së". A mos është ky
11 ai fjalimi i Sadik Halitjahas që përmendët ju më herët?

12 PË. Nuk e di detajet realisht. Ka të bëjë me dokumente që
13 s'janë të miat dhe mos m'i lini me interpretu dokumentet e
14 tjera. Veç unë e tregova, e di që as -- Sadik Halitjaha ka
15 mbajtur ligjëratë në -- këtyne kandidatëve për komandantë
16 batalioni. Por detaje të tjera s'jam, rrjedha -- se s'di.

17 PY. Mirë, se nëse ju kujtohet që ai ka mbajtur një ligjëratë
18 mjafton. Tani, të shohim materialin që ka numrin U001-2318. A
19 njihni një ushtar të UÇK-së me emrin Musli Kallolli [Sipas
20 përkthimit]?

21 PË. Musli Kololli, po.

22 PY. Musli Kollolli [Sipas përkthimit] çfarë zone -- çfarë, më
23 falni -- çfarë roli kishte në zonën e -- operative të
24 Pashtriikut në shkurt të vitit 1999?

25 PË. Musli Kololli në këtë fazë ka pas detyra në Brigadën 123,

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 53

1 e cila është afër [E pakuptueshme]. Komanda e saj ka qenë
2 shumë afër me zonën operative të Pashtrikut, edhe këto
3 ligjërata i ka mbajtu -- po nëse ka mbajtur ligjërata, për këtë
4 problematikë, ka mbajtur nga pozicioni i Brigadës 123.

5 PY. Po.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Anglishtja nuk i përkon shqipes.
7 Edhe një herë, bëhet fjalë për faqen me numër U001-2318. Duhet
8 të shihni faqen që ka emrin Musli Kololli në krye. Ja kjo
9 është, për këtë bëhet fjalë. Faleminderit.

10 PY. Në fillimet e luftës, Musli Kololli, a ka pasur ndonjë
11 funksion të zbulimit në Brigadën 123?

12 PË. Po. Fillimisht ka qenë i kyçur në Batalionin e Budakovës.
13 E, pjesën e dytë, prej domethënë, tetorit, unë atë e kam kyç
14 në kuadër të komandës së Brigadës 123. Dhe aty ka pas detyrën
15 e ndihmëskomandantit për zbulim dhe kundërzbulim.

16 PY. Titulli i ligjërates së tij ishte "Kriminalistika".
17 Kriminalistika ka qenë një nga temat e përfshira në trajnimet
18 e UÇK-së?

19 PË. Po për këtë trajnim specifik unë nuk e di planet. Unë
20 vetëm e di që e përmenda një -- dy orë mësimore, që e kam
21 zëvendësuar Gëzim Hazrollin dhe kam pas tema "Dokumentet
22 operative", dhe kam ba një shpjegim të shkurtë sa i përket
23 problematikës teorike të dokumenteve. Pastaj e kam lënë një
24 epuror tjetër për me i kry ushtrimet me kandidatët.

25 PY. Dëshmitar, s'e kam fjalën për këtë trajnim konkret. E kam

1 -- e kam më të përgjithshme, por po ta bëj edhe një herë.
2 Kriminalistika si temë, a ka qenë një temë që ishte pjesë e
3 trajnimeve të UÇK-së?
4 PË. Po, tash, secili [E pakuptueshme] në kuadër të punës së
5 vet, i ka dit detyrat. Unë për vete nuk i kam dit të gjitha
6 detyrat që janë në kuadër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
7 respektivisht të gjitha -- të gjitha specifikave që janë në
8 kuadër të Brigadës, prandaj edhe kur kërkohet dhe kur formohet
9 brigada, formohet ekipi i tanë. Nuk -- nuk është që njëri
10 mundet me i dit të gjitha. Tema që shtjellohet këtu, sipas
11 mendimit të, është temë që është zhvilluar vërtetë nga Musli
12 Kololli.

13 PY. Në rregull. Në të djathtë, në gjysmën e kësaj faqeje, ju
14 thatë që ky person kishte funksione të zbulimit. Po do shkojmë
15 më në të djathtë të faqes. Thuhet:

16 "Infor -- Informacion i mbledhur drejtpërdrejtë përmes
17 rrjetit të bashkëpunëtorëve."

18 "Informacion mund të jetë edhe keqinformim dhe duhet
19 verifikuar përmes rrjetit të bashkëpunëtorëve."

20 Bazuar në përvojën që kishit në armatën jugosllave, kjo
21 që është përshkruar këtu, a janë vërtetë detyrat që kryen
22 zbulimi gjatë një lufte?

23 PË. Po me thanë të drejtën, ka kalu aq shumë kohë, sa -- sa
24 edhe unë nuk -- nuk po mundem me e dit sa po -- besoj që po.
25 deri sa edhe pse këtu -- tash specifike për këtë që flet Musli

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 55

1 Kololli, kemi të bëjmë me problematikën e kriminalistikës në
2 aspektin e përgjithshëm se ai ka pas të kryme shkollën --
3 shkollën në -- e punëve të brendshme për polici. Prandaj këto
4 specifika i ka njoft e i ka dit mirë.
5 PY. Faleminderit.

6 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e nxorëm këtë
7 dokument përsëri sepse ne kërkuam që të pranohet prej mocionit
8 jogojor dhe nuk u pranua në vendimin F059 -- 051596 [Sipas
9 përkthimit] sepse na thanë që duhet të jepet konteksti përmes
10 një dëshmitari. Ne tani gjykojmë që e kemi dhënë këtë kontekst
11 përmes këtij dëshmitari, dhe kërkojmë që të pranohet sërish ky
12 dokument, me numër U001-2310 deri në U001-2319.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

14 Z. ELLIS: [Përkthim] E kundërshtojmë, kontekstualizimin
15 nuk qe i mjaftueshëm. Dëshmitari tha "Nuk është dokumenti im.
16 Nuk dëshiroj të komentoj për këto arsye se nuk është i imi",
17 edhe përmbajtja nuk është e mjaftueshme për të kuptuar
18 kontekstin.

19 Dëshmitari tha se njihte disa emra për shkak të
20 ligjëratave që kanë dhënë, por kaq.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tjetër?

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Sa i takon themelësisë, dëshmitari
23 gjatë seancës përgatitore ka thënë që nuk -- nuk e ka -- nuk
24 ka pasur dijeni që edhe Musë Kololli të ketë folur -- Kul --
25 Kolo -- Kololli të ketë folur në këtë trajnim.

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 56

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt,
2 është dhënë konteksti mjaftueshëm. Ai ka pasur dijeni për këtë
3 proces, kështu që do të pranohet, sepse përmbush standardin
4 *prima facie* të rregullës 138. Atëherë, numri i plotë i këtij
5 dokumenti është U001-2310 deri në U001-2319.

6 Jepini numrin përkatës.

7 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
8 materiali merr numrin P01348 dhe klasifikimi aktual është
9 konfidencial.

10 Z. HALLING: [Përkthim]

11 PY. Dëshmitar, është edhe një dokument tjetër që lidhet me
12 këto trajnimet.

13 Z. HALLING: [Përkthim] I lutem Sekretarit të Gjykatës të
14 nxjerrë në ekran materialin IT-05-87 P02459 [Sipas përkthimit]
15 dhe përkthimin në anglisht. Është një provë materiale e TPNJ-
16 së, e gjykitimit të Milutinovicit dhe të tjerëve. Shohim faqen 8
17 tek anglishtja, dhe faqen 6 te shqipja. Nëse ju ndihmon edhe
18 më tej, mund t'ju themi që numri i vulës të TPNJ-së mban
19 numrin K053-5468.

20 PY. Dëshmitar, presim të dali edhe anglishtja.

21 Dëshmitar, këtu del edhe emri juaj në fund. Dhe në krye
22 thotë "Plani i angazhimit të komandës së zonës operative të
23 Pashtrikut në ditën D", dhe thotë, "Suharekë, 20 shkurt të
24 vitit 1999".

25 Dëshmitar, e dini ju çfarë është ky dokument?

1 PË. Kemi të bëjmë me një dokument operativ parapërgatitor për
2 një angazhim të komandës në një situatë të caktuar, komandës
3 së zonës operative të Pashtrikut.

4 PY. A ka qenë ndonjë dokument përgatitor për ndonjë operacion
5 konkret?

6 PË. Jo. Është një dokument që mund me shërbye si model për
7 formimin e një dokumenti operativ. Jo, nuk është për rast
8 konkret. Prandaj edhe dokumenti është i panëshkruar. Është i
9 përgatitur, por jo i kompletum.

10 PY. Pra, me sa kuptoj unë, është më shumë një shabllon, apo
11 jo?

12 PË. Pikërisht, pikërisht.

13 PY. Në rregull. Shkojmë te faqja pararendëse dhe shohim
14 fundin e faqes pararendëse të paragrafit 16, ku thuhet dhe
15 "Ekrem Rexha". Në fund, "Komandant Ekrem Rexha". A ndihmuar --
16 a ka dhënë kontribut Ekrem Rexha për të përgatitur shabllone
17 të këtij lloji?

18 PË. Po, por realisht në kuadër të zonës, kemi bërë plot
19 dokumente që e përmenda. Është bërë një punë e madhe në kuadër
20 të zonës, edhe realisht që ka pasur të bëjë kryesisht me
21 përgatitjen e dokumentacioneve dhe dokumenteve operative.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Shohim pak më lartë, në faqen 4
23 tek anglishtja. Besoj që numri që i ka dhënë TPNJ-ja është
24 K053-5465 në shqip.

25 PY. Dëshmitar, a është edhe ky një shabllon?

1 "Komandantit ...

2 "Urdhër për sulm..."

3 PË. Është dokument operativ parapërgatitor që në rast se
4 ndodh ose ndërmirret diçka, të shërbejë si model për formimin
5 e urdhrit për sulm. Por nuk është urdhër, por është
6 "template", pra është një model.

7 PY. Shohim paragrafin 2, ku thotë:

8 "Njësitë tona të përbëra nga një pjesë e njërive të
9 brigadave 121, 122, 123, 124, 125, dhe policisë ushtarake të
10 Shtabit të Përgjithshëm, sulmojnë pozicionet e armikut në
11 Malishevë ..."

12 Kjo që sapo lexova, e ka - ku përmendet policia ushtarake
13 këtu, e Shtabit të Përgjithshëm, bëhet fjalë për të njëjtën
14 polici ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm që ke përmendur
15 edhe ti tek intervista?

16 PË. Këtu bëhet fjalë që përmendëm na për një dokument model,
17 edhe sipas specifikave mundet me qenë vetëm Brigada 121, ose
18 vetëm 121 dhe 122. Po në këtë rast janë specifiku të gjitha
19 njësitë që atë periudhës pak a shumë kanë ekszistuar. Kështu që
20 ky është edhe një herë sipas mendimit tëm, një material që
21 është model. Jo material që ka bazën që me e mbështet në
22 ndonjë veprim që është krye në bazë të këtij dokumenti.

23 PY. Faleminderit.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, besojmë se
25 referenca e policisë ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm në

1 një dokument shabllon, fakti që dëshmitari ka dhënë kontekstin
2 e këtij dokumenti dhe fakti që ka konfirmuar se një prej
3 dokumenteve të tij është pjesë e këtij grupi të dokumentesh,
4 përmbush kriteret për të pranuar dokumentin në fjalë. Dhe
5 kërkojmë që të pranohet dokumenti me numër IT-05-87 P2549
6 [Sipas përkthimit], si në anglisht ashtu edhe në shqip.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
8 kundërshtime?

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Jo.

10 Ekipet e Mbrojtjes nuk paraqesin kundërshtime.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti IT-
12 05-87 P2549 [Sipas përkthimit] pranohet. Ju lutem t'i jepni
13 numrin e provës materiale.

14 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Do t'i japim numrin e
15 provës materiale P01243 [Sipas përkthimit], me klasifikim
16 aktual konfidencial.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
18 ndryshim klasifikimi?

19 Z. HALLING: [Përkthim] Besoj që mund të klasifikohet si
20 publik.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
22 dokumenti klasifikohet si publik.

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] E marr parasysht.
24 Faleminderit.

25 Z. HALLING: [Përkthim]

1 PY. Dëshmitar, tani do të flasim pak më shumë për vitin 1999,
2 dhe zbulimin e UÇK-së. Ju gjatë seancës përgatitore, në
3 Shënimin Përgatitor numër 1, në paragrafin 24, thatë që nuk e
4 keni ditur konkretisht se çfarë ka bërë policia ushtarake e
5 UÇK-së, por ama ju e dinit se çfarë bënte policia ushtarake në
6 armatën jugosllave, çfarë funksioni kishte. Ju kujtohet kjo që
7 e diskutuam javën e kaluar?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe me sa keni kuptuar ju, si keni -- domethënë, mënyra
10 si i keni kuptuar ju funksionet e zbulimit të UÇK-së,
11 mbështeten në të njëjtën përvojë?

12 PË. Eh nuk e di, nuk e di, por megjithatë, kam mujt me pas
13 edhe ndryshime. Manej, numër i caktum i neve eprorëve
14 ushtarakë, që e kemi krye shkollimin në ish-armatën jugosllave
15 të -- praktikisht, ose shkollën në Jugosllavi, pak a shumë e
16 kemi pas një logjikë, dhe kryesisht jemi bazuar në modelin e
17 ushtrisë jugosllave. Kurse të tjerët, ndoshta që kanë pasur
18 literatura dhe janë ndiku nga literatura të tjera, kanë mujt
19 me pas ndoshta edhe ndonjë model tjetër.

20 PY. Kuptoj. Po dinit ju -- nga përvoja juaj ushtarake, ju e
21 dinit se çfarë funksioni kishte zbulimi në ish-armatën
22 jugosllave?

23 PË. Po, në një farë aspekti, ne gjatë shkollimit kemi pas
24 edhe lëndë që kanë të bëjnë -- që kanë pas të bëjnë me
25 bashkëpunëtorë me sektorin e zbulimit dhe kundërzbulimit,

1 lëndë shkollore në akademinë ushtarake.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Lutem që të vendoset në ekran
3 materiali U000-6462 deri në U000-6464, faqja e parë.

4 PY. Dëshmitar, ky dokument mban titullin "Shtabi i UÇK-së për
5 Prizren". Me sa kuptoj unë, ju këtë dokument nuk e kishit parë
6 më përpara ,por për herë të parë e keni parë javën e kaluar,
7 apo jo?

8 PË. Saktë.

9 PY. Këtu në krye flet për detyrat e komandantit. A është
10 përshkruar saktë, me aq sa keni ju dijeni, pra, a është
11 përshkruar saktë këtu komandanti i zonës së UÇK-së?

12 PË. Po, këtu shihet shumë qartë se ky material është
13 përgatitur nga dikush që pak a shumë nuk e ka pas përvojën e
14 eprorit ushtarak të ish-armatës jugosllave. Në terminologji
15 vërehet që ka specifika, po në princip është --

16 PY. Nuk e kam fjalën për përvojën e personit, por funksionet
17 që përshkruhen këtu, a janë përshkruar saktë për komandantin e
18 zonës?

19 PË. Po, për shkak të asaj, domethënë, një përshkrim më i
20 përafërt është por jo tërësisht i saktë. Po, në princip, po.

21 PY. Thatë që është në princip po jo tërësisht. Cila pjesë
22 këtu nuk është e saktë?

23 PË. Jo, nuk mundem me u lëshu unë në këto çështje se jam i
24 papërgatitur, realisht, dhe kujtesa ka bërë të vetën, 25 vjet.

25 Unë nuk jam marrë me këtë problematikë dhe realisht nuk mundem

1 me u lëshu unë në diskutim të këtyne dokumenteve.

2 PY. Dëshmitar, përshkrimi këtu, me aq sa keni ose me aq sa ju
3 kujtohet ju, a është i saktë?

4 PË. Në princip, e thamë, është.

5 PY. E njëjta pyetje vlen për shefin e operatives. Me aq sa ju
6 kujtohet ju, a është i saktë përshkrimi?

7 PË. Në princip edhe kjo është e saktë.

8 Z. HALLING: [Përkthim] Shkojmë në faqen tjetër.

9 PY. Dëshmitar, dua të shohim më konkretisht këtë që thotë
10 "Ndihmëskomandanti për zbulim dhe kundërzbulim" dhe thuhet:

11 "Ndihmëskomandanti për zbulim e kundërzbulim ka ndihmësit
12 e vet, dhe për detyrë zbulimin dhe kundërzbulimin. Merret me
13 zbulimin e forcave të armikut, numrin e tyre, përqendrimin e
14 stacionimin. Është i obliguar --

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më ngadalë e
16 lexoni.

17 Z. HALLING: [Përkthim]

18 PY. "Detyra e tij është të zbulojë qëllimet e armikut, numrin
19 e armatimit, dhe llojet e armatimeve. Zbulon bashkëpunëtorët e
20 armikut dhe për ata që kanë fakte të mjaftueshme se po
21 dëmtojnë çështjen kombëtare, përdor mënyra dhe metoda të
22 nevojshme. Ka për detyrë të kontrollojë dhe hulumtojë
23 pjesëtarët e UÇK-së mos ndonjëri po tradhton dhe bashkëpunon
24 me armikun, dhe jep sekrete ushtarake, pozitën.

25 Ka të drejtë të veprojë në nivel kompanie dhe për UÇK-në

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 63

1 në përgjithësi dhe çdo kërkesë ja bën - që i bën policia
2 ushtarake, duhet të zbatohet."
3 PY. Dëshmitar, me aq sa ju kujtohet, a është përshkruar saktë
4 këtu funksioni i ndihmës komandantit për zbulim e
5 kundërzbulim?
6 PË. Në princip është i përshkruar, po të thashë, a është i
7 saktë a ka mbet diçka pa u thanë, apo mos është diçka elemente
8 të vogla, nuk e di se përmenda, me të vërtetë ka kalu shumë
9 kohë dhe unë nuk mund të lëshohem në sp -- në çështje të
10 ekspertizës të saktë të kësaj problematike.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ne themi që
12 përshkrimi përputhet në parim me atë që kujton dëshmitari, ky
13 është një dokument i TPNJ-së që është sekuestruar nga
14 autoritetet serbe. Konkretisht ky dokument është marrë nga
15 MUP-i serb në Prizren, në vitin 1998, sepse këtu thuhet është
16 marrë nga zyrat e UÇK-së në Prizren. Pra sepse këtu thuhet UÇK
17 Prizren.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kundërshtime?

19 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Po, dokumenti [Sipas
20 përkthimit] tha që s'e ka parë asnjëherë më përpara këtë
21 dokument, dhe s'mund të japë dëshmi për diçka që s'i kujtohet.
22 Edhe ne parashtrojmë që, sidomos duke marrë parasysh
23 prejardhjen e këtij dokumenti dhe faktin që nuk e dimë kush
24 është autori, nuk ka themelësi për pranimin e këtij dokumenti.
25 Dhe gjithashtu, edhe e njëjta gjë ka ndodhur edhe me

1 dëshmitarin tjetër kur i është treguar ky dokument. Bëhet
2 fjalë për dëshmitarin W04765.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Kam edhe unë një pyetje për
4 themelësinë. A mund të na thotë Prokuroria çfarë deshtë të
5 thoshte që thuhet "Shtabi i UÇK-së, Prizren"? Cili njësit?

6 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk e dimë për cilin njësit bëhet
7 fjalë. Ne dimë vetëm atë që shohim në këtë dokument. Po ne
8 duam që t'i pyesim dëshmitarit të na përshkruante strukturën
9 edhe nuk jam dakord me atë që tha Mbrojtja e Veselit, që ky
10 dëshmitar nuk është në gjendje që ta kontradiktojë atë
11 informacion. Ne mendojmë që informacioni që na ka dhënë në
12 bazë të kualifikimeve që ka, është i mjaftueshëm.

13 Z. MISETIC: [Përkthim] Po ne e kundërshtojmë. Nëse
14 Prokuroria thotë unë s'jam në gjendje t'ju them për cilin
15 njësit bëhet fjalë, apo cili UÇK -- për cilën shtab të UÇK-së
16 në Prizren, atëherë nuk jam dakord.

17 Z. ELLIS: [Përkthim] Pajtohemi edhe ne, i nderuar
18 Gjykatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj, në
20 fakt. Ne do ta pranojmë dokumentin, por do ta rishikojmë edhe
21 një herë kur të vijë puna për t'i dhënë peshën kryesore këtij
22 dokumenti.

23 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, U000-6462
24 deri në U000-6464, si në shqip ashtu edhe në anglisht, do t'i
25 jepet numri i provës P01350. Për momentin e klasifikuar si

1 konfidenciale. Faleminderit.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Dokumentin e radhës që dëshirojmë
4 të shfaqet në ekran quhet SPOE00226622 dhe është një faqe e
5 vetme.

6 PY. Dëshmitar, tani do t'ju tregoj disa gjëra që u diskutuan
7 në seancën përgatitore, dhe do t'ju bëj edhe disa pyetje të
8 tjera.

9 Dhe, Dëshmitar, meqenëse po presim që të shikojmë në
10 ekran dokumentin në anglisht, a mund të konfirmoni që përpara
11 seancës përgatitore ju nuk e kishit parë këtë dokument?

12 PË. Këtë dokument e kam parë për herë të parë para juve në
13 javën që shkoi.

14 PY. Po. Pyetjet që kam janë këto: Që dëshirojmë që të ndajmë
15 personat me pozicione të caktuara nga akuzimet që jepen në to.
16 Personat dhe titujt që ata kanë, janë të sakta që në fakt ata
17 kanë ato pozicione që jepen në këtë dokument?

18 PË. Eh kryesisht, edhe pse kur bëhet fjalë te Blerim Kuqi,
19 nuk është komandant i togës, por është komandant i kompanisë.
20 Kjo është kompani, vëzhguese, diversante, jo togë. Të tjerat
21 në princip përputhen.

22 PY. Nga këto pozicione që janë vënë në listë, që kur i bie
23 atëherë që të jetë bërë, të jetë përpiluar kjo listë?

24 PË. Duhet me qenë në janar të vitit 1999, sipas të gjitha
25 gjasave, se në këtë periudhë, po flas unë për veti, kam qenë

1 në zonën operative të Pashtrikut. Edhe pse këtu emërtimi
2 shkruan "shefi i operativës në zonën operative të Pashtrikut",
3 detyra ima ke qenë shef shtabi, jo shefi i operativës. Pra, ka
4 pasaktësi në emërtime, po kryesisht, në princip është q'kjo.

5 PY. Dhe tani tek akuza që bëhet, që:

6 "Kurtesh Fondaj ka luajtur rol në shpartallimin e UÇK-së
7 në zonën e Suharekës."

8 Së pari, kjo akuzë që bëhet, a është e vërtetë? Cili
9 është komenti juaj në lidhje me të?

10 PË. Po, unë nuk jam hy në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës që
11 ta dëmtoj atë, por përkundrazi, ta jap më të mirën të
12 mundshme. Vetëm rrethana po e përmendni, se unë realisht nuk
13 kam vepru me nofkë, kam vepru me emër e mbiemër, edhe kam qenë
14 shumë i vetëdijshëm për pasojat që mund t'i bart në rast se
15 dështon Ushtria Çlirimtare e Kosovës. Unë e kam besu
16 fuqimishëm në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, dhe jam mundu me
17 dhanë më të mirën të mundshme.

18 Edhe -- mirëpo ne e kemi një shprehje, themi "edhe dielli
19 nuk nxeh për të gjithë njësoj". Prandaj, në kontekst të saj, a
20 ka pas dikush që ka dhanë vërejtje në punën teme, po krejt
21 është normale. Mirëpo, misioni jem nuk ka qenë me shkatërru
22 UÇK-në, por me e fuqizu atë, edhe me dhanë kontributin më të
23 mirë të mundshëm.

24 PY. Atëherë, ju kuptoj. Nuk jeni dakord, atëherë me këtë që
25 thuhet këtu që keni luajtur rol në shpartallimin e UÇK-së në

1 Suharekë. Është e vërtetë kjo? Është e saktë?

2 PË. E saktë që nuk kam luajtur rol.

3 PY. Ju jeni akuzuar ndonjëherë për ndonjë gjë të tillë gjatë
4 luftës?

5 PË. Eh, me sa di unë, zyrtarisht jo.

6 PY. Po atëherë jo zyrtarisht?

7 PË. Po zyrtarisht -- jo zyrtarisht po del që po, një prej
8 atyne -- e ua kam dhanë edhe unë një dokument që është që po.
9 Mirëpo jo zyrtarisht nuk jam -- nuk kam pas vërejtje. Pra në
10 mënyrë zyrtare nuk kam pas vërejtje. Përkundrazi, kam pas edhe
11 lëvdata.

12 PY. Po. Dëshiroj të përqendrohem te përgjigja që ju dhatë.
13 Njëri prej tyre është një dokument që tregon që ashtu është. A
14 mund të më shpjegoni pak dokumentin për të cilin bëhet fjalë
15 te kjo fjali që ju sapo na thatë?

16 PË. Po, bëhet fjalë për një dokument që ka përgatitur Halil
17 Qadraku bashkë me Sadik Halitjahan.

18 PY. Cili ishte roli i Halit Qadrakut te UÇK-ja në fillim të
19 vitit 1999?

20 PË. Në nivel të zonës operative të Pashtrikut, detyra ka -- e
21 tij ka qenë eh, e -- përgjegjës për sektorin -- në sektorin e
22 zbulim dhe kundërzbulim.

23 PY. Njihet edhe si Shërbimi i Inteligjencës Informativ? E
24 njëjta fjalë për të?

25 PË. Nuk i di tash këto realisht edhe unë kuptimin -- unë në

1 fazën kur kam qenë shef shtabi, ne e kemi titullue si zbulim
2 dhe kundërzbulim.

3 PY. Në terminologjinë e gjuhës shqipe ushtarake, si quhet
4 shërbimi i zbulim-kundërzbulimit?

5 PË. Po nuk e di, e nëse s'gaboju, në Shqipëri e quajnë edhe
6 shërbimi inteligjent, por nuk -- nuk jam i sigurt. Ndoshta
7 gaboju, se s' -- me të vërtetë nuk s'jam marrë me këtë
8 problematikë fare më, me përfundim të luftës.

9 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, nëse mund ta
10 sqarojmë me paragrafin e caktuar të shënimi të përgatitjes.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, mund të
12 vijoni.

13 Z. HALLING: [Përkthim]

14 PY. Atëherë, Dëshmitar, në seancën përgatitore ju keni thënë:

15 "Halil Qadraku ishte në krye të shërbimit të
16 inteligjencës, që ndryshe njihet si zbulim-kundërzbulimi,
17 ndërkohë që në terminologjinë në gjuhën shqipe njihet edhe
18 'shërbimi hetimor'."

19 A është e saktë kjo? Informativ.

20 PË. Po në princip mundet me thanë që po.

21 PY. Okej.

22 Z. HALLING: [Përkthim] Atëherë dokumenti i radhës është
23 SPOE00227 deri në SPOE002277, faqja e parë, dhe 227682 është
24 faqja e fundit, dhe do të fillojmë në faqen SPOE00227678.

25 ZNJ. O'REILLY: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mund të

1 ketë një gabim në transkriptim, që me fjalën "hetim". Dhe po
2 të ndjekim Shënimin numër 2, duhet të jetë "informacion" dhe
3 jo hetim.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Po, Mbrojtja ka të drejtë, dhe unë
5 prandaj thashë "informacion".

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Edhe një herë faqja është
8 SPOE00227678 edhe në anglisht.

9 PY. Atëherë, Dëshmitar, me këtë faqe dëshirojmë t'ju
10 orientojmë. Thuhet pra që është një takim i Shtabit të
11 Përgjithshëm të UÇK-së në janar të vitit 1999 në Divjakë. Po
12 të kalojmë te faqja tjetër thuhet si më poshtë vijon:

13 "Kurtesh Fondaj thotë: Nuk ka çka lypim këtu ... gjarpna.
14 Ne njohim vetëm B. Zyrapin!"

15 E shihni këtë në ekran?

16 PË. Po, po e shoh.

17 PY. A është kjo diçka që e keni thënë ju ndonjëherë?

18 PË. Nuk besoj. Për mua, realisht, anëtarët e Shtabit të
19 Përgjithshëm kanë qenë njerëz autoritet -- domethënë te unë
20 shumë të respektum, pra njerëz të respektum, dhe unë i kam --
21 jam mundue me qenë shumë korrekt. Po edhe kam bindjen se edhe
22 ata kanë qenë shumë korrekt në raport me mu, dhe nuk është në
23 stilin, në natyrën teme me fol në këtë fjalor.

24 PY. Dhe këtu është përfshirë edhe respektimi i autoritetit të
25 Hashim Thaçit?

1 PË. E kjo -- realisht kjo fjali është skandaloze.

2 PY. Faleminderit.

3 Z. HALLING: [Përkthim] Dokumenti tjetër është dokumenti
4 SPOE00226730 deri në SPOE00226746, dhe në mënyrë më konkrete,
5 faqja SPOE00226741.

6 PY. Dëshmitar, në këtë faqe, në krye të saj kemi diçka të
7 ngjashme me atë që dëgjuam më parë, kur thash:

8 "Kurtesh Fondaj ... e prapë

9 "'10-shat' dhe 'gjarpri' diçka e vështirë për të lexuar.
10 Deklaron H. Paçarizi."

11 A e njihni ndokënd me emrin Paçarizi [Sipas përkthimit]?

12 PË. Po, e njoh dhe po më duket dokumenti që e shfaqët
13 paraprakisht buron prej q'kësaj. Domethënë, nuk ka dy
14 dokumente këtu, por është praktikisht si burim qe ky. Habib
15 Paçarizi ka qenë në sektorin e zbulimit dhe kundërzbulimit në
16 Brigadën 122, në periudhën e janarit të vitit 1999.

17 PY. Dhe po të kalojmë te faqja tjetër, do të shikojmë që
18 flitet për një takim dhe është i përkthyer në gjuhën angleze,
19 si Halil Paqarizi. Ky Halil Habib Paqarizi është ai që
20 diskutohet këtu. A mund të na tregoni?

21 PË. Po, po, pikërisht është për të njëjtin Habib, jo Halil.

22 PY. A mund të na thoni se pse dikush nga zbulimi i UÇK-së
23 mund të bëjë një deklaratë të tillë për ju?

24 PË. Jo, jo, s'mund ta them, se nuk e di.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe tani kërkoj që të kalojmë te

1 një dokument tjetër, P5000, që është SITF00021875 deri në
2 SITF00021876, dhe të kalojmë te pjesa e fundit e faqes së
3 parë.

4 PY. Dëshmitar, në fund të kësaj faqeje flitet për:

5 "... një rast tjetër ku fliten për të gjithë anomalitë që
6 ka pasur Kurtesh Fondaj dhe të gjithë vërejtjet që i janë
7 dhënë nga komandanti i togës, komandanti i brigadës, shefi i
8 operativës dhe në Shtabin e Përgjithshëm, që do të thotë që ju
9 nuk ishit i përshtatshëm për UÇK-në dhe keni qenë i mirë për
10 FARK-istët."

11 A është ky pretendimi që ka pasur për ju pikërisht që
12 është bërë më parë dhe që e shpjeguem edhe më parë nga Halil
13 Qadraku?

14 PË. Po në këtë dokument që përpilon Halil Qadraku dhe që
15 figuron edhe emri i Sadik Halitjahas, pikërisht kjo bëhet
16 fjalë. Mirëpo, me këtë rast unë kisha dasht vetëm me thanë
17 edhe një fjali, se FARK në territor të Kosovës nuk ka pas. Jam
18 i sigurt. Pra, pjesa e ushtarëve që kanë qenë fillimisht nën
19 Ministri të Mbrojtjes në territorin e Kosovës kanë vepru me
20 emblemën e UÇK-së dhe kanë qenë nën komandën e Shtabit të
21 Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

22 PY. Në rregull. Dhe tani të kalojmë te një pjesë e deklaratës
23 suaj, dëshmisë.

24 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe këtu në fakt, kemi numrin
25 P1327.6 dhe janë faqet 17 dhe 18 të saj në gjuhën angleze dhe

1 18 dhe 19 në gjuhën shqipe.

2 PY. Dëshmitar, dëshiroj që t'ju tregoj një pjesë të
3 intervistës suaj me ZPS-në, në të cilën ju keni folur për
4 Halil Qadrakun dhe raportimet e tij në mënyrë më specifike.
5 Dhe natyrisht, me ndihmën e Sekretarit të seancës, do të
6 kalojmë te një faqe specifike e saj.

7 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kuptoj që
8 orarin që kemi por nëse është e mundur që të vijojmë edhe 10
9 minuta të tjera.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, vazhdoni.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Okej, në faqen 17 ju lutem, te
12 versioni në anglisht dhe duhet të fillojë "Te kush
13 raportonte", pra mund të kalojmë në fund të faqes, ju lutem?
14 Aty, ja ku është.

15 PY. Pra, Dëshmitar, aty thuhet:

16 "Kujt i jepte llogari? Në organizime në ushtarak?"

17 Dhe ju përgjigjeni, gjithmonë për Halil Qadrakun:

18 "Sipas vijës komanduese, është dasht me iu referu Ekrem
19 Rexhës, por e vërteta është që ai e ka pasur raportu në
20 sektorin në Shtab të Përgjithshëm me Kadri Veselin."

21 "Në nivelin e Shtabit të Përgjithshëm ky Kadri Veseli ka
22 qenë drejtuesi pastaj?"

23 "Po, po."

24 "Dhe a jemi dakord me faktin që ky zotëri në vend që të
25 ndjekë atë rrugë, strukturën e duhur të komandës, ai shkonte

1 drejtpërsëdrejti në Shtabin e Përgjithshëm. Është kështu?"

2 "Po, dhe mendoj që kjo vinte për shkak të mungesës së
3 njohurive. Ndoshta diçka tjetër, por për mendimin tim, ka qenë
4 për arsye se nuk e dinte se duhet të raportonte te komandanti.
5 Dhe për këtë arsye ka shkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë te
6 Shtabi i Përgjithshëm."

7 Dëshmitar, së pari, a është e saktë nga intervista që i
8 keni dhënë ZPS-së?

9 PË. Po.

10 PY. Atëherë, ju keni thënë që Halil Qadraku kishte mungesë
11 njohurie, nuk kishte njohuritë e duhura për raportimin e
12 duhur. Po Ekrem Rexha i ka treguar ndonjëherë Halil Qadrakut
13 se si të raportonte në mënyrën e duhur?

14 PË. Ekrem Rexha ka pas disa ankesa nga komandantët e
15 brigadave në interferim të punës së Halil Qadrakut, për sa i
16 përket sektorit të zbulimit dhe kundërzbulimit në nivel të
17 brigadave. Dhe Ekrem Rexha ja ka tërheq vërejtjen Halit
18 Qadrakut, duke i thanë që ti mundesh me shku dhe me u
19 konsultue dhe me dhanë këshilla, me marrë informacion nga
20 punëtorët, respektivisht, shefat, respektivisht, të zbulimit
21 dhe kundërzbulimit nëpër brigada, por duhet ta kesh një
22 urdhëresë nga unë. Respektivisht, me q'atë urdhnesë me ty leju
23 ty nga komandantët e brigadave që ta krysh punën tënde. Pra ti
24 duhet me ju lajmëru komandantëve të brigadave, dhe pastaj me
25 kry punën. E, atij kjo ju ka duk se Ekrem Rexha në këtë formë

1 po don me e blloku punën e sektorit të zbulimit dhe
2 kundërzbulimit. Prandaj ai -- unë erdha deri një lloj
3 konkludimi se Halil Qadraku nuk është tuj i dit punën edhe
4 përgjegjësitë që ai ka. Pra, kjo është në esencë pak a shumë,
5 shkurt për këtë problematikë.

6 PY. Këto gjëra që na shpjeguat për Ekrem Rexhën, a është kjo
7 mënyra e duhur e raportimit në një ushtri, duke u bazuar te
8 përvoja e armatës suaj -- armatës jugosllave tuaj?

9 PË. Po gjithsesi, komandanti është komandant. Ai duhet t'i
10 dijë të gjitha. Ai kur i shkon një informacion, për shembull,
11 i zbulimit dhe i kundërzbulimit, sikur që u përmendën që në
12 mesin e tyre duhet të zbulohen pozicionet e armikut, ai duhej
13 t'i referohej komandantit, jo dikujt në ndonjë sektori tjetër
14 jashtë njësisë së tij.

15 PY. Gjithashtu, ju keni thënë që Ekrem Rexha e ka
16 paralajmëruar Halil Qadrakun, për sa i përket mënyrës së duhur
17 të raportimit. Ju a e keni parë vetë këtë paralajmërim që i ka
18 dhënë ai atij?

19 PË. Në fazën e janarit dhe shkurtit, ne kemi pasur takime të
20 rregullta në bazë ditore. I kemi quajtur takime të shkurtra,
21 ça breafing, dhe na në njërin prej atyre takimeve, mos me
22 thanë edhe ndoshta ka mujt edhe me u përsërit edhe dy - tre
23 herë, po në njërin prej takimeve është zhvillu biseda për të
24 cilën fola më parë.

25 PY. Pasi ndodhën këto biseda, Halil Qadraku, a vazhdoi të

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 75

1 raportonte në mënyrën që nuk ishte e duhur, pra edhe më pas?

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, por ndërkohë që
3 lexoj transkriptimin, dëshmitari pra ka thënë që Jahaja [Sipas
4 përkthimit] dhe Qadraku kanë marrë informacion nga brigadat.
5 Asgjë për raportimet.

6 Z. HALLING: [Përkthim]

7 PY. Dëshmitar, ajo që po bënte Halil Qadraku, pra raportimi
8 në Shtabin e Përgjithshëm, duke anashkaluar Ekrem Rexhën?

9 PË. Zoti Prokuror, realisht këtë që e përmendi Avokati
10 Mbrojtës, ka të drejtë. Fjalë -- vërejtjet në Halil Qadrakun
11 janë dhënë nga komandantët e brigadave dhe ajo ka qenë ajo që
12 është potencue, dhe që i është thënë Halilit. Kurse raportimet
13 në nivel ma nalt, nëse ai ka dhanë -- s'ka pas si me pas
14 informacion Ekrem Rexha. Edhe realisht që ky dokumenti që ne i
15 kemi dhënë ka të bëjë me të, mbasi e kemi përfundu gati punën,
16 unë në zonë. Respektivisht Ekrem Rexha veç ka qenë përfundim.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe, të nderuar, me këtë
18 dëshirojmë që të sqarojmë paragrafin 45 të Shënimit Përgatitor
19 numër 2.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
21 vazhdoni.

22 Z. HALLING: [Përkthim]

23 PY. Atëherë, Dëshmitar, ja çfarë është thënë në seancën
24 përgatitore, që:

25 "Ishte Ekrem Rexha që kishte të drejtë në procedura --

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 76

1 për sa i përket procedurave të duhura ushtarake për
2 raportimin. Ne ishim të pranishëm në takimet me komandantët e
3 zonave kur Ekrem Rexha i ka thënë Qadrakut se si duhet të
4 raportonte. I ka treguar, por Qadraku vazhdoi të raportonte në
5 mënyrë të drejtpërdrejtë te YKY-ja në brigada, dhe raportonte
6 drejtpërdrejtë te Shtabi i Përgjithshëm edhe pasi Ekrem Rexha
7 i ka thënë Halil Qadrakut që mos ta bënte këtë gjë.”

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përpara se të përgjigjet
9 dëshmitari, është në fakt edhe shënimi i z. Halling, i këtij
10 takimi, dhe është z. Halling gjatë këtyre pyetjeve dhe
11 përgjigjeve që ka ngatërruar raportimin me përdorimin e fjalës
12 raportim me informacion të marrë nga vijat e mëposhtme dhe
13 informacion të mëtejshëm. Por do të isha i kënaqur që të
14 dëgjonim nga dëshmitari vetë, për sa kujton ai në bazë të
15 kësaj bisede, por pyetjet duhet t'i bëhen atij në lidhje me
16 këtë çështje.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar, dëshmitari e ka
18 treguar javën e shkuar saktësinë e kësaj gjëje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po mund të
20 vijoni.

21 Z. HALLING: [Përkthim]

22 PY. Dëshmitar, atëherë këto gjëra që ju kam lexuar deri tani,
23 a janë të sakta?

24 PË. Z. Prokuror, realisht, tuj e pas parasysh ngarkesën dhe
25 materialet që unë kam pas brenda javës në dorë, realisht kam

1 mujt me u përvjedh çështjeve të terminologjisë që po e
2 përmendim: raportim dhe komunikim, ose marrje të
3 informacionit. Kështu që, nuk kisha pas qejf me u lidh për një
4 fjalë, nëse e kam thanë gabim.

5 Çdo herë është mendu më tepër në komunikim me brigadat jo
6 në raport me komunikimin me Shtabin e Përgjithshëm.

7 PY. Atëherë, Dëshmitar, pyetja ime për ju atëherë është: Pse
8 thatë ju që Halil Qadraku vazhdoi të raportonte
9 drejtpërsëdrejti te stafi i përgj -- te Shtabi i Përgjithshëm?
10 Pse e thatë këtë gjë në seancën përgatitore?

11 PË. Në seancën përgatitore unë jam bazuar në dokumentin të
12 cilin ai e ka përcjellë, që diku mban, nëse s'gabo, datën 16
13 mars. E në atë periudhë, unë as që kam qenë në zonën operative
14 të Pashtrikut. Në të -- domethënë, q' ai ka qenë një farë baze
15 me mendu se ai edhe e ka komunikuar në vijën -- domethënë me
16 Shtabin e Përgjithshëm, vertikale, pa dijeni të Ekrem Rexhës.

17 Por, edhe një herë po e përmend, në atë fazë unë nuk kam
18 qenë në zonën operative të Pashtrikut.

19 PY. A është e saktë nga dokumenti, në të cilin ka shkruar për
20 ju Halil Qadraku, që ai nuk kishte besim te ju?

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe kjo është një pyetje të
22 cilës nuk mund t' i përgjigjet dëshmitari.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk e di cila
24 është baza mbi të cilën ju e bazoni, pra, këtë pyetje, ku --
25 nga ku vjen ky informacion. Diçka që e ka dëgjuar, e ka

1 lexuar.

2 Z. HALLING: [Përkthim] Është e bazuar në diçka që është
3 me shkrim.

4 PY. Atëherë, Dëshmitar, në letrën që ju kemi treguar nga
5 Halil Qadraku, ju a kuptuat, nga ç'ka ishte shkruar për ju,
6 nëse ai kishte besim te ju, ose nuk kishte besim te ju?

7 PË. Zoti Prokuror, në atë letër nuk është vetëm emri im.
8 Është emri i një numri të konsiderueshëm të eprorëve
9 ushtarakë. Sidomos të Brigadës 123. Por, pavarësisht asaj, nuk
10 du me spiku -- me spekulu që ai ka pas diçka, një pretendim të
11 caktum. Unë edhe një herë po e përmend, po kthehem që ato që i
12 thashë edhe më herët, Halil Qadraku nuk e ka dit punën dhe
13 përgjegjësinë që i ka pas.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Dhe me këto fjalë kërkojmë që të
15 sqarohet me paragrafin 44 të notës -- të Shënimit Përgatitor
16 numër 2.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
18 vijoni.

19 Z. HALLING: [Përkthim]

20 PY. Atëherë, Dëshmitar, ju thatë që:

21 "Duke u bazuar te ajo që kishe shkruar Qadraku në letrën
22 e tij, Halil Qadraku nuk kishte besim te Drini, te ju, apo te
23 ndonjë nga oficerët e tjerë."

24 Dëshmitar, a është e vërtetë kjo? Sup -- eprorët -- a
25 është e vërtetë kjo?

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Halling

Faqe 79

1 PË. Po, s'muj me thanë unë që ka pas ose s'ka pas besim. Ai
2 ka pas vërejtje në punën tonë. Këto shihet prej dokumentit. A
3 çështja e besimit, unë s'e di.

4 PY. Me këto paralajmërime që ju i shpjegoni që ju i keni parë
5 personalisht nga Ekrem Rexha, Halil Qadraku a e ndryshoi
6 sjelljen e tij pas këtyre paralajmërimeve që i dha Rexha?

7 PË. Nuk e di, nuk e di.

8 PY. Dëshmitar, ju thatë që nuk e dini nëse Halil Qadraku i ka
9 raportuar apo jo Shtabit të Përgjithshëm. Pra, këtë po thoni
10 tani?

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Është shtrembërim i dëshmisë kjo.
12 Dëshmitari sapo tha që me sa ka kuptuar ai, Halil Qadraku i
13 raportonte Shtabit të Përgjithshëm dhe këtë e ka bazuar në një
14 dokument të vetëm.

15 Z. HALLING: [Përkthim] Ky është një kundërshtim i pabazë.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim] Lexo transkriptimin.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
18 herë tjetër, çohuni dhe bëjeni kundërshtimin. Mos bëni
19 shpjegimin në sy të dëshmitarit. Nëse doni të bëni
20 parashtrime, do të duhet të nxjerrim dëshmitarin nga salla.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kam ndërmend të bëj
22 parashtrime, por po them që shtrembëroi atë që sapo tha
23 dëshmitari dy minuta më përpara. E shohim që në transkriptim
24 po deshët.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet,

1 vazhdoni.

2 Z. HALLING: [Përkthim]

3 PY. Dëshmitar, të sqarojmë atë që po thoni. Pra, pyetja ime
4 është kjo: A po na thoni ju tani që nuk e dini nëse i ka
5 raportuar Shtabit të Përgjithshëm Halil Qadraku?

6 PË. Jo, bre, nuk e di. Ai realisht një shkresë e ka ba në
7 Shtabin e Përgjithshëm, q'atë shkresën të cilën - të cilën ju
8 e keni si provë. Mirëpo, a ka raportu a si ka raportu, unë nuk
9 e di.

10 PY. Dëshmitar, në intervistën për ZPS-në, ju thatë që:

11 "Normalisht duhet t'i raportonte Ekrem Rexhës. Por ama në
12 të vërtetë, ai kishte kontakte me Kadri Veselin në Shtabit të
13 Përgjithshëm."

14 Kjo është e vërtetë, apo jo?

15 PË. Zotëri, për që ka dasht me iu referue, respektivisht me i
16 raportue Ekrem Rexhës, atë e kam thënë. Edhe fakte ai ka pas
17 mundësi me çështje me komuniku edhe në nivel me Shtabin e
18 Përgjithshëm. Se Shtabi i Përgjithshëm pak a shumë ka mujt me
19 dhanë edhe këshilla profesionale. Mirëpo, çdo herë Ekrem Rexha
20 është thënë që kur të komunikon, qoftë në vijë lartë ose
21 poshtë, duhet komunikimi të shkojë përmes tij, si komandant, e
22 jo të realizohet, ose të bëhet drejtpërdrejtë. Kurse, tash,
23 për punën e tij unë s'muj me fol kurrëgjë tjetër hiç, veç me
24 tregu se q'atë dokument mu më ka ra në dorë, edhe q'atë
25 dokument unë juve ua kam sjellë.

1 Sa i përket fjalës -- sa kemi -- sa i përket asaj që ka
2 të bëjë me Halil Qadrakun.

3 PY. Faleminderit.

4 Z. HALLING: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mendoj që u
5 sqarua mjaftueshëm tani.

6 Ka edhe tre materiale të tjera që dua të pranohen te
7 provat gjyqësore, në të cilat ilustruhet sipas nesh niveli i
8 lartë i mosbesimit që kishin një pjesë e UÇK-së përkundrejt
9 ushtarëve profesionistë të UÇK-së, që përpiqeshin të ndiqnin
10 rregullat, dhe paralelisht kishte persona apo ushtarë që i
11 anashkalonin këto rregulla. Edhe --

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Po e kundërshtoj -- po e
13 kundërshtoj këtë parashtrim në praninë e dëshmitarit. Nuk i
14 takon dëshmitarit të dëgjojë çfarë është e rëndësishme, çfarë
15 nuk është e rëndësishme. Çfarë po përpiqet të thotë Prokurori
16 në sy të dëshmitarit.

17 Z. HALLING: [Përkthim] Po përpiqem të flas për vlerën
18 provuese që kanë materiale që dua të pranohen.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Thashë që nuk duhet bërë në prani
20 të dëshmitarit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar].

22 Z. HALLING: [Përkthim] Sa i takon akuzave për Shtabin e
23 Përgjithshëm, jo vetëm që materiali me numër SPOE00227677 deri
24 në 227682 pretendon se ka shënime të takimit të Shtabit të
25 Përgjithshëm në Divjakë më 5 janar të vitit 1999, materiali

1 është sekuestruar prej Jakup Krasniqit, dhe dy dokumentet e
2 tjera, përkatësisht me numër SPOE00226622 dhe dokumenti i
3 fundit me numër SPOE00226730 deri në 226746 janë sekuestruar
4 prej Rexhep Selimit.

5 Dhe mbi bazat që sapo citova, kërkoj që të pranohen të
6 tre dokumentet si pjesë e provave gjyqësore.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dokumenti i
8 parë me numër U006462?

9 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, ky është trajtuar më përpara.
10 Po ua them edhe një herë.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Prisni një
12 çast ju lutem.

13 Në rregull, vazhdoni.

14 Z. HALLING: [Përkthim] Pra bëhet fjalë për dokumentin me
15 numër SPOE0022677 dhe faqja e fundit është 6627822. Më pas
16 është dokumenti SPOE00226622 dhe dokumenti SPOE00226730 në --
17 deri në 226746 që -- të cilët ka qenë dokumenti i parë dhe i
18 tretë në rendin përkatës.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani mund të
20 paraqisni kundërshtimet.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Po, kam komente lidhur me shënimet
22 dhe mënyrën se si u paraqitën këto dokumente, por nuk dua që
23 t'i trajtoj në prani të dëshmitarit. Nuk e kam kundërshtimin
24 te dokumenti, por te mënyra se si kërkohet që të pranohen.

25 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk kam ndonjë kundërshtim

1 konkret. Një pjesë e madhe e këtyre materialeve nuk e kam
2 burimin. Nuk e dimë as prejardhjen, kështu që peshën e kanë
3 shumë të pakët. Megjithatë, unë uroj që ta keni parasysh, të
4 nderuar Gjykatës, dhe nuk e kundërshtojmë.

5 Z. ELLIS: [Përkthim] Ne kundërshtojmë dokumentin e parë
6 që është marrë gjatë një kontrolli. Këto janë dokumente që
7 dokument -- që dëshmitari as i ka parë ndonjëherë më përpara,
8 as nuk ka arritur të na thotë ku e -- kush është burimi i
9 tyre, kështu që s'mund të thotë Prokuroria që është përmbushur
10 standardi. Mbase mund të kenë një dëshmitar tjetër që është në
11 gjendje të na thotë cili është burimi i dokumentit, dhe në
12 mënyrë të tillë të pranohen.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Trupi Gjykses
14 vlerëson se dokumenti me numër SPOE002266 -- 2622,
15 SPOE002267677 deri në 227688 dhe SPOE00226730 deri në 226746 -
16 - i kam numrat siç duhet?

17 Në rregull, pranohen sepse kanë përmbushur -- e
18 përmbushin kriterin e *prima facie* të rregullës 138, të
19 Rregullores sonë.

20 Vazhdoni.

21 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Materiali SPOE0022622
22 [Sipas përkthimit] deri në SPOE0022622 [Sipas përkthimit] në
23 shqip dhe në anglisht merr numrin e provës materiale P01351
24 dhe klasifikimin aktual e kanë konfidencial.

25 Materiali SPOE002227677 [Sipas përkthimit] deri në 226822

1 merr numrin e provës materiale P01352.

2 Ndërsa SPOE00226730 deri në 226746 dhe në shqip, dhe në
3 anglisht, marrin numrin e provës materiale P01352. Më falni,
4 edhe një herë: P01353, dhe e ka klasifikimin konfidencial.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund t'i
6 riklasifikojmë?

7 Z. HALLING: [Përkthim] Jo, për këto dokumente do luteshim
8 që të ruanin klasifikimin konfidencial sepse janë materiale të
9 sekuestruara.

10 Unë nuk kam më dokumente që të pranohen, por kam disa
11 pyetje të fundit.

12 PY. Dëshmitar, tani duam të flasim pak për kohën që keni
13 kaluar në shkollën ushtarake të UÇK-së. A ju është dhënë
14 urdhër ju që të shkonit dhe të punonit në shkollën ushtarake?

15 PË. Eh, bëjmë -- bëhet fjalë në fund të prillit të vitit
16 1999, kur Agim Çeku e merr detyrën e shefit të Shtabit. Ai
17 realisht i komunikon urdhrin Ekrem Rexhës për komandant zone -
18 - komandanti i qendrës shkollë ushtarake dhe më -- si
19 zëvendëskomandanti i tijna. Domethënë, zëvendëskomandanti i
20 qendrës shkollë ushtarake. Çdo herë urdhri i përmendur ka
21 qenë gojarisht, jo me shkrim.

22 PY. Në fund të shkurtit, kur bëtë kërkesën për të transferuar
23 në një strukturë tjetër komanduese, e keni fjalën për shkollën
24 ushtarake në këtë pikë?

25 PË. Jo. Fillimisht unë e -- kam pasur detyrën e përgjegjës

1 për shkollim dhe stërvitje në kuadër të drejtorisë operative
2 të Shtabit të Përgjithshëm. Domethënë, në q'atë sektor por
3 realisht kanë qenë shumë të vogla mundësitë për dhënien e
4 ndonjë farë kontributi për faktin se në atë periudhë kemi pas
5 luftime gjithë ditore, praktikisht permanente. Ditë për ditë.
6 PY. Në rregull. Ti kërkove të shkoje te shkolla ushtarake në
7 prill të vitit 1999?

8 PË. Unë kërkova që ta lë zonën operative të Pashtriikut se
9 realisht e vlerësova që muj me dhanë diku tjetër në kontribut
10 më të madh, edhe në koordinim me Bislum Zyrabin, u përcaktum
11 që ta marr detyrën e sektorit për shkollim e stërvitje, brenda
12 drejtorisë operative të Shtabit të Përgjithshëm. Dhe realisht
13 që po e përmendni, për shkak të asaj se ka qenë e vështirë me
14 dhanë një kontribut për shkak të luftime të ditë përditshme,
15 unë kam qenë i angazhuar në atë periudhë në kuadër të Brigadës
16 123 gjatë luftimeve të marsit të vitit 1999. Në cilësinë e
17 inspektimit të vijave të frontit.

18 PY. Në rregull. Pra, kjo që po -- kjo që po përshkruani ju
19 tani është periudha para se të shkonit në shkollën ushtarake,
20 kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Në rregull. Pyetja e fundit. Dëshmitar, gjatë intervistës
23 për ZPS-në, ju e mbyllët intervistën duke folur për krimet
24 serbe dhe për UNMIK-un.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Për referencë, bëhet fjalë për

1 materialin që mban numrin P1327.9. Janë faqet 32 dhe 33 në
2 anglisht, dhe faqja 41 në shqip.

3 PY. Ju thatë që:

4 "UNMIK-u ka qenë autoriteti përgjegjës pas luftës dhe ata
5 ishin përgjegjës, duhet të kryenin hetime por që nuk e kanë
6 bërë."

7 Ju kujtohet që e thatë këtë gjatë intervistës me ZPS-në?

8 PË. Po.

9 PY. Kur u angazhuan aktivisht KFOR-i dhe UNMIK-u në Kosovë, u
10 raportoheshin natyre krimet, a raportonte ndonjëri krimet
11 atyre?

12 PË. Po unë nuk jam marrë me atë problematikë, por e di që
13 autoritet në Kosovë ka qenë UNMIK-u, deri në vitin 2008. Dhe
14 nëse dikush ka pas njoftim në lidhje me shkelje të caktume,
15 normale që ka mujt me i denoncu dhe me i prezantu në organet e
16 UNMIK-ut në atë kohë. Pra, sipas mendimit të, UNMIK-u nuk e
17 ka ba punën e vet për ato ç'ka realisht -- ndoshta ka qenë i
18 ngarkuar. Nuk e ka kry funksionet dhe detyrën si duhet.

19 PY. Në fakt UNMIK-u nisi disa çështje kundër ish-anëtarëve të
20 UÇK-së pas luftës, apo jo?

21 PË. Nuk më kujtohen detajet të caktume, raste të caktume, po
22 nëse s'gaboj, ka pas raste.

23 PY. Ju keni ndonjë informacion që vetë UÇK-ja t'i jetë
24 drejtuar UNMIK-ut apo KFOR-it për krimet e kryera prej
25 anëtarëve të UÇK-së?

1 PË. Jo, s'kam kurrfarë informacion se realisht mua në atë
2 kohë më është dasht, si gati çdo qytetar i Kosovës, me punue
3 për me mujt me kriju një bazë për me ekzistue. Kështu që jam
4 marrë me punët e mia dhe më nuk më ka interesu problematika,
5 çështje të tjera, domethënë, që e kanë kalue kompetencat e
6 mia.

7 Se edhe jam demobilizu me përfundim të luftës nga
8 ushtria, edhe më realisht nuk më kanë interesuar problematika
9 të tjera.

10 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

11 Z. HALLING: [Përkthim] Nuk kam më pyetje.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull,
13 z. Misetic.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

15 Pyetje të palës tjetër nga z. Misetic:

16 Z. MISETIC: [Përkthim]

17 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Unë quhem Luka Misetac [Sipas
18 përkthimit] dhe jam Avokati i z. Thaçi. Kam disa pyetje për
19 ju. Sot pasdite -- deri sot pasdite.

20 Së pari, dua të konfirmoj diçka. Ju keni qenë oficer në
21 armatën kombëtare jugosllave nga viti 1985 deri në vitin 1987,
22 kështu?

23 PË. Fillimisht, mirëdita. Po, i nderuari Avokat, pikërisht
24 ashtu si thatë ju është.

25 PY. Në rregull. Nga viti 1987 deri në qershor të vitit 1998

1 ke kryer më ndonjë funksion ushtarak në ndonjë organizatë
2 ushtarake?

3 PË. Jo.

4 PY. Në qershor të vitit 19998 u kyçe në UÇK, kështu?

5 PË. Po.

6 PY. Po para se të kyçeshe, në mars, prill dhe maj, ju keni
7 pas kontakte me UÇK-në përmes Blerim Kuqit. Saktë?

8 PË. E, sidomos në fazën e funtit të muajit mars, prill dhe
9 qershor. Po.

10 PY. Sipas intervistës për ZPS-në, Blerim Kuqi në atë kohë,
11 kishte formuar njësitin e tij Lisi brenda UÇK-së. Kështu?

12 PË. Saktë.

13 PY. Në atë periudhë kohore, mars, prill, maj, Blerim Kuqi
14 kishte mbështetjen e Ukë Bytyqit për formimin e njësitit Lisi.
15 Kështu?

16 PË. Po.

17 PY. Të dy, si Blerim Kuqi, si Ukë Bytyqi, kanë qenë udhëheqës
18 të LDK-së në Suharekë asokohe. Është e saktë?

19 PË. Po, para kyçjes së tyre në UÇK ata kanë qenë udhëheqës në
20 Suharekë.

21 PY. Më pas, po për atë periudhë kohore, flas mars, prill,
22 maj, për këtë e kam fjalën, Blerim Kuqi dhe Ukë Bytyqi ishin
23 ende në LDK në të njëjtën kohë që formonin UÇK-në në zonën e
24 Suharekës?

25 PË. Nuk i di detajet. Ukë Bytyqi ka mujt me qenë në funksione

1 partiake, ndërsa Blerim Kuqi jo, e se s' -- me momentin e
2 kyçjes në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, ai më nuk ka ushtru
3 kurrfarë funksioni tjetër në drejtim të Suharekës.

4 PY. Po ua bëj këtë pyetje se në intervistën për ZPS-në që
5 mban numrin P01327.7, faqe 2, rreshtat 11, 12 në anglisht, ju
6 thoni:

7 "Në Suharekë UÇK-ja u krijua prej strukturave të LDK-së."

8 A ju kujtohet ta keni thënë këtë? Po ashtu keni thënë që
9 UÇK-ja drejtohej nga ish-përkrahës të LDK-së. Kështu?

10 PË. Po.

11 PY. Kur thoni në Suhare -- Suharekë -- kur thoni ju që në
12 Suharekë UÇK-ja u krijua prej strukturave të LDK-së a mund të
13 na e shtjellosh pak më tej, çfarë ke dashur të thuash me këtë?

14 PË. Po e marr një shembull. Realisht, Ukë Bytyçi ka qenë
15 kryetari i LDK-së, degës më të madhe partiake, ndërsa Blerimi
16 ka pas detyrën në grumbullimin e mjeteve për financim të
17 qeverisë, respektivisht të organeve tona paralele që i kemi
18 pasur në pushtimin -- në sistemin e Jugosllavisë. Kështu që,
19 këshilli i përkohshëm atë -- nuk si është quajtur ajo -- ajo
20 farë organizimi, po realisht ai ka qenë në krye të
21 grumbullimit të mjeteve financiare për mbajtjen e organeve
22 paralele të shtetit në atë kohë.

23 Prandaj, këta të dy persona kanë qenë personat kryesorë
24 në qeveri -- në një qeveri -- po përmendi në qeverisje lokale,
25 që ka funksionu si organ paralel i organeve të atëhershme

1 serbe.

2 PY. Mirë. Këta dy persona, pra Blerim Kuqi dhe Ukë Bytyqi, a
3 ishin dy prej themelueseve kryesorë të UÇK-së në zonën e
4 Suharekës? Është e drejtë ta them kështu?

5 PË. Për njësitin Lisi po. Po. Po, krahas asaj ka ekzistuar
6 edhe një njësit tjetër, Çeliku 50.

7 PY. Qëndrojmë te njësiti Lisi. A është e vërtetë që Blerim
8 Kuqi është zgjedhur si komandant i njësitit Lidi në prill të
9 vitit 1998?

10 PË. E nuk i di detajet rreth formës se si është ardh ai në
11 krye të atij njësiti, apo është zgjedh, a si është forma se si
12 është formua, nuk jam në detaje. Domethënë, nuk jam në
13 rrjedhat të asaj dhe nuk mund me shpjegu se nuk e di.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim në ekran provën materiale
15 P1333, faqja 1 në anglisht dhe faqja 2 në shqip.

16 PY. Dëshmitar, e njëhi këtë dokument në ekran?

17 PË. Po.

18 Z. MISETIC: [Përkthim] Shkojmë te paragrafi që fillon me
19 fjalët "në mars të vitit 1999 ...". Ma merr mendja që te
20 shqipja është te faqja tjetër. Më falni, jo ishte te faqja
21 pararendëse, te shqipja. Në fund.

22 PY. Dëshmitar, është ky paragrafi që fillon me fjalët "në
23 mars të vitit 1998 kjo strukturë"

24 "... do të shkojë në Drenicë ku do të bashkëpunojë me
25 strukturat e atjeshme si dhe me Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-

1 së. Pas kontakteve të lartcekura, si dhe nga rrethanat e
2 krijuara në prill të vitit 1998, u mor vendim që të formohet
3 njësitit Lisi, ku komandant i njësitit u zgjodh Blerim Kuqi. Ky
4 njësit në fillim kishte 70 ushtarë, kurse për herë të parë
5 haptazi doli në fshatin Dobërdolan", edhe kështu me radhë.

6 Keni ndonjë arsye për ta kontestuar faktin që Blerim Kuqi
7 është emëruar komandant i sht -- i njësitit Lisi në prill të
8 vitit 1998?

9 PË. Çështje teknike rreth asaj se a është emnu apo vetë-emnu
10 e ka formu njësinë, nuk e di, po e di faktin se njësitit Lisi
11 në krye me Blerim Kuqin, kanë pas një komunikim
12 jashtëzakonisht të mirë me struktura të tjera të krijuara në
13 atë kohë, sikurse ka qenë Çeliku 50, njësitit Lumi, e disa
14 njësite të tjera që kanë vepru në atë rajon.

15 PY. Në atë kohë, duke marrë parasysh rolet që kishin
16 udhëheqësit e LDK-së, veçanërisht e kam fjalën këtu për Blerim
17 Kyqin dhe Ukë Bytyqin, me sa keni ju dijeni, UÇK-ja në atë
18 kohë e konsideronte dikë si kundërshtar të UÇK-së veç për
19 faktin se kishin qenë apo ishin ende anëtarë të LDK-së? Dhe e
20 kam fjalën këtu për zonën e Suharekës.

21 PË. Nuk ma merr mendja që të ketë qenë diçka e tillë.

22 PY. Keni dëgjuar ndonjëherë për ndonjë urdhër në zonën e
23 Suharekës, sipas të cilës duhet të mbyllej UÇK-ja? Më falni,
24 desha të thosha LDK-ja, jo UÇK-ja. Të mbyllej LDK-ja.

25 PË. Jo. Jo.

1 PY. Me sa keni ju dijeni, LDK-ja në Suharekë, e vijoji
2 veprimtarinë e vet normale edhe pas krijimit të UÇK-së apo u
3 largua, apo u mbyll -- u mbyll LDK-ja në zonën e Suharekës?

4 PË. Jo, ka vazhdue veprimtarinë e vet deri në përfundim të
5 luftës.

6 PY. Flasim tani për periudhën mars, prill, maj të vitit 1998.

7 Në këtë kohë Bislime Zyrapi çfarë roli kishte pranë UÇK-së?

8 Pra, prill, maj - prill -- prill, maj -- më fal, mars, prill,
9 maj të vitit 1998.

10 PË. Me sa unë mbaj mend, Bislime Zyrapi në territorin e komu -
11 - Kosovës, ka ardhur në fund të majit të vitit 1998.

12 Domethënë, nuk ka qenë pjesë këtyre formacioneve ushtarake.

13 PY. Pra, me sa dini ju, ai nuk ka qenë pjesë e UÇK-së deri në
14 momentin që hyri në territorin e Kosovës, që është maji --
15 fundi i majit i vitit 1998. Kështu?

16 PË. Saktë.

17 PY. Çfarë funksioni pati ai në UÇK në fund të majit, 1998,
18 kur hyri në Kosovë.

19 PË. Pasi Bislime Zyrapi u kyç në radhët e UÇK-së, menjëherë
20 fillimisht detyra e tij ka qenë me i dhanë fizionominë
21 ushtarake Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, detyrë të cilën kam
22 bindjen që e ka kryer me një sukses të admirueshëm.

23 PY. Po, çfarë pozite pati, çfarë roli, çfarë titulli, çfarë
24 titulli pati kur hyri në Kosovë?

25 PË. Eh, fillimisht nuk e di tash çështjet e titujve, po ne e

1 quanim si shef i operacioneve pranë Shtabit të Përgjithshëm,
2 që më vonë e dimë se e ka marrë detyrën e shefit të Shtabit,
3 por edhe këtu çështje e definimit të strukturave, realisht pak
4 tash edhe për mua që kam qenë pjesë e saj, është pak e
5 koklavitur, e mos të flas për të tjerët, që janë jashtë
6 strukturës që paraqet huti.

7 PY. Në rregull, do flasim më tej pas pushimit të drekës, por
8 do të bëj edhe një pyetje të fundit tani. Bislim Zyrapi vetë
9 është nga Suhareka, apo jo?

10 PË. Po. Me origjinë është nga një fshat i Suharekës,
11 Studenqan, Suharekë.

12 PY. Pra, me sa keni ju dijeni, Bislim Zyrapi kishte një
13 interes të veçantë prej Suharekën sepse prej andej vinte.
14 Kështu?

15 PË. Në -- në -- nëse e shikojmë prej një këndi, eh, tjetër,
16 del që po, ai ka pas një simpati dhe realisht ka pas dëshirë
17 që Suhareka me dalë mirë në këtë Ushtrinë Çlirimtare të
18 Kosovës, me dhanë një kontribut me të vërtetë maksimal.

19 PY. Faleminderit, Dëshmitar.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Është koha e pushimit të drekës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar,
22 tani kemi një orë e gjysmë pushim. Kur të rikthehemi, do
23 vijojejmë dhe do përfundojmë në orën 16.30.

24 Mos flisni me askënd për dëshminë tuaj jashtë sallës së
25 gjyqit.

1 DËSHMITARI: Faleminderit.

2 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rifillojmë në
4 orën 14.30.

5 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

6 --- Seanca rifillon në orën 14.29

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem,
8 sillni në sallë dëshmitarin.

9 Do të bëjmë të pamundurën që duke mos e bërë pushimin që
10 kemi pas një ore që të përfundojmë me kundërpyetjet sa më
11 shumë që të jetë e mundur, në mënyrë që të ecim përpara.
12 Megjithatë në rast se dikush kërkon që të bëjmë pushim,
13 atëherë ju lutem më thoni. Dhe do t'ju mirëkuptonim.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Mund të jem unë ai që do ta kërkoj
15 pushimin.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndoshta me më
17 shumë gjasa unë.

18 [Dëshmitari vijon dëshminë]

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Mikrofoni çaktivizuar]
20 [Përkthim] Shpresojmë të kesh kaluar mirë në drekë. Dhe tani
21 jemi gati të vijojmë me dëshminë tuaj. Do të vazhdojmë deri në
22 orën 4.30. Në rast se keni nevojë për pushim, ju lutem na
23 thoni.

24 DËSHMITARI: Në rregull është. Faleminders.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

1 Z. Misetic do të vijojë me pyetjet e tij.

2 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit, Kryetar i Gjykatës.

3 PY. Mirëdita, Dëshmitar. Ju përmendët në dëshminë tuaj
4 përpara pushimit të drekës që ju e dinit që Bislim Zyrapi
5 ishte shefi i operacioneve operative. Kur u bë Bislim Zyrapi
6 shef operativ në Shtabin e Përgjithshëm të UÇK-së, a mund të
7 na e thoni këtë?

8 PË. Jo, nuk muj me thënë se unë realisht nuk jam në rrjedha
9 të kësaj. Ndoshta më herët e kam dit këtë informacion e kam
10 pas, po sot e kam harru, nuk muj me thanë saktë se kem të
11 bëjmë me këtë datë ose me atë datë.

12 PY. A mund të na thoni se kur u bë shef i Shtabit të
13 Përgjithshëm?

14 PË. Po as këtë s'muj me e thanë. Nuk muj me e thënë, se nuk e
15 di.

16 PY. A ka qenë shef i Shtabi të Përgjithshëm me ç'dini ju në
17 gusht të vitit 1998?

18 PË. Ne i kemi thënë shef, po realisht tash çfarë funksioni ka
19 pas dhe si janë kanë ato, unë nuk i di. Ne e kemi konsideru
20 shef të Shtabit të Përgjithshëm.

21 PY. Kur e konsideruat si shef të Shtabit të Përgjithshëm? A
22 mund të na thoni kohën më të hershme kur e keni konsideruar të
23 tillë, pra, si shefin e Shtabit të Përgjithshëm?

24 PË. Realisht që e përmenda janë dy koncepte: një si shef
25 operacioni dhe një shef i Shtabit të Përgjithshëm. E kur bëhet

1 ky kalim, nuk e di. Kryesorja në fazën e dytë të muajit
2 nëntor, tetor, nëntor atëherë e kemi konsiderue e kemi njoft
3 si shef i Shtabi Përgjithshëm.

4 PY. Okej.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të na
6 sqaroni për vitin ju lutem? Që ta kemi ta kemi në transkript.

7 Z. MISETIC: [Përkthim]

8 PY. Kur thoni tetor apo nëntor për cilin vit e keni fjalën?

9 PË. Në tetor, nëntor 1998.

10 PY. Okej. Dhe kur ka qenë hera e parë që ju mbani mend që e
11 keni konsideruar të ishte shefi i operacioneve i Shtabit të
12 Përgjithshëm?

13 PË. Nuk muj me bë specifika për sa i përket datave se me të
14 vërtetë ka kalu shumë kohë dhe nuk di. Muj me gabu.

15 PY. Okej. Atëherë le të shikojmë rrugëtimin tuaj. Në 10
16 qershor, ju i thatë ZPS-së që u bëtë, u kyçët në njësitin
17 Lisi, është e saktë kjo?

18 PË. Po, e saktë është.

19 PY. Gjithashtu përpara pushimit ju përmendët që përveç
20 njësitit Lisi kishte edhe një njësit tjetër që quhej Çeliku
21 50, është e saktë kjo?

22 PË. Po.

23 PY. Dhe komandant i atij njësitit ishte Habib Elshani, apo jo?

24 PË. Saktë.

25 PY. Gjithashtu i keni thënë ZPS-së që përpara një jave apo

1 dhjetë ditë përpara se të kyçeshit tek njësitit Lisi, u krijua
2 shtabi rajonal i Suharekës. A e mbani mend ta keni thënë këtë?

3 PË. Shtabi rajonal për Suharekë është kriju gjatë muajit
4 qershor. Jo para se me u kyç unë, por mbasi që jam kyç unë në
5 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

6 PY. Po dhe ajo që i thatë ZPS-së, besoj unë, është që ishte
7 rreth një javë apo dhjetë ditë pasi u kyçët ju në UÇK-në.

8 Është e saktë kjo?

9 PË. Po, e saktë është.

10 PY. Okej. A është e saktë gjithashtu që Shtabi i Përgjithshëm
11 u krijua nga njësitit Lisi dhe njësitit Çeliku 50, pra, që ishin
12 këto njësite që kishin krijuar shtabin rajonal?

13 PË. Po, saktë është.

14 PY. Okej. Dhe tani dëshiroj t'ju tregoj një dokument. Së pari
15 më lejoni që t'ju bëj një pyetje paraprake: A e njihni dikë që
16 quhet Xhem Karaxha?

17 PË. Po, e njoh.

18 PY. Dhe nga e njihni Xhem Karaxhën?

19 PË. Është bashkëfshatar i jemi.

20 PY. Okej. Dhe ju e dini që Xhem Karaxha ose çfarë lidhje ka
21 ai me Brigadën 123?

22 PË. Ka qenë pjesëtar i UÇK-së në kuadër të Brigadës 123,
23 respektivisht prej fillave, prej qershorit në kuadër të
24 njësitit Lisi e pastaj edhe në kuadër të Brigadës 123.

25 PY. Atëherë së pari me lejoni që t'ju tregoj diçka nga faqja

1 e vet e Facebook-ut, dhe për këtë kemi një numër përkatës i
2 cili është DHT03988.

3 Si fillim personi në këtë fotografi kush është?

4 PË. Është fotografi e jeme e bëne menjëherë me përfundim të
5 luftës, domethënë, është në qershor të 1999.

6 PY. Kjo uniforma që keni veshur është ajo lloj uniforme që
7 vishnit, për shembull, në verën e vitit 1998?

8 PË. Unë e kam pas një tjetër uniformë, kamuflazh gjithashtu,
9 po që e ka përdorur ushtria zvicerane. Ndërsa këtë uniformë e
10 ka bajt personalisht Balim Muharremaj edhe e kemi bë
11 fotografinë në Prizren dikun me datën 16, 17 qershor. Uniforma
12 është e Balil Muharremajt.

13 PY. 16 apo 17 qershor të cilit vit, ju lutem?

14 PË. 1999.

15 PY. Okej. Dhe me Ç'dini ju, a ka qenë e zakonshme që ushtarët
16 e UÇK-së të veshin uniforma në të cilat thuhej "Ushtria e
17 SHBA-së"?

18 PË. Jo. Ish dashtë ndoshta me u hek kjo por ne nuk e kemi
19 hjek edhe uniformat që i kemi pas kamuflazh të shteteve të
20 Gjermanisë edhe aty ka figuru shpesh flamuri në njënin krah,
21 po nuk na ka pengu fort.

22 PY. Ky postim dhe më vjen keq që nuk e kemi përkthimin në
23 anglisht për Gjykatën, megjithatë do ta lexoj, aty është
24 shkruar nga Xhem Karaxha:

25 "Respekt për bashkëluftëtarin Kurtesh M. Fondaj në Peqan,

1 ish-komandanti i Brigadës 123 për periudhën tetor, nëntor
2 1998.”

3 Ju Xhem Karaxhën e njihni si një person i cili ka një
4 mendim të mirë për ju ose ka respekt për ju?

5 PË. Me thanë të drejtën unë konflikte, problem bash me asnjë
6 ushtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kurrë nuk kam pas.

7 PY. Okej. Atëherë do t'ju tregoj edhe një postim tjetër nga
8 Facebook.

9 Z. MISETIC: [Përkthim] Me numër tjetër DHT03987. Dhe i
10 kërkoj Sekretarit të seancës të na e vendosë në ekran.

11 PY. Është gjithashtu një postim nga Xhem Karaxha. Dhe është
12 një dokument, ai thotë që është origjinale, sipas të cilit
13 është formuar shtabi vendor në Suharekë. E shihni dokumentin
14 në ekran?

15 PË. Po.

16 PY. Po. Po ta lexojmë dokumentin, në të pretendohet që thuhet
17 që është bërë një takim i përbashkët në datën 26 qershor 1998
18 në Studençan. A mbani mend keni qenë ju i pranishëm në këtë
19 takim?

20 PË. Jo.

21 PY. A keni qenë i pranishëm në një takim ku njësitë Çeliku 50
22 dhe ai Lisi ranë dakord që të formonin një shtab të asaj zone,
23 një shtab vendor?

24 PË. Po më duket se që ky dokument është ai momenti i formimit
25 të njësitit, domethënë, të shtabit rajonal, respektivisht

1 shkrires së dy njësive në një njësi ushtarake të veçantë. E
2 jo, unë nuk kam qenë prezent.

3 PY. Në rregull. Po të lexojmë dokumentin, në pikën numër 1
4 thuhet që bëhet bashkimi i dy njësive të UÇK-së, Çeliku 50
5 dhe Lisi nën një komandë. Në pikën e dytë thuhet të formohet
6 shtabi lokal Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për Suharekën.

7 Pra, shtabi lokal kështu u krijua, apo jo? Jeni dakord?

8 PË. Po.

9 PY. Dhe më pas vijohet që në vijim të këtij takimi Blerim
10 Kuqi do të ishte komandant i shtabit dhe Habib Elshani do të
11 ishte zëvendëskomandant i shtabit. E shikoni këtë pjesë?

12 PË. Po.

13 PY. Ndërsa në Pikën 3 thjesht thuhet që Bislim Zyrapit dhe
14 Gafurr Elshani ishin pjesë e këtij takimi, morën pjesë. E
15 shihni këtë?

16 PË. Po.

17 PY. Më pas ka nënshkrimet e tetë personave, përfshirë Blerim
18 Kuqin dhe Habib Elshanit që janë të parët, më pas Bislim
19 Zyrapit që është numri vendor numër shtatë. E shihni këtë?

20 PË. Po.

21 PY. A keni ndonjë arsye për të mos rënë dakord, për shembull,
22 për mënyrën sesi u formua ky shtab sipas datës dhe
23 vendndodhjes që tregon ky dokument?

24 PË. Jo, jo nuk jam për atë praktikisht me e kundërshtu
25 apsikisht kurrëgjë. Unë nuk kam qenë prezent në formimin e

1 këtij shtabi rajonal dhe mënyrën sesi kanë rrjedhë gjanat nuk
2 i di.

3 PY. Okej. Dëshmitar, ajo që po ju sugjeroj është që në
4 Shënimin Përgatitor në paragrafin 12, ju thoni që me ç'kuptoni
5 ju, ka qenë Shtabi i Përgjithshëm që ka krijuar Brigadën 123
6 sepse Zyrapi ka qenë i pranishëm kur u krijua.

7 Dhe ajo që sugjeroj unë ishin këto dy shtabet vendore që
8 ranë dakord dhe ranë dakord pra, që këto dy njësitate ku ishte
9 dhe Zyrapi i pranishëm në fund të qershorit të krijonin këtë
10 gjë. Jeni dakord ju me mua?

11 PË. Z. Avokat, në princip pajtohem. Por na tash kur,
12 domethënë, arsyeja e jeme pse unë e kam mendu edhe e kam thënë
13 që ka qenë Shtabi i Përgjithshëm është emni që po përmendet i
14 Bislime Zyrapi në këtë dokument. Në cilën cilësi ka qenë
15 Bislime Zyrapi unë nuk e di. Por mendimi jem ose mendja jeme ka
16 thënë që ai të jetë si përfaqësues i strukturave të larta të
17 UÇK-së. Ndoshta është gabim, por ky ka qenë perceptimi jem.

18 PY. Okej. Pra, ky ishte prezumim nga ana juaj, apo jo?

19 PË. Po në një farë aspekti unë e kam pas në krye thjesht edhe
20 mendimin se Bislime Zyrapi pasi ka qenë edhe një herë po e
21 përmendi, prezent është ardhë me pjesën dhe me iniciativën e
22 tij. Ky bashkim respektivisht kjo formë e organizimit. Sepse
23 pastaj në mënyrë shumë të ngjajshme vazhdon edhe me shtabe të
24 tjera rajonale dhe pastaj shumë shpejt ma vonë kalon nga ky
25 shtab rajonal formohet edhe brigada. Prandaj, logjika mu më ka

1 dhënë me konkludu se kemi të bëjmë me një organizim të nivelit
2 ma të lart. Që realisht ky është mendim i jemi.

3 PY. Po. Po a e shihni tani që në këtë dokument thuhet që
4 vendimin e morën njësitë Çeliku 50 dhe Lisi dhe jo Shtabi i
5 Përgjithshëm?

6 PË. Korrekt, po e shoh.

7 PY. Okej. Në rregull.

8 PË. Por në realisht nuk jam -- nuk ka qenë i njoftum me
9 formën e me këtë dokument.

10 Z. MISETIC: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, kërkojmë që ta
11 dorëzojmë këtë dokument si prova materiale.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
13 kundërshtime?

14 Z. HALLING: [Përkthim] Jo.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë
16 DHT03987 pranohet. Ju lutem t'i japim një numër si provë
17 materiale.

18 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Atëherë i caktojmë
19 numrin 1D00164 me klasifikimin publik. Faleminderit.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Faleminderit.

21 PY. Dëshmitar -- ndjesë. Edhe një gjë tjetër për këtë
22 dokument. Në shënimin e përgatitjes, shënimin numër 1,
23 paragrafi 12 -- jo vetëm që citimin ta kem të saktë nga vendi
24 i duhur. Një sekondë ju lutem.

25 Tek Pjesa e parë e intervistës tuaj me ZPS-në, P1327.1,

1 në faqen 20 në anglisht duke filluar në rreshtin 18, ju thatë
2 dhe këtu po flisnit për krijimin e shtabin vendor. Pyetja
3 ishte kur u formua ai dhe ju thatë:

4 "Në fillim të qershorit. E gjitha kjo ka ndodhur deri në
5 20 qershor. Dhe në fund të qershorit, duke u bazuar tek ky
6 shtab rajonal, ne krijuam Brigadën 123".

7 Ajo që ju sugjeroj është që në dokument tregohet që nuk
8 ishte Brigada 123 që u krijua në fund të qershorit, por në
9 fund të qershorit u krijua shtabi rajonal. A keni ndonjë arsye
10 për ta kundërshtuar këtë aspekt kohor?

11 PË. Jo, zoti Avokat, po nëse s'gabo, unë ndërkohë kam dhënum
12 dhe përmirësim të kësaj problematike duke thënë që fillimisht
13 është formu shtabi rajonal e pastaj është formuar brigada. Kam
14 dhënë edhe shënime tjera në raport me, domethënë, jo vetëm
15 q'atë, domethënë, ai shënim, po edhe shënimin tjetër edhe në
16 bazë zë gjetjeve që kam pas të miat, shoh që Brigada 123 është
17 krijuar pikërisht më 7 korrik 1998.

18 PY. Dhe ku e bazoni këtë gjë? Mbi ç'gjetje?

19 PË. Në bazë të dhënave dhe shënimeve të mia që i kam -- që i
20 kam pas praktikisht.

21 PY. Thatë që i "keni patur". I keni ende këto shënime?

22 PË. Jo, nuk i kam.

23 PY. Keni patur mundësinë t'i rishikoni këto shënime që i keni
24 dhënë ZPS-së?

25 PË. Javën e kalime i kam lexue, i kam lexue edhe në fazën

1 përgatitore. Nëse s'gaboja diçka i kam thanë Prokurorit për
2 këtë çështje.

3 PY. Pra, nuk jam i qartë. Ju i keni lexuar shënimet tuaja
4 javën e shkuar, i keni rishikuar ato dhe aty thuhet që ka qenë
5 data 7 korrik si data e formimit të Brigadës 123?

6 PË. Në ato transkriptet që janë bo më 2019 figuron ashtu si e
7 thatë ju. Mirëpo, në fazën përgatitore, unë i kam dhënë këtë
8 shënim Prokurorit. Mendoj që Prokurori e ka këtë informacion.

9 PY. Okej. Do t'ju bëja dhe një pyetje tjetër për qershorin e
10 vitit 1998. Në intervistën me ZPS-në në dokumentin P1327.3 në
11 faqet 5 deri në 6 në anglisht dhe në faqen 7 të gjuhës shqipe,
12 ju shpreheni që në qershor 1998:

13 "Po krijohet ushtria" dhe "kishte shumë çështje boshllëqe
14 që nuk po ndiqnin rrugën ushtarake".

15 Për çfarë e kishit fjalët që kishte shumë çështje apo
16 boshllëqe që nuk po ndiqnin rrugën apo linjën ushtarake?

17 Z. HALLING: [Përkthim] Ne kërkojmë që të lexohet e gjitha
18 kjo, përfshirë edhe rreshtin e fundit jo katër fjalët e
19 fundit.

20 Z. MISETIC: [Përkthim] mund të bëhet kjo në pyetjet që do
21 të bëjë sërish Prokuroria.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni, ju
23 lutem.

24 Z. MISETIC: [Përkthim]

25 PY. Atëherë më lejoni që të përsëris pyetjen time. Në

1 intervistën tuaj të ZPS-së ju thatë që:

2 "Në qershor të 1998 po krijohej ushtria" dhe "kishte
3 shumë boshllëqe dhe çështje të cilat nuk ndiqnin linjën apo
4 vijën ushtarake".

5 Për çfarë çështjesh apo boshllëqesh, hendeqesh e kishit
6 fjalën këtu, cilave ju referoheni?

7 PË. Realisht tash ne jemi tu fol për një situatë që ka ndodhë
8 para 25 vite dhe normale që detajet saktë rreth asaj çështjeje
9 dhe asaj kohe, mu s'mund të më kujtohen. Por, muj me thanë se
10 kemi pas një lloj entuziazmi, kemi pas një vërshim të rinjve
11 për kyçjen në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës, prandaj është
12 dashtë me pas një lloj kujdesi edhe në pranimin edhe në
13 sistemimin atyne të rinjve në radhët e njësive të UÇK-së. Edhe
14 një çështje, një numër i konsiderueshëm i këtyne të rinjve
15 kanë qenë pa shërbim ushtarak edhe kanë pas nevojë për
16 trajnime bazike, duke fillu prej asaj si mbahet arma e të mos
17 flas më edhe elementëve tjera.

18 PY. Nga përgjigja juaj kuptoj që është e vështirë për të
19 patur një komandant strukturore funksionale me ushtarët në
20 qoftë se ata nuk janë të trajnuar më parë. A jeni dakord me
21 këtë?

22 PË. Sigurisht, sigurisht.

23 PY. A ka patur eprorë të trajnuar në çdo nivel komande në
24 qershor të 1998 me aq sa dini ju?

25 PË. Jo. Jo, s'ka pas.

1 PY. Okej. Me lejoni të kaloj tek një çështje tjetër. Në
2 përgjigjen që i keni dhënë Prokurorit sot në mëngjes kur po
3 flitej për situatën në të cilën e gjeti veten Brigada 123 në
4 shtator, tetor të 1998, ju thatë që ushtria u shpërnda.
5 Thjesht dëshiroj që ta tregoni pak më shumë se cila ka qenë
6 situata në ushtrinë në Suharekë në fund të shtatorit, në
7 fillim të tetorit 1998.

8 PË. Unë po filloj pak më herët në gusht, në fund të gushtit
9 të 1998, ne kemi pas luftime të rrepta në territorin e komunës
10 së Suharekës në drejtim të batalionit që ka qenë në rajonin
11 Studençan, Rreshtan, Peqan, Sllapuzhan, Nishor edhe realisht
12 kemi pas humbje jashtëzakonisht të mëdhaja.

13 Plus pas kësaj, komplet rajoni, fshatrat janë djeg dhe
14 popullata është zhvendos në pjesën veriore të komunës së
15 Suharekës, respektivisht në fshatin Pagarushë edhe në rajone
16 tjera. Kështu që ne e kemi pas, që e përmenda dhe njëherë,
17 dëme jashtëzakonisht të mëdhaja si ushtri, por edhe si
18 popullatë.

19 Rajoni tjetër i Suharekës, pjesa veriore që e ka përfshi
20 Batalionin e 2-të, të njëjtin fat, ndoshta pak edhe ma të keq,
21 që ka pas më 27 shtator 1998, ku një numër i konsiderueshëm i
22 forcave serbe janë angazhu dhe për një ditë kanë bë skandale e
23 shkatërrime të papara. Kështu që në mesin, domethënë dhe si
24 rezultat i saj ushtria për një moment është shpartallu.

25 PY. Dhe përveç të gjithë atyre dëmeve që pati, a është e

1 saktë që Blerim Kuqi ishte larguar për në Shqipëri dhe ju nuk
2 kishit komandant të Brigadës 123 gjatë gjysmës së dytë të
3 shtatorit dhe fillimit të tetorit, është e saktë kjo?

4 PË. Është e saktë, se në fillim të shtatorit, domethënë, data
5 dikund 10 shtatori, Blerim Kuqi ka shku në Shqipëri. Unë e kam
6 përcjellë edhe i kam thënë "Rruga e mbarë". Qëllimi ka qenë që
7 thjesht me e forcu ushtrinë jo me e dobësu, se e përmenda, ne
8 e kemi pas probleme pastaj me ekzistë në aspektin e
9 logjistikës.

10 Ne, Ushtria Çlirimtare e Kosovës ka shfrytëzu resurset e
11 popullatës. Popullata e ka mbajtur ushtrinë. Mirëpo në ato
12 rrethana që e përmenda kur çdo gjë është shkatërrue, popullata
13 tashmë s'ka pas mundësi me na përkrah neve. Dhe qëllimi i
14 shkumjes së Blerim Kuqit në Shqipëri ka qenë me kërkue
15 mbështetje financiare nga qeveria Bukoshi.

16 PY. Okej. Megjithatë të përpigemi të qëndrojmë tek kjo temë,
17 pra, si kishte situata e UÇK-së në Suharekë në atë periudhë
18 kohore, fund shtatori, fillim tetori. Pra, kishte shumë
19 viktima, komandanti ishte larguar. Më vjen keq, nuk e mbaj
20 mend sot në mëngjes, po më duket ju bë pyetja sesa ushtarë
21 kishin mbetur ende në brigadë në fillim të tetorit 1998. A
22 mund të kujtoni cila ishte përgjigja juaj ju lutem?

23 PË. 300 plus 300, 600 ushtarë. Rreth 600 ushtarë.

24 PY. Okej. Këta 600 ushtarë, ku ishin këta, ku ndodheshin?
25 Ishin nëpër shtëpitë? Ishin në front? Ku ishin këta?

1 PË. Kryesisht nëpër shtëpitë e tyre, por në një koordinim dhe
2 një formë për me mujt me u mobilizua ka qenë mundësia shumë e
3 shpejt. A një numër i konsiderueshëm i zyne kanë qenë, kanë
4 organizue jetën në njësite të vogla, në grupe të vogla.

5 PY. Pra, kur ju thoni ose që të jem i qartë dhe i sigurt, nga
6 këta 600 vetë shumica ishin nëpër shtëpitë e tyre, a do të
7 thotë kjo që juve ju desh që të bënit punë që disa prej këtyre
8 t'i rikthenit në formacionet e UÇK-së, pra, sepse ishin kthyer
9 nëpër shtëpi, jo të gjithë por shumë ishin kthyer nëpër
10 shtëpi.

11 PË. Po forma e organizimit ka qenë edhe paraprakisht në një
12 nivel i përzim. Një numër i konsiderueshëm i ushtarëve ka qenë
13 ka jetu dhe ka banu thuj në shtëpitë e veta. Një numër i
14 vogël i ushtarëve, domethënë, rreth 40 për qind, mos nëse
15 kështu në mënyrë aproksimative po e them, ka qenë i kazermum.
16 Pjesa tjetër nuk ka qenë e kazermume e ushtrisë, thuj dhe në
17 periudha tjera jo veç në këtë periudhë.

18 PY. Mirë. Flasim për emërimin tuaj apo për dëshminë që keni
19 dhënë se z. Thaçi ju emëroi si komandant të Brigadës 123. Ju
20 thatë që personalisht z. Thaçi ju ka emëru, madje ju e sqaruat
21 ju thatë mbase mund ta ketë përcjellë emërimin tuaj më 6 tetor
22 1998, kështu?

23 PË. Po.

24 PY. Dhe të vetmit persona që kanë qenë të pranishëm keni qenë
25 ju personalisht, z. Thaçi dhe më duket se thatë dhe Fatmir

1 Limaj?

2 Z. HALLING: [Përkthim] Kundërshtojmë. Është shtrembërim i
3 dëshmisë. Është shtuar një person.

4 Z. MISETIC: [Përkthim] Ja më jepni një çast atëherë ta
5 verifikoj.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Prokuror,
7 a mund të na thoni kush është personi shtesë?

8 Z. HALLING: [Përkthim] Vllaznim --

9 DËSHMITARI: Vllaznim Kryeziu.

10 Z. HALLING: [Përkthim] -- Kryeziu mbase. Po.

11 Z. MISETIC: [Përkthim] Ku ishte ky?

12 PY. Unë po lexoj Pjesën 1, të intervistës dhe po jua lexoj
13 unë, Dëshmitar:

14 "Kush ka qenë tjetër i pranishëm në këtë takim?"

15 Ju jeni përgjigjur kështu:

16 "Kam qenë unë, kur u emërova?"

17 "PY. Po, kush ishte tjetër?"

18 "PË. Fatmir Limaj.

19 "PY. Thaçi, Fatmir Limaj dhe ju vetë?"

20 Dhe ju i jeni përgjigjur.

21 "Po ne të tre".

22 DËSHMITARI: Unë e kam plotësu këtë të dhënë, realisht ka
23 qenë prezent edhe Vllaznim Kryeziu, zëvendëskomandant i
24 Brigadës 122.

25 Z. HALLING: [Përkthim] Për t'ju ndihmuar më tej këtë mund

1 ta gjeni tek prova materiale P1327.3, faqja 2 në anglisht,
2 është pjesa shtesë.

3 Z. MISETIC: [Përkthim]

4 PY. Mirë vazhdojmë. E morët këtë urdhër, pra, urdhrin që ju
5 emëronte ju dhe pyetje që kam unë është kjo: Urdhër me shkrim
6 nuk ka pas, apo jo?

7 PË. Jo.

8 PY. As vendim me shkrim për emërimin?

9 PË. Jo, jo, gojarisht është dhënë urdhri. Respektivisht
10 njoftimi, unë po e quaj tash njoftim për emërim.

11 PY. Tani në këtë takim a jeni tre a katër persona pak rëndësi
12 ka, ju është dhënë një emërim me gojë. Pas emërimit me gojë
13 shkove tek anëtarët e tjerë të Brigadës 123, po çfarë ju the
14 ti atyre? Ti nuk kishte asnjë letër që të vërtetonte që ishe
15 emëruar komandant, ti çfarë u the atyre si ua shpjegove ti që
16 ishe emëruar komandanti i ri?

17 PË. Unë kam besimin e mjaftueshëm. Edhe realisht kemi të
18 bëjmë me një strukturë thuaj komplet të re që është formu në
19 kuadër të Brigadës 123 edhe më datën që dikund 8 faktikisht
20 apo 10 s'jam i sigurt, tetor e kam kostitue komandën e
21 Brigadës 123, respektivisht e kemi rikonsolidu brigadën.

22 PY. Po jo unë pyetjen e kam pak më konkrete, unë dua të na
23 thuash me aq sa mundesh, çfarë fjalësh përdorët kur u ktheve
24 ti në Brigadën 123 në çfarë forme, me çfarë forme ua the atyre
25 "Unë jam komandanti i ri", sepse ti ndonjë letër nuk kishe që

- 1 ta vërtetonte, nëse mundesh na thuaj çfarë fjalësh përdore me
2 përafërsi për t'u thënë "Shiko, jam unë komandanti" në
3 ç'mënyrë, me ç'fjalë?
- 4 PË. Në atë periudhë kam qenë komandant batalioni. Dhe thjesht
5 njerëz që i kam pas afër vetit kam zgjeru pak edhe me pjesën e
6 Batalionit 2 edhe i kam thirr në takim, ju kam thënë se kam
7 marrë komunikimin nga Hashim Thaçi që jam komandant brigade
8 edhe duhet ta konsolidojmë brigadën në mënyrë që të fillojmë
9 me riorganizim edhe përgatitje të ushtrisë. Edhe konform saj
10 kam vepru.
- 11 PY. Tamam. Pra, ti u ke thënë të tjerëve që "më emëroi Hashim
12 Thaçi si komandant të ri në emër të Shtabit të Përgjithshëm",
13 kështu?
- 14 PË. U kam thënë që ma ka komunikuar emërimin në Shtab të
15 Përgjithshëm, domethënë, Hashim Thaçi në emër të Shtabit të
16 Përgjithshëm.
- 17 PY. Pra, zëvendëskomandant ishte Balim Muharremaj, mirë e
18 thashë?
- 19 PË. Po.
- 20 PY. Sadri Emërllahu u bë ndihmës logjistike, ndihmës për
21 logjistikën?
- 22 PË. Po.
- 23 PY. Musë Kollolli u bë ndihmës për zbulim kundërzbulim,
24 kështu?
- 25 PË. Po.

1 PY. Ylmet Fondaj u bë përgjegjës për policinë ushtarake?

2 PË. Po.

3 PY. Po Ukë Bytyqi pati ndonjë rol në ristrukturimin e
4 Brigadës 123?

5 PË. Po edhe ai kishte rolin e marrëdhënies civile-ushtarake
6 në kuadër të brigadës, se kjo marrëdhënie civile-ushtarake
7 ishin shumë të dobishme dhe të domosdoshme në atë periudhë
8 edhe Ukë Bytyqi ka dhënë kontribut të madh në këtë çështje.

9 PY. A pajtohesh me mua që ti u ke thënë të gjithë këtyre
10 personave që Hashim Thaçi më komunikoi vendimin që më emëronte
11 komandant të ri të Brigadës 123?

12 PË. Po.

13 PY. Mirë. Do të tregoj një diçka që ia keni dhënë ju ZPS-së
14 edhe një nga personat që identifikova unë ishte komandanti i
15 logjistikës, për logjistikën Sadri Emërllahu.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Do të doja që të vendosej në ekran
17 materiali përkatës.

18 PY. Presim që të dali dhe anglishtja. Por kur i keni dhënë
19 këtë dokument ZPS-së i keni thënë që ky është një dokument i
20 përgatitur nga Sadri Emërllahu në 2006, kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Ai e ka lexuar publikisht në qershor të 2006 më ditën e
23 pavarësisë së Suharekës, domethënë, ishin festimet e
24 pavarësisë së Suharekës, kështu?

25 PË. Dita e çlirimit të Suharekës, 13 qershori 2006.

1 PY. Po e lexoj për publikun me zë, apo jo?

2 PË. Po.

3 PY. I thatë ZPS-së se fillimisht ju keni thënë që çdo gjë në
4 këtë dokument është e vërtetë dhe e saktë, po me përjashtim të
5 disa gabimeve gramatikore keni thënë dhe disa data që mund të
6 jenë gabim një a dy ditë gabim. Ju kujtohet që e keni thënë
7 këtë?

8 PË. Po. Po në mesin e tyre është edhe çështja se Sadri
9 Emërllahu në këtë dokument shkrun që u zgjodh unanimitisht
10 komandant i brigadës, që nuk qëndron, që unë jam zgjedhë. Po
11 jam emnu.

12 PY. Do flasim dhe për këtë. Po ama nuk e thotë kështu as në
13 shqip as në anglisht.

14 Z. MISETIC: [Përkthim] Do ta shohim më konkretisht është
15 faqja 8 në anglisht edhe në shqip. Nëse nuk keni të gjithë
16 dokumentin atëherë do ua jap unë numrin. Është 083227 deri në
17 083248-ET, faqja 8. Në shqip 083226 deri në 083248 RED2, faqja
18 8.

19 Sekretar i seancës, ju kërkoj ndjesë, ngatërresa ishte
20 nga ana jonë, por dokumenti që është pranuar ka qenë me 13
21 faqe dhe jo me 3 faqe. Është në transkriptin provizor është
22 faqja 10, rreshti 19 deri në 21, ju e përmendët vetë dhe thatë
23 që është me numër P0133 pjesë e dokumentit që mban numrin e
24 përgjithshëm 083227 deri në 083239.

25 Shkojmë në faqen 8 të këtij dokumentit në anglisht dhe në

1 shqip.

2 PY. Dëshmitar, mesa kuptoj unë në shqip, këtu nuk thuhet që
3 jeni zgjedhur. Unë po ua lexoj në anglisht, thuhet:

4 "Pikërisht më 8 tetor 1998 në orët e mbrëmjes në shtëpinë
5 e Gani Sallaukës në Studençan u bë riorganizimi i Brigadës 123
6 të UÇK-së për zonën e Suharekës. Komandant i Brigadës 123 në
7 mënyrë unanime u emërua eprori Kurtesh Fondaj i cili në stafin
8 e tij kishte këtë përbërje e vijon".

9 Pra në shqip "emëruar" është dhe në shqip fjala "emëruar"
10 është, apo jo?

11 PË. Po, po është në mënyrë unanime, del sikurse emnimi është
12 bë nga këta anëtarët e shtabit, jo ndonjë organ jashtë kësaj.

13 PY. Në fakt i parapritë pyetjes time të radhës, z. Emërllahu,
14 kur ka përdorur termin "unanim", ka dash të nënkuptoj që ka
15 pas dy a më shumë persona që kanë qenë të përfshirë në
16 emërimin tuaj si komandant, apo jo?

17 PË. Sipas interpretimit tim, atë që e ka thënë Sadri
18 Emërllahu, del që unë komandant i brigadës jam bë nga ekipa,
19 respektivisht shtabi i mëvonshëm që quhet komanda e brigadës.
20 Nëse e shikojmë me kujdes përmbajtjen del kjo, mirëpo unë e
21 kam dhënë sqarimin në deklarin ZPS-së që këtu kemi të bëjmë me
22 gabim.

23 PY. Kur ju pyeta më herët një nga personat e përmendur Sadri
24 Emërllahu, dhe ky ishte një nga personat që ju ia thatë atij,
25 se ai u bë dhe ndihmësi juaj për logjistikën. Pra, ju atij ia

1 keni thënë që jeni emëruar ose më saktë u informuat për
2 emërimin tuaj nga Hashim Thaçi. Tani a keni ndonjë shpjegim ju
3 pse në 2006 Sadri Emërllahu nuk e thotë kështu por thotë që
4 diçka ka ndodhur në shtëpinë e Gani Sallaukës ku jeni emëruar
5 në mënyrë unanime nga personat e pranishëm në atë mbledhje apo
6 takim?

7 PË. Nuk muj me dhënë interpretim këtij dokumenti. Veç se
8 mendimi jem është që ai ka gabu në terminologji. Se çështje
9 nuk është edhe aq e thjesht po takohen shtatë-tetë persona dhe
10 gjithsecili njani-tjetrin po e vendosin edhe bashkërisht po e
11 formojnë një komandë brigade. Kjo realisht nuk shkon kështu.

12 PY. Unë po ju them se dokumenti që ju tregova në Facebook pak
13 më përpara ku u krijua shtabi lokal, është pikërisht mënyra
14 sesi u krijua, apo jo? Pra, personat e zonës u bashkuan dhe
15 zgjodhën Blerim Kuqin si komandant të shtabit në Suharekë, apo
16 jo, shtabit lokal?

17 PË. Megjithatë, ato dy njësite ushtarake kishin një farë
18 strukture dhe ato, pak a shumë, ranë dakord që ta formojnë një
19 shtabi rajonal fillimisht e pastaj nga ai shtab rajonal po
20 gati e njëjta strukturë kaloi dhe në komandë të brigadës.
21 Mirëpo realisht, çështja e emërimeve në ushtri nuk shkon, nuk
22 shkon në këtë mënyrë.

23 PY. Do të bëj një pyetje tjetër. Në këtë takim në shtëpinë e
24 Gani Sallaukës më 8 tetor ti vetë ke qenë i pranishëm?

25 PË. Edhe kjo data 8 është gabim e shkruar. Duhet me qenë 10

1 tetor. Po ky dokument për të cilin realisht e posedon Gjykata
2 ka mujt me pas plotësime dhe ndryshime se mu më është dhënë
3 versioni për me e korrigjue këtë dokument. Po unë e kam pas në
4 lexim dokumentin, draft dokumentin që është lexu në ditën e
5 çlirimit. E saktë se çka përmbajtje ka pas rreth kësaj a është
6 përmirësu ky gabim a jo, unë nuk e di, po ky dokument ka dalë
7 si, domethënë, është draft dokument i një historiku që është
8 lexue më 13 qershor 2006.

9 PY. Mirë. Po pavarësisht a ka qenë 8 a 10 data, ke qenë i
10 pranishëm fizikisht ti në shtëpinë e Sallaukës në këtë rast?

11 PË. Po, unë e kam organizue takimin dhe unë i kam thirr
12 personat e caktum dhe ia kam komunikue emnimet dhe detyrat në
13 kuadër të komandës së brigadës të gjithë anëtarëve këtu që
14 përmenden në vazhdim.

15 Dhe një çështje në mes me sqaru. Se Sadri Emërllahu
16 personalisht vetë nuk ka qenë prezent në këtë takim. Të
17 tjerët, anëtarë tjerë, po. Prandaj edhe ka mujt me pas këtë
18 informim të gabueshëm se ai nuk ka qenë prezent në këtë takim.
19 Kjo është plotësim, këtu nuk më ka pyet kërrkush po realisht
20 se është mu kujtue dhe po e jap këtë fakt.

21 PY. Po Hashim Thaçi ka qenë i pranishëm në këtë takim?

22 PË. Jo.

23 PY. Po tani po thua që Sadri Emërllahu nuk ka qenë i
24 pranishëm. Po Bali Muharremaj ka qenë i pranishëm?

25 PË. Të gjithë të tjerët kanë qenë të pranishëm. Ka qenë i

1 ftum dhe Sadri Emërllahu, po ai ka mungu nuk ka ardh në këtë
2 takim.

3 PY. Kur thoni gjithë "të tjerët" e ke fjalën për personat e
4 tjerë që janë në këtë listë në faqen që kemi përpara, pra,
5 Bali Muharremaj, Ukë Bytyqi, Musë Kollolli, Ylmet Fondaj, Isë
6 -

7 PË. Isë.

8 PY. Morina? Për këta e ke fjalën?

9 PË. Po. Po, po.

10 PY. Nga këta persona që jetojnë ende a mund ta konfirmojnë
11 këta persona që ju u keni thënë atyre se jeni informuar nga
12 Hashim Thaçi që jeni komandanti i ri, personat që janë ende
13 gjallë mund ta konfirmojnë këtë?

14 PË. Po realisht ndoshta a mirë me i pyet, mos mbet nën atë
15 tash vetëm në mue që me thanë që unë nëse pasna bë, domethënë,
16 nëse pasna bë diçka në krye në vete, kjo është çështje krejt
17 tjetër. Po megjithatë po, duhet me i pyet ndoshta. Nëse doni
18 me kërku vërtetësinë, pyetni.

19 PY. Jo, nuk po them. Po them mesa ke ti dijeni, ti u ke thënë
20 atyre në këtë takim që Hashim Thaçi më përcolli emërimin, pra,
21 mesa keni ju dijeni, nuk ka asnjë arsye që këta persona të mos
22 e konfirmojnë këtë, pra, që ti u ke thënë atyre në atë takim
23 në shtëpinë e Gani Sallaukës këtë mesazh, kështu?

24 PË. Kjo saktë. Po unë tash po e përmendi që thashë që Sadri
25 Emërllahu ka mungu në këtë takim. Prandaj kanë mujt me rrjedhë

1 këto që i përmendëm, këto gabime. Po megjithatë që prapë po e
2 përsëris, që ky dokument ka qenë draft i historikut, jo
3 dokumenti përfundimtar që është lexue në ditën e çlirimit. Po
4 drafti që më është dhënë me kontrollu mos rastësisht po ndodh
5 ndonjë, mos ka bë ndonjë gabim. E thashë a e kam përmirësu unë
6 a jo këtë dokument nuk e di edhe unë. Ka kalu shumë kohë, nuk
7 mbaj mend.

8 PY. Flasim për diçka tjetër por që ka lidhje. Në intervistë
9 për ZPS-në keni thënë se keni menduar se z. Thaçi ua përcolli
10 emërimin sepse ai dhe z. Selimi ishin të vetmit persona nga
11 Shtabi i Përgjithshëm që ishin ende në Kosovë. A ju kujtohet
12 që e thatë këtë?

13 PË. Po.

14 PY. Po ashtu thatë se kur keni hyrë në Kosovë shkurtimisht
15 pasi keni shkuar në Kosovë jeni takuar me Jakup Krasniqi dhe
16 Sokol Bashotën. Ju kujtohet?

17 PË. Unë kam qenë në Kosovë. Po më 10 qershor kam udhëtue në
18 fshatin Negroc edhe aty kam kontaktue e i kam pa këta persona
19 për herë të parë.

20 PY. Ke të drejtë. Të kërkoj falje. Ishe në Kosovë. Po a e
21 dije ti aso kohe apo dhe më pas se Jakup Krasniqi dhe Sokol
22 Bashota ishin pjesë e Shtabit Qendror që më pas u bë Shtabi i
23 Përgjithshëm?

24 PË. Për mu ishin persona shumë të rëndësishëm. Se çfarë posti
25 ata kanë mbajt dhe si janë quajt ato, unë nuk kam pas

1 informacione. Po megjithatë e dijsa që janë njerëz të
2 rëndësishëm edhe për mue. Edhe atëherë, po edhe sot janë shumë
3 të respektum.

4 PY. Po në fillim të tetorit 1998 e dije që Jakup Krasniqi dhe
5 Sokol Bashota ishin anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm?

6 PË. Po tash kur po flitet për Shtabin e Përgjithshëm nuk i di
7 edhe unë. Tash nuk po muj me i kuptu disa terma se janë
8 përdorë si nocion "Shtabi Qendror", "Shtabi Përgjithshëm". Po
9 me një çështje po e di diçka, që ata kanë qenë struktura të
10 larta të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Prej këtij pozicioni
11 sot këtë muj me konfirmue. A për sa i përket asaj a kanë qenë
12 anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm edhe kur u kriju shtabi,
13 nuk e di.

14 PY. Më fal, të kërkoj ndjesë, se mbase është gabimi im se unë
15 nuk jam i qartë, kështu që të lutem të më ndihmosh. Tek
16 intervista për ZPS-në ke thënë kështu.

17 Z. MISETIC: [Përkthim] Dhe po ua them për referencë për
18 palët që është prova materiale P1327.1.

19 PY. Keni thënë kështu:

20 "Me singëritet, në atë periudhë në Kosovë" flasim për
21 fillimin e tetorit 1998, "vetëm Hashim Thaçi dhe Rexhep Selimi
22 kanë qenë të pranishëm ose anëtarë ose udhëheqës të këtij
23 Shtabi të Përgjithshëm. Pjesa tjetër nuk ishin në Kosovë."

24 Në fakt kur ti nuk e dije kush ishte pjesë e Shtabit të
25 Përgjithshëm, atëherë nga e di ti që ishin këta të vetmit

1 persona të Shtabit të Përgjithshëm ende në Kosovë?

2 PË. Po ishin qe ata pjesa që ne e quajtmshim qoftë Shtab
3 Qendror, qoftë Shtab i Përgjithshëm. Realisht me të cilët unë
4 e kam pas kontakte kanë qenë më të vërtetë vetëm këta dy.

5 PY. Në atë kohë e keni fjalën?

6 PË. Po flas për tetor, sidomos për tetor se në fazën e
7 nëntorit kanë fillu me u kthye edhe të tjerët në mesin e tyre
8 është kthy edhe Bislirn Zyrapi.

9 PY. Në intervistën për ZPS-në gjithashtu keni thënë - dhe për
10 referencë është materiali P01327.1, faqja 27, rreshtat 17 dhe
11 21 - pra, keni thënë që në atë kohë besonit se z. Thaçi ka
12 qenë në kontakt me Bislirn Zyrapi, "kështu që u emërova në
13 mënyrë të ligjshme dhe jo në mënyrë të paligjshme".

14 Dhe më pas në Shënimin Përgatitor thoni diçka të
15 ngjashme. Thoni:

16 "... emërimin ma komunikoi Hashim Thaçi më 6 tetor. Por
17 emërimi në vetvete ishte përgjegjësi e Bislirn Zyrapi - nëse
18 Hashim Thaçi u konsultua me Bislirn Zyrapi apo këtë emërim e
19 bëri vetë unë nuk e di."

20 Kështu?

21 PË. Po.

22 PY. Pra, kjo që keni thënë në 2019, pra, që besonit se z.
23 Thaçi thjesht u ka komunikuar emërimin nga Bislirn Zyrapi,
24 kështu?

25 PË. Po në bazë që logjikës së funksionimit të gjënave, unë po

1 vete te ky përfundim.

2 PY. Kur thoni në 2019 meqë z. Thaçi ishte në komunikim me z.
3 Zyrapi unë u emërova në mënyrë të ligjshme dhe jo të
4 paligjshme, çfarë do kishte qenë një mënyrë e paligjshme? Ose
5 po e bëj dhe një herë pyetjen. Do të kishte qenë e paligjshme
6 nëse z. Thaçi do t'ju kishte emëruar ju pa u konsultuar
7 paraprakisht me z. Zyrapi, sipas jush?

8 PË. Nuk po hyj në atë, po duhet të ishte e paligjshme
9 vendosja jeme në mënyrë arbitrare vetë veten unë me caktu
10 komandant brigade. Këtu unë këtë e kam mendu, jo në çështje
11 tjera.

12 PY. Po bazuar në këtë që sapo thatë, ju po thoni në dëshminë
13 tuaj, që për të mos u emëruar në mënyrë arbitrare, emërimi
14 juaj duhet të kishte ardhur prej z. Zyrapi?

15 PË. Mesa di unë, në periudhën e tetorit, nëntorit, po edhe të
16 shtatorit edhe ma vonë emërimet janë bë ushtri në mënyrë
17 ekskluzive nga Bislam Zyrapi për sa i përket komandantëve të
18 brigadave.

19 PY. Okej. Tani kalojmë tek një çështje tjetër. Në Shënimin
20 Përgatitor numër 1, në paragrafin 42, ju thoni që në tetor të
21 1998, Hashim Thaçi nuk ju lëshoi ndonjë urdhër të posaçëm,
22 specifik apo atë të një natyre të përgjithshme për të sulmuar
23 vendndodhjet e serbëve. E mbani mend që ta keni thënë këtë
24 gjë?

25 PË. Po, e kam thënë.

1 PY. Okej. Dhe në paragrafin 42 të Shënimit Përgatitor ju
2 thoni që këto urdhra ju vinin nga z. Thaçi me gojë dhe jo me
3 telefon, e vërtetë?

4 PË. E vërtetë.

5 PY. A e kuptova siç duhet që kjo do të thotë që jua jeni
6 takuar me z. Thaçi personalisht dhe ai këto urdhra jua jepte
7 me goje?

8 PË. Po ke bëhet fjalë për dy, tri takime, jo ma tepër. Edhe
9 normal që komunikimi, pra, ka qenë në qeto dy, tri takime, jo
10 ma shumë.

11 PY. Okej. Pra, këto dy, tre takime kanë ndodhur në tetor të
12 1998, është e saktë kjo?

13 PË. Në tetor edhe në nëntor.

14 PY. Kur ka qenë takimi i fundit në nëntor të 1998?

15 PË. Nuk e di datën saktë, po nëse s'gaboje kemi pas një takim
16 në Nishor. Nuk e di saktë datën.

17 PY. Atëherë për çfarëdo lloj takimi që ju mbani mend ose aty
18 ku z. Thaçi ju ka dhënë urdhrat me gojë a mund të na jepni
19 vendndodhjen e saktë të këtyre takimeve, pra, ku kanë ndodhur
20 këto takime saktësisht?

21 PË. Kur ma ka komunikuar urdhrin me gojë ka qenë fshati Marali
22 fillimi, domethënë, muajit tetor. Saktë edhe aty nuk më
23 kujtohet data. A pastaj taku me të ma vonë për herë të fundit
24 kemi qenë gjatë muajit nëntor, ky ka qenë në fshatin Nishor.

25 PY. Atëherë që ta kuptoj siç duhet. Ju ka dhënë ndonjë urdhër

1 në Nishor?

2 PË. Në Nishor nuk më ka dhënë urdhër.

3 PY. Pra, çfarëdo lloj urdhrash që do t'ju ketë dhënë me
4 ç'mbani mend ju, ka qenë në fshatin e Marallisë, apo jo?

5 PË. Në Marali. Vetëm një herë ka qenë ajo. S'ka pas urdhra
6 tjera.

7 PY. Në ç'ndërtesë në fshatin e Maralisë?

8 PË. Në oborrin e një shtëpie private.

9 PY. Kur thoni "shtëpi private", ishte një vend i komandës së
10 UÇK-së, ishte konvertuar për ndonjë lloj pune nga UÇK-ja?

11 PË. Diçka e ngjajshme ka mujt me ndodhë. Nuk e di saktë. Veç
12 e di që jemi takuar në Marali, në fshatin Marali.

13 PY. Kush ishte i pranishëm gjatë kësaj bisede, kush tjetër?

14 PË. I pranishëm ka qenë vetëm Fatmir Limaj dhe askush tjetër.

15 PY. Nuk sollët për shembull, zëvendëskomandantin me vete ose
16 ndokënd tjetër nga shtabi juaj që të ishte i pranishëm që të
17 takohej me dikë që vinte nga Shtabi i Përgjithshëm për
18 shembull?

19 PË. Jo. Veç e kam pas përcjellësin, ushtarin që më ka
20 përcjellë zakonisht, po ai nuk ka qenë afër meje në momentin
21 ikur kemi zhvillu bisedën.

22 PY. Kur u rikthyet tek shtabi juaj për të kaluar, për të
23 përçuar urdhrin, pra, për të sulmuar pozicionet serbe në
24 përgjithësi, a mund të na tregoni emrat e anëtarëve të shtabit
25 tuaj që kanë marrë urdhrin që i keni dhënë ju?

1 PË. Po, kryesisht mbase me komandantët e batalionit të
2 Butakovës edhe me komandantët e kompanive të Batalionit të
3 Parë të cilin e komandoja unë. Po tash me emna veçantë nuk po
4 më kujtohen. Nuk më kujtohen.

5 PY. A mund të na jepni emrin e dikujt që mund të ketë
6 mundësinë, që me ç'dini ju, do të duhet që të konfirmojë që
7 këtë urdhër që ju e keni marrë ia keni përçuar atyre poshtë
8 jush? Një emër. Më duhet një duhet një emër. Të paktën një
9 emër ju lutem.

10 PY. A për fatkeq bash një emën për të cilin realisht ndoshta
11 e përmendi dhe ma herët Prokurori, ai sot nuk është i gjallë.
12 Është fjala Isë Morina, po ai ka qenë komandant q'atë kohë i
13 batalionit të Budakovës. Ndërsa të tjerët janë batalionit --
14 tash tjerët, Ylmet Fondaj ka qenë i policisë ushtarake. Këta
15 struktura tjerë të brigadës Musë Kollolli. Gjithashtu edhe Ukë
16 Bytyqi më s'është i gjallë është i ndjerë. Këta tjerët në
17 kuadër Bali Muharremaj si zëvendëskomandant gjithashtu ka qenë
18 i informum, normale. Po ashtu edhe Sadri Emërllahu ka qenë i
19 informum si përgjegjës për logjistikë.

20 Po kanë qenë dhe komandantët e kompanive po emrat e tyre
21 nuk po më kujtohen.

22 PY. Pra, nga të gjithë këto emra që ju na keni dhënë të
23 gjithë këta persona që jetojnë, mund ta konfirmojnë që ju jeni
24 kthyer dhe u keni thënë që "mua më ka thënë Hashim Thaçi që në
25 përgjithësi të sulmojmë pozicionet e serbeve", është e saktë

1 kjo?

2 PË. I kam komunikuar, sigurisht që i kam komunikuar. E tash, ata
3 do të përgjigjen? Ajo është çështje e tyre. Kryesorja këtë që
4 po e them është e vërtetë.

5 PY. Në rregull. Ju i kishit thënë ZPS-së në Pjesën 8 të
6 intervistës së ZPS-së, në faqet përkatëse, në faqen 14,
7 rreshtat 9 deri në 14. Në kontekstin e Fatmir Limajt. Pyetja
8 që ju bë juve ishte nëse Fatmir Limaj në cilësinë e tij si
9 shef i drejtorisë së policisë ushtarake të UÇK-së ju kishte
10 lëshuar një urdhër, ju a do ta kishit zbatuar atë urdhër si
11 komandant i Brigadës 123 dhe ju thatë, citoj:

12 "Unë personalisht jo. Së pari do të kisha kërkuar
13 miratimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm".

14 E mbani mend ta keni thënë këtë gjë?

15 PË. Kam mujt me e thënë. Në parim, kjo ashtu ish dasht me
16 funksionu, se Fatmir Limaj, domethënë, në pjesën e dytë mbas
17 dhjetorit ka qenë komandanti i policisë ushtarake. Komandant i
18 brigadës, respektivisht një epror i brigadës urdhrat e merr
19 nga shefi i shtabit ose komandanti i ushtrisë e jo nga ndonjë
20 organ i posaçëm sikur në këtë rast policia ushtarake.

21 PY. Pra a mund të na shpjegoni se përse ndodh që një
22 komandant brigade, me ç'kuptoni ju, nuk do të pranonte urdhra
23 nga një anëtar i një drejtorie të Shtabit të Përgjithshëm?

24 PË. Po në strukturën ushtarake, urdhrat mirren nga
25 komandanti, respektivisht shefi i shtabit. Ndërsa të gjithë

1 drejtorët, po i quajmë ne ata të drejtorive si janë quajt në
2 Shtabin tonë të Përgjithshëm, ata janë këshilltarë të shefit
3 shtabit. Prandaj si këshilltarë, ata duhet me i kërku
4 komandantit, respektivisht shefit të shtabit e urdhrin ta
5 formulojë shefi i shtabit e jo me shku direkt përmes
6 drejtorëve të drejtorive.

7 Prandaj në këtë logjikë unë do të kërkoja sqarim nga
8 shefi i shtabit. Pra, kjo është hipotetike, s'kam pas rast po
9 megjithatë i hyna këtij sqarimi ndoshta pak pa nevojë.
10 PY. Në rregull. Dhe e vlerësoj përgjigjen tuaj. Tani do të
11 kaloj tek një çështje tjetër që kishim filluar ta diskutonim
12 që është largimi i Blerim Kuqit për në Shqipëri. Ju keni thënë
13 që ai u largua për të arritur marrjen e fondeve nga qeveria e
14 Bukoshit. Dhe në intervistën me ZPS-në, ju thatë që ai u
15 largua në 10 shtator të 1998, është e saktë kjo?

16 PË. Ka shkuar në Shqipëri diku rreth 10 shtatorit 1998. Po,
17 mirë thashë.

18 PY. Dhe në intervistën tuaj me ZPS-në, ju thatë ai
19 posaçërisht vajti që të takohej me Bujar Bukoshin dhe Ahmet
20 Krasniqin që ishte Ministri i Mbrojtjes, në mënyrë që të
21 merrte fonde për Brigadën 123. Është e saktë kjo?

22 PË. Po, është e saktë edhe realisht ai e ka përmbush këtë
23 detyrë.

24 PY. Okej. Bujar Bukoshi dhe Ahmet Krasniqi, a ishin eprorët e
25 Blerim Kuqit?

1 PË. Bujar Bukoshi ishte kryeministër i Qeverisë në Ekzil.
2 Ndërsa ndërkohë ishte formuar Ministria e Mbrojtjes në kuadër
3 të asaj qeverie dhe ajo për momentin funksionojke vetëm në
4 Tiranë. Por ne realisht tash po e përmendni kemi arritur më
5 vonë gjatë muajit nëntor është arrit një marrëveshje ushtarake
6 e cila si rezultat i saj janë fut në territorin e Kosovës një
7 numër i konsiderueshëm eprorësh edhe ushtarësh që kanë qenë
8 nën kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes. Dhe ata kanë dhënë një
9 kontribut të madh në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

10 PY. Po. Dëshmitar, unë e di që ju jeni ushtar profesionist
11 dhe oficer i tillë, dhe po ju bëj një pyetje specifike dhe do
12 t'ju lutesha që të bënit të pamundurën që përgjigjen tuaj të
13 ma jepnit precise. Pyetja ime edhe një herë është: Bujar
14 Bukoshi dhe Ahmet Krasniqi a ishin në vijën e komandës së
15 Blerim Kuqit?

16 PË. Zoti Avokat, por edhe ju kur e formut ose tregut se si
17 është formu njësitit Lisi, dhe pastaj bashkimi i njësiteve në
18 një shtab rajonal e pastaj në brigadë, tregut që është bërë si
19 një lloj kompromisi.

20 Edhe këtu realisht nuk është konë ministria e Bukoshit
21 ndonjë ministri, ose Qeveria e Bukoshit ndonjë qeveri e dikujt
22 ndonjë shteti tjetër. Ajo ka qenë e shtetit tonë, Kosovës.
23 Edhe jona ka qenë që për me mujt me mbijetu neve na është
24 dashtë financim, i pari material.

25 Nuk kemi mujt me ekzistim po qe se s'kishim pas

1 mbështetjen e Qeverisë Bukoshi, e cila realisht po e përmendi
2 edhe një herë në fund të -- sidomos në fund të nëntorit nuk ka
3 mungu dhe komplet zona operative e Pashtrikut prej atij
4 momenti financohet nga Qeveria Bukoshi.

5 PY. Jam dakord dhe do të arrijmë në atë pikë, ju premtoj këtë
6 gjë, pas pak ama. Megjithatë, tani për tani unë ende nuk e di
7 përgjigjen tuaj dhe duhet të jetë përgjigje me po ose me jo.
8 Pra, Bujar Bukoshi dhe Ahmet Krasniqi a ishin pjesë e
9 zinxhirit komandues të Blerim Kuqit? Ju mund të përgjigjeni me
10 po ose me jo.

11 PË. Jo.

12 PY. Okej. Në rast se jo, atëherë a e dini nëse Blerim Kuqi
13 kishte leje nga ndokush tek Shtabi i Përgjithshëm që të
14 largohej nga brigada dhe të shkonte dhe të takohej me Bukoshin
15 dhe Krasniqin?

16 PË. Blerim Kuqi para se me shku së paku tri ditë ka insistu
17 me u taku me anëtarë të Shtabit të Përgjithshëm që po i qujmë
18 të Shtabit të Përgjithshëm ose Shtabit Qendror, po s'ka mujt
19 me komuniku me asnjë edhe ka ec, ka shkue për Shqipëri se
20 situata ka qenë emergjente në atë moment edhe thjesht shumë e
21 rëndë.

22 PY. A jeni në dijeni në faktit që Bislum Zyrapi ishte i
23 inatosur me Blerim Kuqin dhe madje e ka akuzuar që ka
24 braktisur brigadën. Është e saktë kjo?

25 PË. Po.

1 PY. Jeni në dijeni besoj gjithashtu që Bislum Zyrapit ka thënë
2 që Blerim Kuqi duhet të arrestohet për dezertim, e saktë?

3 PË. Jo, për këtë nuk jam në dijeni.

4 PY. A e njihnit Tahir Zemajn, e dini kush është?

5 PË. E di, po me e njoft nuk e njof.

6 PY. A e dini që Tahir Zemaj ka qenë në zonën e Dukagjinit?

7 PË. Po.

8 PY. A e dini që Tahir Zemaj ka qenë pjesë e FARK-ut, e
9 Forcave të Armatosura të Republikës së Kosovës?

10 PË. Zoti Avokat, unë me përgjegjësi të plotë ju them që në
11 tetorin kur, në kohën sa ka funksionu zona operative e
12 Pashtrikut, respektivisht për qeta ushtarë që janë ardh me
13 Blerim Kuqin në fund të nëntorit 1998, nuk kanë pas shenja
14 kurrfarë të FARK-ut, po kanë funksionue si Ushtri Çlirimtare e
15 Kosovës edhe i kanë referu Shtabit të Përgjithshëm,
16 respektivisht Bislum Zyrapit.

17 Edhe një element. Futjen e tyre në territor të Kosovës e
18 kam bo unë, po kam qenë në koordinim me Bislum Zyrapin. Nuk e
19 kam ba krye në vedi. Por çdo herë për më të mirën të mundshme,
20 për forcim edhe unfikim të faktorit ushtarak, edhe e dyta
21 forcim të ushtrisë në kuptimin e luftimit të okupatorit, në
22 këtë rast pushtetit serb në Kosovë.

23 PY. Pra, me çfarë dini ju, Tahir Zemaj ka qenë nën komandën e
24 Shtabit të Përgjithshëm dhe raportonte tek Shtabi i
25 Përgjithshëm i UÇK-së?

1 PË. Për Tahir Zemën nuk e di, por realisht edhe aty ka pasë
2 në bazë të të dhënave që pak a shumë kam, ka pasë një moment
3 në një përafrim, po pastaj prapë janë largue strukturat e --
4 domethënë Tahir Zemaj me Ramush Haradinaj. Po ç'ka ka ndodh
5 saktë mes tyre unë nuk e di.

6 PY. A e dini që Tahir Zemaj -- edhe Tahir Zemaj u tërhoq nga
7 zona e Dukagjinit dhe pothuajse në të njëjtën kohë si Blerim
8 Kuqi, në të njëjtën kohë si ai ka shkua në Shqipëri?

9 PË. Jo, Tahir Zemaj shumë ma herët është tërhjek për
10 Shqipëri, nuk është përafërsisht e njëjta kohë. Barëm
11 përshtypja, më falni që ju ndërpreva.

12 PY. Pra, kur thoni "shumë më përpara" sa përpara 10 shtatorit
13 ka është tërhequr Tahir Zemaj për në Shqipëri?

14 PË. Po ka -- në fazën e luftës një javë është shumë. Po tash
15 në çfarë rrethana, unë nuk i di. nëse s'gaboju ai ka qenë gjatë
16 muajit ose korrik ose fillimi i gushtit. Nuk jam i sigurt, po
17 nëse s'gaboju bëhet fjalë për q'atë periudhë.

18 PY. Okej.

19 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lejoni t'ju tregoj tashmë një
20 dokument tjetër që është pranuar dhe ka numrin P1336.

21 PY. Dhe është një dokument tjetër që ju ja keni dhënë ZPS-së.
22 A mund të ma konfirmoni, a e keni dhënë ju këtë dokument ZPS-
23 së? Është e saktë kjo?

24 PË. Po, e saktë është.

25 PY. Okej. Ky është një dokument me datën 27 tetor 1998. Dhe

1 është lëshuar nga Ministri i Mbrojtjes i Qeverisë së Bukoshit,
2 Halil Bicaaj. Është e saktë kjo?

3 PË. E saktë.

4 PY. Dhe në bazë të këtij urdhri Halil Bicaaj ju emëron si
5 shefin e shtabit të zonës së Pashtrikut. Është e saktë kjo?

6 PË. E saktë.

7 PY. Dhe në dokument thuhet që ju emëroheni në zonën operative
8 numër katër të UÇK-së. Është e saktë kjo?

9 PË. Q'ashtu shkrun.

10 PY. Pra, -- jo, të bëj një pyetje tjetër më parë. Ky dokument
11 si ju është dhënë ju?

12 PË. Po do të tregoj në detaje nëse nuk më kishit ndërprerë,
13 kisha pas qejf me sqaru saktë këtë çështjen e dokumentit.

14 Është shumë e vërtetë që unë këtë dokument ne e kemi
15 marrë dikund domethënë është shtyp me 27 tetor, e këtë
16 dokument kemi mujt me -- kam mujt me e marrë në fillim të
17 nëntorit. Domethënë, diç ma larg se tri, katër ditë prej këtij
18 momenti. Ky dokument ka pasë edhe karakterin diplomatik ose
19 politik sepse ne e kemi përdorur këtë dokument edhe për
20 arritjen e një qëllimi në masivizim të Ushtrisë Çlirimtarë të
21 Kosovës, sidomos prej strukturave të LDK-së, dega Suharekë, të
22 cilët pas ofensivave që ndodhën sikurse -- sikur fillun me u
23 tërhjekë edhe me bo një farë lloj rezistence ndaj ushtrisë.

24 Edhe për me mujt me e tregu se ushtria është e unifikume,
25 gjithashtu unë kisha informacion non-stop u bisedojke rreth

1 unifikimit të ushtrisë, atëherë ne kur -- e kur e kam marrë unë
2 këtë urdhër, e kemi thirr kryetarin e degës LDK Suharekë, dhe
3 i kemi thënë që kemi një urdhnesë edhe kërkojmë që ju si LDK
4 mos të kryni veprime pa koordinim me neve. Nuk i kemi ndërpre
5 aktivitetin politik, por i kemi thënë, po i kemi thënë "ju
6 duhet t'i koordinoni veprimet me neve".

7 Edhe përgjigja e tyne ka qenë, saktë po e flas,
8 nënkryetari i degës së LDK-së, Viktor Markaj, edhe ai tha "Po
9 ne kryesisht takohemi çdo të premte me Presidentin Rugova edhe
10 kryesisht nga i marrim urdhrat". Atëherë, unë i thashë, bashkë
11 kemi qenë me Ukë Byqitin, të ndjerin, atëherë ne i thamë
12 "Njoftojeni Rugovën edhe thoni se kemi të bëjmë që mbrena
13 ekzistojnë eprorë që kanë emërime edhe nga Ministria e
14 Mbrojtjes, e Qeverisë së Bukoshit". Edhe ata e kanë njoftu.
15 Edhe pas këtij momenti pak ka qenë një dilemë, kryesia ç'ka me
16 veprue, ç'ka me bo në këtë rast.

17 Por Ukë Bytyqi, tash i ndjerë e shpik një thënie ku thotë
18 "Ka thonë Rugova, pa thënë fare, ka thënë Rugova duhet të
19 ndihmohen ata djelmoha se e kanë shumë seriozisht". Edhe kjo
20 pas këtij momenti realisht ne kemi pas mbështetjen e plotë të
21 -- edhe të faktorit -- të gjithë popullatës në komunën e
22 Suharekës. Prandaj, ky, këtë urdhër, ky urdhër ka pas edhe një
23 herë po e përmendi politik, po edhe diplomatik.

24 Edhe -- më falni edhe një çështje nëse më lejohet. Shefi
25 i Shtabit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë në dijeni

1 të këtij urdhri.

2 PY. Okej. Atëherë, t'i rikthehem pyetjes fillestare që bëra.

3 Kjo pyetje është që Halil Bicaaj, po bënte një takim për ju si

4 shef i shtabit të zonës operative numër katër, brenda për

5 brenda UÇK-së, që pra të kishte një pretendim nga z. Bicaaj që

6 ai mund të bënte emërimet të tilla në UÇK në atë kohë. A është

7 e saktë kjo?

8 PË. Për këtë, me rastin e këtij urdhri, unë e kam kontaktu me

9 ardhjen e shefit të shtabit nga Shqipëria edhe e kam njoftue

10 lidhur me këtë urdhër, edhe Bislime Zyrapi përmend, thotë "Nuk

11 është korrekte nga Halil Bicaaj të lëshojë urdhresa.

12 Marrëveshja, thotë, është bo mes Shtabit të Përgjithshëm edhe

13 Ministrisë së Mbrojtjes, por sipas marrëveshjes, thotë,

14 emërimet në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës bëhen nga unë,

15 thotë, e jo nga Ministria e Mbrojtjes, thotë. Prandaj kjo nuk

16 është korrekte". Po nuk ka pas ndonjë farë relevance. Nuk kemi

17 vepru na konform këtij urdhri. Unë nuk kam marrë kurrfarë

18 detyre konform këtij urdhri.

19 PY. Nëse mund të kalojmë tek fundi i faqes, ju lutem. Këtu

20 thuhet në fjalën e fundi:

21 "Emërohet për nevojat e shërbimit në FA."

22 Pra, "FA", do të thotë FARK këtu, apo jo? Forcat e

23 Armatosura Republikës së Kosovës. Është e saktë kjo?

24 PË. Forcat e Armatosura. Q'atë kuptim e ka.

25 PY. Po, por Forcat e Armatosura dhe dua të jem shumë specifik

1 këtu. "FA" është shkurtimi për FARK-un, Forcat e Armatosura të
2 Republikës së Kosovë, apo jo, e saktë?

3 PË. Nuk e di tash me -- çështja as nuk du me mbrojt as me
4 sulmu këtë urdhër. Por realisht unë tregova pse e kam marrë
5 edhe në çfarë kuptimi e kam përdor. Pra, ky urdhër e ka
6 masivizu Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës.

7 PY. Po. Po, por ky urdhër ju është dhënë juve disa ditë pasi
8 është lëshuar dhe dua të kuptoj se çfarë keni kuptuar ju vetë
9 dhe si e kuptoni këtë fjali që thuhet "Për nevojat e FA-së".
10 Pra, a do të thotë kjo që "emëruar për nevojat e shërbimit të
11 FA-së"?

12 PË. Po nuk du me spekulu tash se realisht ka kalu një
13 periudhë e gjatë edhe në bazë të njohurive të mia forcat e
14 armatosura e përfshijnë një nocion bukur të gjanë. Në kuadër
15 të kësaj është edhe ushtria edhe mbrojtja edhe siguria.
16 Domethënë forcat e mbrojtjes dhe të sigurisë, janë policia e
17 shumë, shumë elemente të tjera në forca të armatosura.
18 Prandaj, po mos shoh më detaje -- se realisht nuk muj mo me
19 bisedu me thonë ma tepër se nuk -- kam harrue shumë gjona prej
20 kësaj.

21 PY. Jua komunikoni me z. Bicaç përpara lëshimit të këtij
22 dokumenti?

23 PË. Jo, nuk kam komunikuar as para as mbrapa derisa ata janë
24 vendos pas luftës në Prishtinë. Pas luftës në Prishtinë jam
25 taku në dy raste me Halil Bicën, por jo ma shumë.

1 PY. Përpara pak minutash ju sapo dëshmuat që dëshironit që të
2 lëshohej ky dokument sepse ju dëshironit të rekrutoni persona
3 në zonë për të fuqizuar UÇK-në. Dhe me ç'kuptova unë prandaj u
4 lëshua ky dokument. Pra, si ja komunikuat Halil Bicajt këtë
5 gjë? Ka qenë me anën e LDK-së ka ndodhur?

6 PË. Jo, Blerim Kuqi kur është shku në Shqipëri ka komunikue
7 me ministrin edhe ka kërku që të fuqizojë ushtrinë. Edhe ai e
8 ka kërku këtë urdhër edhe Halil Bicaj e ka lëshu, edhe mu më
9 është përcjellë nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të
10 Kosovës.

11 PY. Në rregull. Dhe në fakt ju më pas u bëtë shef i shtabit
12 të zonës së Pashtrikut, apo jo? E saktë?

13 PË. U bona po me emërim të Bislime Zyrapi dhe jo në bazë të
14 kësaj shkrese.

15 PY. Në rregull. Po a është e saktë të themi që Bislime Zyrapi
16 në vijim të marrëveshjes që përmendët ju mes FARK-ut dhe UÇK-
17 së me 2 nëntor, pra Bislime Zyrapi thjesht konfirmoi një
18 propozim që vinte nga Qeveria e Bukoshit për t'ju emëruar ju
19 si shef shtabi në zonën e Pashtrikut?

20 Ose a po thoni ju që është një rastësi që edhe z. Bicaj e
21 më pas z. Zyrapi deshën që të ishit ju shef shtabi i zonës së
22 Pashtrikut?

23 PË. Nuk besoj që kjo shkresë ka ndikue te Bislime Zyrapi që të
24 bëjë emërimin tem si shef shtabi. Nuk besoj që kjo shkresë ka
25 pas efekt.

1 Z. MISETIC: [Përkthim] Do shohim një dokument tjetër.

2 Është prova materiale P633-ET dhe P633 në shqip në faqen 1.

3 PY. Ndërkohë që presim të shfaqet dokumenti në ekran ne kemi
4 folur dhe ju e dini që ka pasur marrëveshje në nëntor për
5 shkrirjen e forcave të Qeverisë Bukoshi me UÇK-në, kështu?

6 PË. Jam në dijeni të një marrëveshje që është bërë mes
7 Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Në këtë
8 rast Halil Bicës edhe Bislime Zyrapit. Jam njoftue nga Bislime
9 Zyrapit.

10 PY. Këtë dokument e ke parë ndonjëherë më përpara?

11 PË. Jo, jo.

12 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem të shkojmë më poshtë aty
13 ku duket nënshkrimi.

14 PY. Ky është urdhër për emërimet e lëshuar nga Bislime Zyrapit
15 më 12 shkurt 1999. Këtu emëron Nexhmedin Kastratin si shef
16 shtabi të zonës së Pashtrikut. E shihni?

17 PË. Po.

18 PY. Në atë kohë kur ka dalë urdhri, ju ishit shef shtabi i
19 zonës së Pashtrikut, apo jo? Pra, ju kishit qenë nga dhjetori
20 deri në momentin që doli ky urdhër, kështu?

21 PË. Nuk jam në dijeni të këtij urdhri, por unë e kam pas një
22 urdhër tjetër përmes të cilës i kam bërë dorëzime-pranimin e
23 detyrës edhe jam lajmëruar në Shtab të Përgjithshëm në marrjen e
24 detyrës së përgjegjësit për shkollim edhe stërvitje në
25 Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe pozicioni jem ka mbet

1 vakant.

2 Nëse bën veç një moment me pa edhe datën e këtij
3 dokumenti?

4 PY. Patjetër.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Më lart.

6 PY. Është data 12 shkurt 1999.

7 PË. Unë detyrën e shefit të shtabit e kam dorëzuar në fund të
8 shkurtit. Emërimi realisht qenka ma herët, po nuk po e shoh që
9 -- ky qenka i protokollum po nuk e shoh që ka nënshkrim.
10 Ndoshta është bërë gati në atë periudhë dhe unë detyrën e kam
11 ushtruar deri në fund të shkurtit, muajit shkurt.

12 PY. Ju e dini ama që Nexhmedin Kastrati ju zëvendësoi ju si
13 shef shtabi i zonës së Pashtrikut, apo jo?

14 PY. Saktë, po.

15 PY. A e dini që kur u bë Sylejman Selimi komandant i
16 përgjithshëm i UÇK-së?

17 PË. Me 7 shkurt 1999, kur delegacioni jonë kishte takimet në
18 Rambuje. Prandaj edhe po e mbaj mend datën.

19 PY. Pra, ky është një dokument që është pranuar nga
20 Prokuroria. Mban datën 12 shkurt 1999 ku duket sikur është
21 emëruar një person tjetër në pozicionin që më parë mbanit ju.

22 Z. MISETIC: [Përkthim] Ju lutem tani të shohim dokumentin
23 që mban numrin 01347.

24 PY. Këtë dokument --

25 Z. MISETIC: [Përkthim] Ja presim të dalë edhe shqipja.

1 PY. Dëshmitar, këtë dokument jua tregoi Prokurori sot
2 paradite.

3 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim tek pjesa ku duket
4 nënshkrimi në shqip.

5 PY. Ju thatë që ky ishte një dokument që e keni nënshkruar ju
6 në cilësinë e shefit të shtabit të zonës operative të
7 Pashtrikut dhe mban datën 12 shkurt -- më falni, 21 shkurt
8 1999. Pra, ju po thoni që ju nuk e dinit momentin që keni
9 nënshkruar këtë dokument që nëntë ditë më herët Bislum Zyrapi
10 kishte nxjerrë një urdhër ku emëronte Nexhmedim Kastratin si
11 shef shtabi?

12 PË. Zoti Avokat, dokumentin paraparak që ju e dhatë nuk pat as
13 nënshkrim as vulë. Kështu që po mendoj që ai dokument ndoshta
14 ka qenë i përgatitun por jo ekzekutiv.

15 PY. E drejtë, e drejtë. E pranoj.

16 Z. MISETIC: [Përkthim] Shohim një dokument tjetër që ka
17 numrin P1340.

18 PY. Dëshmitar, ju kujtohet kjo urdhëresë?

19 PË. Po.

20 PY. Kjo është urdhëresa ku Bislum Zyrapi të urdhëron - më fal
21 - urdhëron shefin e shtabit të zonës së Pashtrikut, eprorin
22 Kurtesh Fondaj që të dorëzojë detyrën e lartpërmendur në afat
23 prej tri ditësh dhe t'ja dorëzojë komandantit të zonës së
24 Pashtrikut, Ekrem Rexhës, kështu?

25 PË. Ashtu thotë dokumenti.

1 PY. Po thoni në dëshminë tuaj që z. Zyrapi e ka lëshuar këtë
2 urdhër me kërkesën tuaj?

3 PË. Po.

4 PY. Faleminderit.

5 Dëshmitar, në intervistën për ZPS-në keni thënë se keni
6 parë z. Thaçi në Divjakë në prill a maj 1999. A ju kujtohet?

7 PË. Edhe një herë nëse bën pyetjen, ju lutem. p

8 PY. Patjetër. Në intervistën që keni dhënë për ZPS-në, më
9 duhet të jap edhe citimin për palët, është SPOE13427, ju keni
10 thënë që në Divjakë keni parë z. Thaçi në prill ose në maj
11 1999. Ju kujtohet?

12 PË. Në prill 1999 në Divjakë, nuk e di ç'ka ka mujt me
13 rrjedhë, por jo, nuk e kam pa Hashim Thaçin në prill në
14 Divjakë. Por, në Jezercë, po.

15 PY. Mbase është gabimi im atëherë, mbase ka qenë Jezercë. Sa
16 herë e keni parë atje?

17 PË. Po disa ditë kemi qenë bashkë. Nuk mbaj mend sa,
18 domethënë ditët, por katër, pesë ditët kemi qenë bashkë.

19 PY. Gjatë kohës që ishit atje, keni parë ndonjë person që
20 ishte i ndaluar, persona të ndaluar apo qoftë objekte ku
21 mbaheshin persona të ndaluar?

22 PË. Jo, jo, nuk ka pasë.

23 PY. Sa i takon komunikatave tani - është diçka që përmendet
24 në materialin P01327.7 faqja 32, rreshtat 2 deri në 5. I keni
25 thënë Prokurorisë se nuk keni pasur dijeni për asnjë

1 komunikatë të lëshuar nga UÇK-ja kur të përmendeshin
2 kolaboracionistët, kështu?
3 PË. Komunikata që janë dhënë ato përmes mjeteve të informimit
4 sa kam mujt me i pa, përndryshe sot në mënyrë specifike nuk
5 mundem me fol bash për asnjë.

6 PY. Po ju pyes për diçka që ja keni thënë ZPS-së dhe unë po
7 ja u lexoj. Është Pjesa 7 e intervistës për ZPS-në, faqja 32,
8 rreshti 2, thuhet kështu:

9 "A e dinit ju që komunikatat e lëshuara prej Shtabit të
10 Përgjithshëm përmendnin edhe kolaboracionistët apo shqetësime
11 lidhur me kolaboracionistët?"

12 Dhe ju jeni përgjigjur:

13 "Nuk kam dijeni për këtë."

14 Kështu?

15 PË. Po, edhe tash të njëjtën gjë e pohova. Bash s'kam lidhje
16 me këto.

17 PY. Pra, në se kanë ekzistuar komunikata të tilla, këto
18 komunikata s'ua kanë përcjellë as njerëz si ju, as si
19 komandant batalion, as si komandant brigade, as si shef shtabi
20 i zonës së Pashtrikut, kështu?

21 PË. Unë nuk kam pa në formë të shkrueme ndonjë prej këtyre
22 komunikatave.

23 PY. Dhe nuk i keni parë as në media ama, kështu? As si --
24 flasim për gjatë luftës.

25 PË. Nuk di. Realisht edhe mjetet e informimit respektivisht

1 mjetet e shkrume kanë qenë bukur të kufizume në atë periudhë.
2 Nuk muj me thonë diçka se faktikisht nuk kam ndonjë farë
3 informacioni që mundem me e lidh edhe me thanë, po ose jo. Nuk
4 -- ose ma tepër me thanë që jo, nuk kam pasë informa rreth
5 lëshimit të komunikatave
6 PY. I thatë ZPS-së se kur flisni për komunikatat këtu
7 përfshini edhe deklaratat që ka lëshuar Adem Demaçi dhe Albin
8 Kurti. Kështu?
9 PË. Për ato që ka lëshu Adem Demaçi është një që e mbaj mend
10 mirë, një [e pakuptueshme], ku thotë që Ushtria Çlirimtare e
11 Kosovës duhet ta ndërrojë formën e veprimit të saj, nga vija -
12 - domethënë nga lufta frontale të kalojë në luftë guerile. Kjo
13 ka qenë pak a shumë e formulume kështu prej Adem Demaçit.
14 PY. Më bëhet qejfi që e dhe një shembull që të kujtohej. Unë
15 tani po ju pyes: Nëse nuk të kujtohet ndonjë komunikatë ku
16 përmendeshin ata bashkëpunëtorët, kolaboracionistët, tani që
17 je këtu në bankën e dëshmitarëve, a të kujtohet ndonjë
18 komunikatë tjetër konkrete përveç asaj që përmende nga Adem
19 Demaçi?
20 PË. Jo, por pse bash këto e mbajta mend është për faktin se
21 kjo komunikatë realisht ishte një prej atyre që pak a shumë na
22 paraqiste vështirësi në rikonstruktimin e ushtrisë. Për ato
23 edhe realisht e mbajta mend. S'e di sa u thirrshin në emër të
24 asaj se jo duhet me ndryshu formën e veprimit. Prandaj atë nuk
25 e kam harru.

1 PY. Do flasim për një temë tjetër. Në intervistën me ZPS-në
2 keni përmendur edhe dënimin me vdekje për bashkëpunëtorët. Kur
3 keni folur me ZPS-në dhe keni thënë që ishte një dënim i
4 mundshëm dhe dënimi me vdekje për bashkëpunëtorët, e kishit
5 fjalën për dënim me vdekje vetëm për anëtarët e UÇK-së apo
6 edhe civilët do të dënoheshin me vdekje në qoftë se do të
7 ishin kolaboracionistë?

8 PË. Jo, fjala është kon vetëm për ushtarët e Ushtrisë
9 Çlirimtare që tradhtojnë.

10 PY. Më pas i thatë ZPS-së se dënimi me vdekje nuk mund të
11 jepej nga komandanti, por ky ishte një dënim që mund të jepej
12 vetëm nga strukturat më të larta. Për cilat struktura e kishit
13 ju fjalën?

14 PË. Po zakonisht është mendu në një autoritet më të lartë. Që
15 komandanti i brigadës me pas një të drejtë të tillë ka qenë
16 problematike me mujt me i ekzekutu, problematike. Edhe është
17 fol në mënyrë të përgjithshme. Nuk ka pas diçka specifike që
18 është bo fjalë.

19 PY. Ju keni ndonjë dijeni, keni dijeni për ndonjë rast ku
20 jetë dënuar me vdekje ndonjë prej anëtarëve të UÇK-së nga
21 ndonjë autoritet i lartë?

22 PË. Jo. Jo, nuk jam në dijeni.

23 PY. Si ish-oficer i armatës jugosllave, a e dini ju që edhe
24 me ligjet jugosllave, bashkëpunimi me armikun në kohën kur
25 kishte konflikt të armatosur mund të dënohej me vdekje?

1 PË. Gjithsesi se po.

2 PY. I keni thënë po ashtu ZPS-së që ekzistonte po ashtu një
3 dokument që ju jepej ushtarëve të rinj, dhe ata duhej ta
4 lexonin atë dokument -- një çast që t'ju japim edhe referencën
5 palëve.

6 Z. MISETIC: [Përkthim] Bëhet fjalë për materialin me
7 numër P01327.5 Pjesa 5, faqja 18, rreshtat 4 deri në 7 e në
8 vijim.

9 PY. Ju keni thënë se ekzistonte një dokument që u jepej
10 ushtarëve të rinj. Ata duhet ta lexonin, ta pranin, dhe të
11 pranonin se duhet të zbatonin rregullat e UÇK-së, përndryshe
12 nëse nuk do të respektonin këto rregulla mund të deheshin e
13 mund të dënoheshin edhe me vdekje. A ju kujtohet që ja keni
14 thënë këtë Prokurorisë?

15 PË. Kam mund, kam mund me ju thanë por kam mendu në tekstin e
16 betimit të cilin s'kemi pasë mundësi me e realizu betimin në
17 mënyra solemne, por ja u keni dhënë tekstin me e lexu ushtarët
18 dhe pak a shumë me ditë synimin tonë si Ushtri Çlirimtare të
19 Kosovës.

20 PY. Këtë mendova edhe unë, në fakt.

21 Z. MISETIC: [Përkthim] Do lutesha është të vendosim në
22 ekran, provën materiale me numër P00641. Faqja 8 edhe në
23 anglisht edhe në shqip. Gjashtë faqe më përpara, ju lutem.

24 PY. Dëshmitar, ju lutem lexoni këtë pjesën ku është poshtë
25 titullit "Përmbajtje e betimit ushtarak" dhe të më thoni nëse

1 ishte kjo ajo që deshët të thonit ju, kur folët për dënimin me
2 vdekje.

3 PË. Pikërisht. Po.

4 PY. Faleminderit. Në intervistën me ZPS-në keni përmendur
5 disa nga ngjarjet në pranverën e 1999. Në Shënimin Përgatitur
6 numër 1, paragrafi 45 -- më falni nuk e dhashë të saktë
7 referencën.

8 Ju keni thënë që keni qenë përgjegjës për sektorin e
9 edukimit brenda UÇK-së në atë kohë. Kështu?

10 PË. Po. Si e përmenda edhe ma herët, me përfundim të punës si
11 shef shtabi në zonën operative të Pashtrikut, jam lajmëru në
12 drejtorinë operative të Shtabit të Përgjithshëm në sektorin e
13 shkollimit dhe stërvitjes, e cila ka pasë një zyrë në Nishor
14 dhe aty kam punue rreth përgatitjes së planeve për trajnim të
15 stafit komandues, për komandant niveli të ulët edhe të mesëm.

16 PY. Në intervistën për ZPS-në thoni që -- është korrigjuar
17 kjo më pas, në fakt, prej jush, në Shënimin Përgatitor numër
18 1, fillimisht keni thënë se keni menduar që z. Thaçi po bënte
19 ndryshime në mënyrë që të dobësonte UÇK-në dhe të mënjanonte
20 konkurentët e mundshëm politikë. Por ama në Shënimin
21 Përgatitor numër 1, në paragrafin 45 ju keni thënë që ky ishte
22 thjesht mendimi juaj lidhur me atë situatë pas luftës dhe ju
23 nuk e dini konkretisht çfarë ka ndodhur. Kështu?

24 PË. Zoti Avokat, realisht tash në një çështje tash të jemi
25 shumë korrekt. Intervista në, domethënë, me ZPS-në ka qenë dy

1 ditë edhe ka qenë bukur e mundimshme. [E pakuptueshme] edhe
2 rrjedhja e ndonjë gabimi është krejt normale. Por, edhe kjo
3 tash që është thënë në fazën përgatitore edhe këtu ai material
4 është lexu edhe sa kam mujt me majt mend edhe pastaj disa
5 korrigjime i kemi bo me Prokurorin.

6 Por me një çështje, disa çështje që interpretohen edhe
7 jipen në stenogramet e intervistës të 2019-s, realisht
8 paraqesin mendimet e mia, opinionin tim. I mirë e i keq ai
9 është i jemi jo ndonjë farë dokumenti që është i një forme
10 zyrtare.

11 PY. Pajtohem. Po thjesht dua t'ua bëj këto pyetje që të
12 sqarojmë disa nga gjërat që gjenden në deklaratën tuaj. Që ta
13 sqarojmë edhe një herë. Ndonëse është opinionin juaj sipas jush
14 kush ishin konkurrentët e mundshëm politikë të z. Thaçi? Ky ka
15 qenë formulimi që keni përdorur ju në intervistë.

16 PË. Realisht z. Thaçi pas luftës pat formu Partinë
17 Demokratike. Konkurrentë i ka pas partitë politike të tjera.
18 Një prej tyre ka qenë LDK-ja. Nuk jam tash -- më fal, po nuk
19 jam tuj e kuptu tash thelbin e asaj që ju po doni.

20 PY. Dhe është faji im. Do të jap edhe kontekstin. Keni folur
21 me ZPS-në gjatë intervistës suaj, keni diskutuar periudhën e
22 pranverës së 1999. Dhe ka pasur një diskutim në qoftë se gjatë
23 asaj periudhe kohore, pra në pranverën e 1999 mos ka bërë
24 ndryshime z. Thaçi brenda UÇK-së me qëllim që të eliminonte
25 konkurrentë të mundshëm politikë të tij. Tani unë pyetjen e

Dëshmitari: Kurtesh Fondaj (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Misetiç

Faqe 146

1 kam kështu: Sipas jush në pranverën e 1999, kë perceptonte z.
2 Thaçi si konkurrent të mundshëm politik sipas jush?

3 PË. Brenda UÇK-së nuk besoj që ka pas ndonjë konkurrent ose
4 edhe ndonjë pretendent që me marrë diçka në vijën politike.

5 Z. MISETIC: [Përkthim] Z. Kryegjykatës, po shoh orën. Të
6 filloj nesër paradite, po nuk do të kem edhe shumë pyetje. Kam
7 edhe një çështje organizimi përpara se ta mbyllim ditën e
8 sotme.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Fondaj,
10 për sot përfunduat. Faleminderit që ishit këtu dhe ndatë
11 informacionet që kishit. Do të ktheheni nesër në orën 9 të
12 mëngjesit që të vazhdojmë me dëshminë tuaj. Tani mos harroni
13 që s'duhet të diskutoni me askënd për dëshminë tuaj jashtë
14 sallës së gjyqit. Tani mund të dilni nga salla e gjyqit. Ju
15 urojmë një mbrëmje të këndshme.

16 DËSHMITARI: Gjithashtu.

17 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në seancë
19 publike?

20 Z. MISETIC: [Përkthim] Po.

21 Fillimisht sa i takon kohës që kisha kërkuar unë jam
22 brenda afatit që kisha kërkuar dhe rreth çerek ore do të kem
23 nesër dhe do të përfundoj.

24 Gjëja tjetër që doja të flisja me ju është diskutimi që
25 pata me Sekretarin e seancës. Unë në fakt doja të shfaqej

1 dokumenti P01333, po në qoftë se nuk e keni këtë dokument,
2 atëherë do ju lutesha që të pranohej tek provat gjyqësore.

3 SEKRETARI I GJYKATËS: [Përkthim] Në fakt komunikam me
4 ekipin tuaj. E konfirmoj që dokumenti P0133 në të vërtetë
5 është një dokument me 13 faqe.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Ka të ngjarë që pyetjet nga ekipi
7 i Mbrojtjes, nga Veseli, do të jenë më të shkurtra nga koha që
8 kishim kërkuar fillimisht.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e ekipet e
10 tjera do ta shkurtojnë një çikë kohën?

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Jo.

12 Z. ELLIS: [Përkthim] Do ta shoh sonte, por për momentin
13 jo. I qëndroj kohës që kisha kërkuar më përpara.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
15 Faleminderit. Faleminderit për bashkëpunimin.

16 Shihemi nesër në orën 9.00.

17 --- Seanca mbyllet në orën 16.31

18

19

20

21

22

23

24

25